



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 483/prot.
6

Tiranë, më 02.06.2022

Lënda: Dërgim raporti përfundimtar auditimi.

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

TIRANË

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.5043/1 prot, datë 12.10.2021 "Për miratimin e planit strategjik për periudhën 2022-2024 dhe planit vjetor të auditimit për vitin kalendarik 2022" dhe programit të auditimit nr.483/1 prot, datë 27.01.2022 "Për auditimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas", miratuar nga drejtori i komanduar i auditit në MD, bashkëlidhur po ju dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit të mbajtur gjatë përbushjes së angazhimit të auditimit në Institucionin Tuaj. Auditim ka përfshirë periudhën 01.05.2019 deri më 31.12.2021.

Në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr.114, dt.22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", si dhe kapitulli VI, pika 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, detyroheni që raporti i auditit të jetë objekt analize në strukturat tuaja.

Brenda 20 ditë pune nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit duhet të dërgoni pranë drejtorisë së auditimit Planin e Veprimit të miratuar dhe të plotësuar me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Drejtoria e auditimit në vijim **do të ndjekë dhe monitorojë zbatimin e rekomandimeve**, bazuar e në zbatim të kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin nr.114 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", manualin e auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i Financave nr.100 datë 25.10.2016, i ndryshuar me udhëzimin nr.42 datë 27.10.2020 "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

ULSI MANJA



1950
1951
1952

1953
1954
1955

RAPORT PËRFUNDIMTAR

“Mbi vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të përputhshmërisë e të rregullshmërisë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për periudhën e aktivitetit nga data 01.05.2019 deri më datë 31.12.2021.”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

Në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Drejtori i Komanduar, Z.Gentjan Thoma, me nr. 483/1 prot, datë 27.01.2022 “Për auditimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas” sipas objektit dhe llojit të auditimit, grupi i punës, kreu angazhimin e auditimit për vlerësimin e aktivitetit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Qëllimi i misionit të auditimit, në zbatim të programit të punës është aktiviteti ekonomiko-financiar, përputhshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore dhe rregullshmëria e veprimeve me karakter financiar. Afati i auditimit është 01.05.2019 deri më datë 31.12.2021.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas është person juridik publik nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me urdhër nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.

Ky Institucion zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike, vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me dhënie të ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrisë së Drejtësisë për t’u përfshirë në buxhetin e shtetit, bashkëpunon me organizata ndërkombëtare me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.

Organizimi dhe funksionimi i së cilës është i rregulluar me ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Rregulloren e Brendshme, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me urdhër nr. 393, datë 23.11.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, në të cilin janë përshkruar detyrat, kompetencat funksionale të drejtorive si dhe parimet themelore në ushtrimin e veprimtarisë.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, rezultoi se veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve të kontrollit të brendshëm ka funksionuar relativisht mirë.

Në vijim po japim një përmbledhje të konstatimeve të grupit të auditimit, gjetjeve, dhe konstatimeve kryesore:

- ✓ Gjatë procesit të auditimi konstatuam se në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas gjatë periudhës **Qershor – Dhjetor 2020** janë akumuluar detyrime të papaguara në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shendetesore, për shkak të deklarimit me vonesë në sistemin e organeve tatimore të punonjësve e këtij institucioni, **detyrim ky në shumën 37,347 lekë.**
- ✓ Nga ana DNJF (Drejtoria e Finacës) **për vitin 2020**, në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë zbatuar saktë përcaktimet ligjore për rastin e pagesës së lejes së pakryer për vitin 2020 të një punonjësi si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës, përmes procedurës së lëvizjes paralele, të bazuar në përllogaritje jo korrekte sipas kuadrit ligjor e financiar aktual duke **përfiturar në mënyrë të gabuar 19,092 lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.** Ky veprim është në kundërshtim me vendimin nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 4 “Pushimet”. i ndryshuar ,
- ✓ Për periudhën e audituar për vitin 2019-2020, janë likuajduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor *në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”¹, konkretisht neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i” ku thotë se “30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga debitori të faturës ose kërkesë pagese të njëvleftshme”, **institucioni duhet të kryej likuidimin.** Konkretisht janë likuajduar 5 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 148,210 lekë duke sjellë edhe tejkalim të afateve që parashikon Ligji nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare dhe si pasojë b. implikojnë risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura).*

*Gjithashtu theksojmë se një rëndësi e veçant duhet ti kushtohet likuidimit të faturave tatimore të avokatëve të ndihmës juridike dytësore duke respektuar me korrektësi Ligjit nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, në lidhje me afatin 30 ditë nga lëshimi i faturës së avokatit që kryen shërbimin, **faturë kjo që duhet të përpilohet në momentin që mbaron procedura e avokatit.** Nga ana e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Ndhmës Juridike Dytësore duhet të standartizohet qartë kjo procedurë (gjurma e auditit) duke eliminuar rriskun e krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura).*

- ✓ Nga auditimi i transaksioneve, u konstatua se, gjatë periudhës objekt auditim për vitin **2019 dhe 2020 shuma 1,167 lekë, vlerësohet si shpenzim i kryer pa efektivitet,** shpenzime këto të kryera për detyrimet e prapambetura në lidhje me **kamatvonesat** për pagesat e shpenzimeve për ujë, si dhe **kamatvonesat** në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorit vendore e taksave për vitet 2018-2019, *në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 10, si dhe në kundërshtim me, ligjin nr.*

48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7
"Afati për autoritetet publike", pika "i"

- ✓ Duke analizuar performancën e buxhetit **për vitin 2019-2020** rezulton se, nga ana e institucionit ka një menaxhim dhe punë jo koherente, në planifikim dhe realizimin e planit të buxhetit. Në këtë situat ka ndikuar negativisht edhe situata e pandemisë në vend. Shkalla e shfrytëzimit të fondeve të buxhetit është nën ndikimin e drejtëpërdrejtë të ndryshimit të (Nëpunësit zbatues) dhe si rrjedhojë ndryshimi i tyre ka ndikuar negativisht në planifikimin, **ndjekjen, si dhe argumentimet e sakta mbi planifikimin buxhetor.**
- ✓ Për periudhën e audituar u konstatua se niveli i përqindjes së realizimit të artikullit 602 (Mallra dhe shërbime) dhe 231(Investime), nuk janë në nivele të kënaqshme. Gjithashtu, në total shkalla e përqindjes së realizuar është 37.6 %. Konkretisht artikulli **602** "Shpenzime operative", është realizuar **42.4%** për vitin 2019, viti 2020 është realizuar **33.5%** dhe për vitin 2021 është realizuar **26.3%** , **fakt që tregon performancë relativisht të ulët**, për ndjekjen dhe realizimin sistematik të fondeve të planifikuar për vitin ushtrimor. Ky artikull buxhetor duhet të mbështetet në argumentime më të qarta dhe të sakta planifikimi.
- ✓ *Drejtorja e financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Ndihmës Juridike Dytësore, duhet të menaxhoj me efektivitet situatën në përdorimin e fondeve vjetore, ndjekjen dhe realizimin sistematik të çdo artikulli buxhetor konkretisht shpenzimet gjyqësore të cilat kanë një peshë specifike të madhe në shpenzimet buxhetore dhe situacionin e shpenzimeve të mos e shikojë vetëm si një tabelë përmbledhëse, por si analizë për të nxjerr shkaqet dhe pasojat me qëllim, realizimin e fondeve buxhetore, si dhe përmbushjen e objektivave të institucionit në kohën e duhur.*
- ✓ Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 procesi i inventarizimit nuk është kryer brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore, brenda vitit 2020, por në fillim të vitit 2021. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë.29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" me ndryshimet, neni 7.
- ✓ Nga auditimi u konstatua se në lidhje me nëpunësin zbatues për vitin 2020, caktuar me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 "Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas **nuk janë ndjekur procedurat e dorëzimit të materialeve në ngarkim për punonjësit që largohen**, veprim i cili vjen në kundërshtim me pikën 10 dhe 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik": *Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve.*

- ✓ Aktualisht, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka 2(dy) qendra të ndihmës juridike parësore të financiar nga Buxheti i DNJF-së, nga katër që janë parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit. Qendra e Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë e vendosur në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë e rivitalizuar prej muajit Korrik 2021 dhe Qendra e Ndhmës Juridike Parësore në Lushnje e vendosur në ambientet e Bashkisë Lushnje, e rivitalizuar prej muajit shtator 2020.
 - a). Për periudhën 2019-2020 u konstatua ekzistenca e vendeve vakante në kundërshtim me Urdhrin nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”.
 - b). Përditësimi dhe administrimi i dosjeve të personelit nuk është mbajtur sipas VKM-së nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”.
- ✓ Nga auditimi u konstatua se drejtoritë nuk kanë hartuar manualin e proceseve të punës dhe hartën e proceseve të përditësuar, si dhe nuk është hartuar gjurma e auditimit konform Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas është një institucion i krijuar rishtazi dhe janë ende në proces të krijimit të një praktike të unifikuar pune, për rrjedhojë vlerësimi i pagesave të avokatëve vlerësohet me një nivel risku të lartë. Duke qënë se praktika e përmendur në projekt raport përbën një rast sui generis (papajftueshmëria për shkak të ushtrimit të funksionit të avokatisë), i rekomandojmë DNJF-së dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Dytësore t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë vlerësimit të pagesave të avokatëve të ndihmës juridike falas duke interpretuar drejtë dhe pa konfunduar bazën ligjore dhe konkretisht ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, udhëzimin e përbashkët nr.18, datë 05.08.2020 dhe Kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Gjatë ushtrimit të misionit të auditimit, është konstatuar se është punuar mirë për njohjen dhe implementimin e Ligjit nr.10297, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, DNJF ka zbatuar relativisht mirë rregullat, parimet, procedurat për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, por është e nevojshme të ndiqet në vazhdimësi procesi i implementimit të ligjit për MFK-në. Si institucion varësie i Ministrit të Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i DNJF raporton mbi veprimtarinë e institucionit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

II. HYRJE

Grupi i Auditimit, nisur nga qëllimi dhe objekti i misionit të auditimit, bazuar në Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, urdhrin të Ministrit të Financave nr.

100, datë 25.10.2016 “Miratimi i manualit të auditimit të brendshëm”, Ligjit nr.10 296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me ndryshime etj.

Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë, sipas programit të angazhimit të auditimit me nr. 483/1 prot, datë 27.01.2022 “Për auditimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, të miratuar nga Drejtori i Komanduar, bëri vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe përputhshmërisë ligjore të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, për periudhën nga data 01.05.2019 deri më datë 31.12.2021, lidhur me funksionimin e DNJF nga ana organizative, zbatimin e strukturës, organikës, vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, menaxhimin ekonomiko-financiar, administrimin, ruajtjen, dokumentimin e qarkullimin e vlerave materiale e monetare, zbatimin e dispozitave ligjore për blerjet me vlera të vogla, zbatimin e afateve të përcaktuara nga ligji, zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, analizën ligjore të funksionimit të institucionit, procedurat e prokurimeve në përputhje me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore, realizimin e objektivave me efektivitet dhe eficientë.

Grupi i Auditimit i ngarkuar për kryerjen e këtij misioni, me përbërje:

1. Alma Naska, përgjegjëse e grupit,
2. Adriana Kalemaj, anëtare e grupit.

Auditimi filloi me datën **27.01.2022** dhe mbaroi në datën **28.02.2022**, sipas programit bazë nr. 483/1 prot, datë 27.01.2022 “Për auditimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare, përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, në 3(tre) kopje, nga të cilat 1(një) kopje i dërgohet menaxhimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, 1(një) kopje qëndron në arkivën e Ministrisë së Drejtësisë dhe 1(një) kopje administrohet nga Drejtoria e Auditimit.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit, Grupi i Auditimit ka audituar vlerësimin e aktivitetit financiar-ekonomik, procedurat e planifikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, sistemin e funksionimit ligjor të institucionit, sistemin e buxhetit, inventarizimin, sistemin e kontrollit të brendshëm, monitorimin dhe menaxhimin financiar.

Baza Ligjore:

-Ligj nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar me ligjin nr.40/2017, datë 30.3.2017

- Ligji nr. 111/2017, “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”,

-Rregulloren e Brendshme, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me urdhër nr.393, datë 23.11.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”;

-Ligj nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 162 /2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Udhëzimi i MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
- Ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Ligj nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë;
- VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe aktet e nxjerra nga Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë në zbatim të akteve të mësipërme.

Auditimi është kryer, në përputhje me kodin etik dhe standardet e auditimit duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, konform me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

Standardet e auditimit

Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Miratimi i Manualit të Auditimit të Brendshëm” me ndryshime.

III. METODA E AUDITIMIT

Mbi bazë sistemi, *i kombinuar, me zgjedhje* duke përfshirë auditimin e përputhshmërisë (realizuar nëpërmjet intervistave me stafin e punonjësve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, në nivel drejtorësh drejtorie, pyetësorëve mbi kontrollin e brendshëm, vlerësimin e sistemit të pagave dhe personelit, procedurat e prokurimit, auditimin financiar (realizuar nëpërmjet vlerësimit të saktësisë së llogarive, transaksioneve dhe vlerësimin e saktësisë, plotësisë dhe ligjshmërisë së veprimeve financiare), auditimin e performancës realizuar nëpërmjet rishikimit dhe vlerësimit të veprimtarisë, proceseve si dhe vlerësimi nëse burimet janë përdorur me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet). Periudha e audituar është **01.05.2019 deri më 31.12.2021**. Qëllimi i misionit të auditimit është vlerësimi dhe dhënia e sigurisë së arsyeshme mbi funksionimin ligjor të veprimtarisë së njësisë shpenzuese, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen.

IV. GJETJET, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR CDO SISTEM

Pasi u analizua i gjithë dokumentacioni i paraqitur sipas sektorëve, si dhe i vlerësimit në tërësi të veprimtarisë së institucionit, bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, në mënyrë të përmbledhur konstatojmë si më poshtë:

Drejtimit ku u ushtrua auditimi:

1. Auditim mbi strukturën organike dhe pagat e punonjësve.

1.1 Llogaritja e pagës, zbatimi i kriterëve për përfitim.

U audituan pagat e punonjësve të Drejtorisë së **Ndihmës Juridike Falas**, të cilat përcaktohen sipas funksionit dhe kategorisë bazuar në VKM-së nr.181, datë 03.03.2011 "*Për Miratimin e Struktures dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve civilë/nëpunësve*", *Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit*" lidhja nr. 7 kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në institucionet qendrore të përcaktuara sipas pikës 1/3/b, të këtij vendimi, e cila korenspondon me lidhjen nr 7, tabela bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Paga e punonjësve mbështetës është përlllogaritur bazuar në VKM nr.202, datë 15.03.2017 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucionit dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore*", të ndryshuar.

Gjithashtu nga auditimi i kryer nuk u konstatuan parregullsi në përputhshmërinë e diplomës me pozicionin e punës dhe se përcaktimi i pagës së grupit është realizuar konform llojit të diplomës të gjendur në dosjen e personelit, ku përcaktohet qartë vlera e pagës për çdo grup diplome të arsimit universitar duke i përcaktuar në tre grupe, konform vendimit sa më sipër.

Pagat e punonjësve në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas janë përcaktuar sipas funksionit dhe kategorisë referuar Urdhrit të Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas*".

U realizua auditimi në lidhje me përlllogaritjet e vjetërsisë në punë, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të përballuara nga punëmarrësi si dhe ato të përballuara nga punëdhënësi, deklaratimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre a janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, të ligjit nr. 7770, datë 13.10.1994 "*Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*", tatimi mbi pagë është llogaritur konform ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për Tatimin mbi të Ardhurat*" me ndryshimet përkatëse janë kryer ndalesat të cilat janë derdhur në Degën Rajonale të Tatimeve dega Tiranë. Nga auditimi u konstatua se në këtë institucion për vitin 2021, zbatohet

borderoja e unifikuar që i referohej Udhëzimit Nr. 4, datë 13.12.2016 “Për Formën elementet dhe plotësimin e borderosë së pagave për njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe u konkludua se është një zgjidhje e drejtë që të gjithë Institucionet të kenë një format të njëjtë të pagave, pavarishtë specifikimeve dhe kriteret e ndryshme që secili ka. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës si listëprezencat, urdhrat e veçantë të titullarit. Janë nënshkruar nga drejtuesi kryesor të gjithë listëprezencat dhe urdhër shpenzimet për pagat. Urdhër shpenzimet janë nënshkruar edhe nga dega e Thesarit Tiranë. Në përfundim të auditimit mund të shprehemi se ishin kryer me dokumentacion të plotë autorizues e justifikues konform akteve ligjore e nenligjore.

1.1/a - Pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në lidhje me personat për deklarim me vonesë në sistemin e organeve tatimore duke akumuluar gjoba për detyrim të papaguar ne Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Gjetje: Gjatë procesit të auditimi konstatuam se në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas gjatë periudhës **Qershor –Dhjetor 2020**, janë akumuluar detyrime të papaguara në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për shkak të deklarimit me vonesë në sistemin e organeve tatimore për punonjësve e këtij institucioni detyrim ky **në shumën 37,347 lekë.**

Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr.12968, datë 14.10.2021 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, përcaktohet qartë se në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.08.2008,” Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas rezulton të jetë debitore në shumën 37,347 lekë, për deklarim te vonuar **në sistemin e organeve tatimore**, per periudhën Qershor –Dhjetor 2020.

Konkretisht:

NR	Tatimi	Periudha	Detyrimi i papaguar Gjobë(lekë)	Përshkrimi
1	Taim në Burim	Qershor 2020	5.000	Gjobë deklarim i vonuar
2	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Gusht 2020	5.000	Gjobë deklarim i vonuar Esig 027
3	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Gusht 2020	4,828	Gjobë për pagesë të vonuar
4	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Gusht 2020	1,227	Kamatvonsë
5	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Shtator 2020	4,041	Gjobë për pagesë të vonuar
6	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Shtator 2020	1,011	Kamatvonesë
7	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Tetor 2020	5.000	Gjobë deklarim i vonuar Esig 027
8	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Tetor 2020	5.000	Gjobë deklarim i vonuar Esig 027

9	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Nëntor 2020	2.020	Gjobë për pagesë të vonuar
10	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Nëntor 2020	498	Kamatvonesë
11	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Nëntor 2020	132	Kamatvonesë
12	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Dhjetor 2020	2.880	Gjobë për pagesë të vonuar
10	Kontributet e Sig.Shoq. e Shëndetësore	Dhjetor 2020	710	Kamatvonesë
	Totali		37,347	

Jemi para faktit se në sistemin tatimor Drejtoria e Ndihtmes Juridike Falas paraqitet me detyrim të papaguar ndaj sistemit tatimor. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Mbi mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, pika 1; 2 dhe neni 11, pika 3.

Neni 6

1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur.
2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.

Neni 11

3. **Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë të subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës**

Referuar nenit 10 të ligjit nr.9936 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet qartë që në pagesat për fondet buxhetore, nuk parashikohen pagesat e gjobave dhe interesave, nga llogaria e institucionit, si dhe rekomandojmë zbatimin me korrektësi të ligjit. Gjithashtu mbështetur edhe në Ligji Nr.9136, datë 11.09.2003 “Mbi mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 19, pika 1; 2, në të cilë shprehet qartë se:

1. Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, mbahen kamatëvonesat për pagesë të vonuar. **kamatëvonesat nuk falen nga asnjë autorite.**
2. Masa e kamatëvonesës për pagesë të vonuar është ajo e përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjatë procesit të auditimit Drejtoria e Ndihtmes Juridike Falas ka kërkuar, pranë Ministrisë së Financave shqyrtimin e çështjes për faljen e gjobave të gjeneruara në sistemin e tatimeve, me shkresë nr. 346 prot, datë 31.03.2021, e cila nuk është marrë parasysh. Gjithashtu ky institucion ka ankimuar detyrin pranë Drejtorisë e Apelit Tatimor me shkresën nr.682 prot, datë 06.04.2021. Drejtoria e Apelit Tatimor ka kthyer përgjigje me shkresë nr.682/7 Prot, datë 29.06.2021 duke e konsideruar të drejtë vlersimin për gjoba dhe kamatvonesave në shumë 37,347 lekë, dhe rrëzon ankimin e tatimpaguesit (në rastin konkret DNJF-së).

Konkluzioni: Nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të ndiqen të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 37,347 lekë, për deklarim të vonuar **në sistemin e organeve tatimore**. Ky detyrim përfaqëson shkelje e disiplinës financiare dhe duhet të zhdëmtohet **nga personi përgjegjës që ka shkatuar këtë detyrim të paparashikuara** nga ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe të zbatohet me korrektësi kuadri ligjor në lidhje me mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Nga auditimi i strukturës, u konstatua se në zërin “Shpenzime personeli” për DNJF rezulton se :

- a). Për vitin buxhetir 2019, nga 10.100 mijë lekë të planit të rishikuar, janë shpenzuar 4.869 mijë lekë ose 48.2%.
- b). Për vitin 2020, nga 18.500 mijë lekë të planit të rishikuar, janë shpenzuar 10.192 mijë lekë ose 55%.
- c). Për vitin 2021 nga 21.400 mijë lekë të planit të rishikuar, janë shpenzuar 15.695 mijë lekë ose 73.3% .

Për periudhën objekt auditimi struktura organike e DNJF sipas planit të miratuar është 26 punonjës dhe sipas viteve numri në fakt është:

- ✓ Viti 2019 muaji dhjetor në fakt janë 12 punonjës
- ✓ Viti 2020 muaji dhjetor në fakt janë 17 punonjës + një punonjës me kontrat të përkohëshme.
- ✓ Viti 2021 muaji dhjetor në fakt janë 17 punonjës + tre punonjës me kontrat të përkohëshme.

Mungesa e theksuar në organikën e këtij Institucion sidomos në vitet 2019-2020 janë reflektuar edhe në përqindjen e ulët të **performancës buxhetore në lidhje me këtë artikull**. Gjithashtu, u bë edhe verifikimi me të zgjedhur i disa punonjësve të institucionit mbi pagesat neto të bëra në llogaritë personale të tyre në banka, duke i krahasuar me pagat neto në listëpagesa, dhe përlllogaritjet e tyre në borderotë përmbledhëse, *për të cilat nuk rezultuan diferenca*.

1.2.Llogaritja e dietave, zbatimi i kritereve dhe procedurat për përfitim.

-Shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit.

Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim dhe dieta brenda vendit, pagesat janë përlllogaritur në përputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” me ndryshime, bashkëngjitur urdhër shpenzimit është urdhër shërbimi, autorizimi, fatura tatimore dhe kuponi tatimor për shpenzimet e akomodimit, biletat për shpenzimet e transportit si dhe dokumentacion tjetër justifikues. Nuk u konstatuan probleme me likuidimin e pagesave në shpenzime udhëtime e dietave brenda vendit. Pagesat janë kryer të rregullta me dokumentacion të plotë autorizues se justifikues. Për periudhën e audituar nuk ka pasur raste të pagesave në udhëtime e dieta jashtë vendit.

1.3. Zbatimi i kritereve dhe procedurave në llogaritjen e shpërblimeve të tjera.

Gjatë periudhës së auditimit u konstatua se në Institucion nuk kishte punonjës që ishin anëtarë të komisioneve të ndryshme të parashikuar për të përfituar shpërblim.

1.4. Sistemi i pagave dhe rekrutimeve.

**Mbi menaxhimin e burimeve njerëzore dhe respektimin ligjor të marrëdhënies së punës.
Zbatimi i kritereve dhe procedurave të punësimit.**

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike, vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me dhënien e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrin të Drejtësisë për t'u përfshirë në buxhetin e shtetit, bashkëpunon me organizata ndërkombëtare me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut. Organizimi dhe funksionimi i së cilës është i rregulluar me Ligjin nr.111/2017, "Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shtetit", si dhe rregulloren e brendshme, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me urdhër nr.393, datë 23.11.2020, "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas".

Me Urdhrin nr.59, datë 25.03.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas", numri i punonjësve i këtij institucioni është përcaktuar të jetë 25 punonjës, nga të cilët 16 janë pjesë e shërbimit civil dhe 9 me kontratë pune.

Në shkurt të vitit 2021 është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundur realisht realizimin e këtij objekti në masën 100%, ku gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 është plotësuar vendi vakant i specialistit të financës.

Gjithashtu, në periudhën 01.05.2019 deri më datë 31.12.2021, janë larguar nga detyra 3 punonjës. Aktualisht vijojnë të mbeten vakante pozicioni i specialistes së Burimeve Njerëzore, 3 specialistë të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike dhe 1 specialistë i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.

Sa i përket punonjësve me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, janë rekrutuar 7 punonjës pranë qendrave Lezhë, Vlorë, Fier, Dibër dhe Tiranë si dhe është bërë i mundur rekrutimi i 2 paraligjorëve pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Është miratuar Metodologjia e Vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me urdhër nr.53, datë 26.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm si dhe është zhvilluar procesi i konkurrimit për vendet vakante pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Për këtë është ngritur një Komision për zhvillimin e procesit të konkurrimit me urdhër nr.18, datë 01.02.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i Ndhmës Juridike Falas.

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit auditoi dosjet e personelit të punonjësve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike për t'i audituar. Auditimi i dosjeve të personelit u shtri në dy drejtime: 1) auditim i përputhshmërisë së diplomës me pozicionin e punës dhe 2) auditim i pagës së grupit me llojin e diplomës. Nga auditimi nuk u konstatuan parregullsi në përputhshmërinë e diplomës me pozicionin e punës dhe se përcaktimi i pagës së grupit është realizuar konform llojit të diplomës të gjendur në dosjen e personelit, por gjatë auditimit u konstatua se dosjet ishin krijuar për çdo punonjës, por administrimi i tyre nuk ishte realizuar konform VKM-së nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, *Lidhja 1 dhe 2*, pasi dosja e personelit jo gjithmonë përmbante dokumenta të noterizuara (si p.sh: fleta e inventarizimit, diploma dhe listë notash të noterizuara, akte të emërimit.etj...). Kjo kishte ardhur si pasojë e mungesës së specialistit të burimeve njerëzore prej 2 vitesh në këtë institucion.

Gjithashtu, u audituan përshkrimet e punës, të cilat ishin hartuar dhe realizuar konform lidhjes nr.4, Formulari i Përshkrimit të Punës duke përcaktuar misionin, qëllimin, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore dhe kërkesat e posaçme për kualifikim.

Përshkrimet e Punës janë hartuar bazuar në VKM-në nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura”, i ndryshuar. Përshkrimet e punës janë firmosur nga nëpunësi civil, eprori direkt dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

Procesi i vlerësimit të performancës së punonjësve është realizuar 2 herë në vit bazuar në VKM-në nr.109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, sipas Formularit të vlerësimit sipas Lidhjes nr.1 dhe 2. Punonjësit vlerësohen për realizimin e objektivave sipas standardeve profesionale dhe etike. Është realizuar dokumentimi i vlerësimeve në dosjet përkatëse të personelit për secilin punonjës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Rekrutimi realizohet nga DAP sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Struktura organizative është miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”.

Deri në fund të periudhës së audituar janë konstatuar 10 Pozicione vakante, 5 punonjës me trajnim të posaçëm, 3 specialistë të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, 1 specialist i Burimeve Njerëzore dhe 1 specialist i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.

Gjetje nga auditimi: Përditësimi dhe administrimi i dosjeve të personelit nuk është mbajtur sipas VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”.

Rekomandimi: Të përditësohen të gjitha dosjet e personelit të DNJF-së sipas Lidhjes 1 të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020.

Gjetje nga auditimi:

Në strukturën funksionale, për periudhën e audituar ka patur 10 vende vakante në kategorinë ekzekutive/me trajtim të posaçëm.

Rekomandim:

Këto vakanca organike të ndiqen me prioritet nga institucioni i varësisë, dhe të vazhdoj bashkëpunimi i DNJF-së me DAP-in për plotësimin e vakancave me staf të kualifikuar, pasi mungesa e punonjësve ndikon në performancën e realizimit të objektivave të institucionit me efektivitet dhe efikasitet.

Largimet nga puna, mënyra e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Deri në përfundim të auditimit, janë larguar 3 specialistë nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Dytësore, 1 specialist i Burimeve Njerëzore të larguar me kërkesë për dorëheqje dhe 1 specialist i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore me ngritje në detyrë.

Sistemi i pagave rekrutime të stafit të DNJF-së:

Gjetjet për sistemin e pagës, zbatimin e kritereve për përfitim dhe rekrutimeve do të trajtohen sipas formatit të mëposhtëm:

Titulli i Gjetjes: “Analiza në lidhje me deklarinë me vonesë në sistemin e organeve tatimore duke akumuluar gjoha për detyrim të papaguar kundrejt Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.”

Gjetje Nr. 1	
(Subjekti i Audituar)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë ,(Drejtoria e Financës) në (DNJF)
(Njësitë/subjektet e interesuar nga gjetja)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji Nr.9136, datë 11.09.2003 “Mbi mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, pika 1; 2 dhe neni 11, pika Neni 6 1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarinë dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur. 2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.

	<p>Neni 11</p> <p>3. Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë të subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës</p> <p>”, neni 19, pika 1; 2, në të cilë shprehet qartë se</p> <p>1. Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, mbahen kamatëvonesat për pagesë të vonuar, kamatëvonesat nuk falen nga asnjë autorite.</p> <p>2. Masa e kamatëvonesës për pagesë të vonuar është ajo e përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>
Përshkrimi i detajuar i gjetjes	<p>Gjatë procesit të auditimi konstatuam se në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2020, janë akumuluar detyrime të papaguara në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për shkak të deklarimit me vonesë në sistemin e organeve tatimore për punonjësve e këtij institucioni detyrim ky në shumën 37,347 lekë.</p> <p>Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 12 968, datë 14.10.2021 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, përcaktohet qartë se në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.08.2008,” Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas rezulton të jetë debitore në shumën 37,347 lekë, për deklarim të vonuar në sistemin e organeve tatimore, për periudhën Qershor –Dhjetor 2020.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë
Konkluzioni	<p>Jemi para faktit se në sistemin tatimor Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas paraqitet me detyrim të papaguar ndaj sistemit tatimor në shumën 37,347 lekë.</p> <p>Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Ligji Nr.9136, datë 11.09.2003 “Mbi mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, pika 1; 2 dhe neni 11, pika 3.</p>
Rekomandimi	<p>Nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të ndiqen të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 37,347 lekë, për deklarim të vonuar në sistemin e organeve tatimore. Ky detyrim përfaqëson shkelje e disiplinës financiare dhe duhet të zhdëmtohet nga personi përgjegjës që ka shkatuar këtë detyrim të paparashikuara nga ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të zbatohet me korrektësi kuadri ligjor në lidhje me mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.</p>
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Dhjetor 2022

Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, sqarohet gjithë situata e krijuar e cila është përshkruar qart dhe në projekt raportin e auditimit, si dhe nënvizon mënyrat e ndjekura për ankimimin e gjobës në Drejtorinë e Apelit Tatimor, duke ritheksuar se janë të gatshëm për zbatimin e rekomandimit duke mos cënuar ligjin. (bashkëlidhur korrespondenca për justifikimin e të gjitha fakteve në lidhje me gjetjen e sipërcituar dhe ankimimin e kryer, ku theksojmë se grupit të auditimit janë vënë të gjitha më parë në dispozicion)
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, "Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2 datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë", protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marrë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë: Ky observacion është përpiluar në formën e një sqaruese, ku grupit të auditimit ju referua edhe në periudhën e auditimit në këtë institucion dhe si rrjedhojë nuk sjellin argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

Titulli i Gjetjes: Ekzistenca e vendeve vakante në kundërshtim me Urdhrin nr.59, datë 25.03.2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas".

Gjetje nr. 2	"Ekzistenca e vendeve vakante"
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Struktura është bazuar në <i>Urdhrin e Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas"</i> .
Përshkrimi i gjetjes	Në strukturën funksionale, për periudhën e audituar ka patur rreth <u>10</u> vende vakante. Mosplotësimi i vendeve vakante sjell vështirësi në realizimin e detyrave funksionale, mosrealizim të objektivave të drejtorive me cilësi dhe efektivitet të proceseve të punës. Situata: Mosplotësimi i organikës, ekzistenca e vendeve vakante. Kriteri: <i>Urdhri nr.59, datë 25.03.2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas"</i> .

	Ndikimi/Efekti: Ekzistenca e vendeve vakante ndikon në mosrealizimin e objektivave të institucionit me efektivitet dhe efencë.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Mungesa e plotësimit të vendeve vakante sjell vështirësi në realizimin e deyrave funksionale të secilit pozicion, mbivendosje përgjegjësish për punonjësit e tjerë dhe mosrealizim të objektivave të institucionit. Plotësimi i vendeve vakante të përcaktuara në Urdhrin e Kryeministrit synon të realizojë me efektivitet objektivat e këtij institucioni.
Rekomandimi	Vakancat organike të ndiqen me prioritet nga institucioni, për plotësimin sa më shpejtë të saj, pasi mungesa e punonjësve ndikon negativisht në realizimin e objektivave të institucionit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Subjekti i audituar ka paraqitur argumentime lidhur me gjetjen dhe ka pranuar gjetjen e grupit të auditimit.
Observacioni i gjetjes nr.2	“Ekzistenca e vendeve vakante” Subjekti i audituar me shkresën nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit ka paraqitur kundërshtime si më poshtë: “Përgjatë vitit 2021, pavarësisht kërkesave të përsëritura të institucionit, vendet vakante për stafin ekzekutiv nuk janë shpallur në faqen zyrtare të DAP.”
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	DNJF ka ndjekur procedurat sipas legjislacionit në fuqi, por vakancat organike duhet të vazhdojnë të ndiqen me prioritet nga institucioni, për plotësimin sa më shpejtë të saj, pasi mungesa e punonjësve ndikon negativisht në realizimin e objektivave të institucionit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.
Rishikimi i nivelit të riskut	I mesëm.

Administrimi i dosjeve të personelit të DNJF-së:

Titulli i Gjetjes: Përditësimi dhe administrimi i dosjeve të personelit nuk është mbajtur sipas VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”.

Gjetje nr. 3	“Përditësimi dhe administrimi i dosjeve të personelit”
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas Drejtoria e Financës, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se administrimi i tyre nuk ishte mbajtur konform VKM-së nr.833/2020.</p> <p>Situata: Mosadministrimi i dosjeve konform VKM-së nr.833/2020. Në disa prej dosjeve mungonin dokumentat e noterizuara, aktet e emërimit nga DAP dhe fleta e inventarizimit të dosjeve.</p> <p>Kriteri: VKM-ja nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”.</p> <p>Shkaku: Kjo parregullsi ka ardhur si pasojë e mungesës së specialistit të burimeve njerëzore, si personi përgjegjës për administrimin e dosjeve të personelit të Drejtorisë së Financës, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Administrimi i dosjeve të personelit është detyrë funksionale e specialistit të burimeve njerëzore, Drejtoria e Financës, Aktiveve dhe Shërbimeve Mbështetëse. “3. Njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar.”
Rekomandimi	Të përditësohen të gjitha dosjet e personelit të DNJF-së sipas Lidhjes I të VKM- së nr. 833, datë 28.10.2020.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar.
Observacioni i gjetjes nr.3	“Përditësimi dhe administrimi i dosjeve të personelit” Subjekti i audituar ka argumentuar në observacionin e paraqitur me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet

	<p>kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit se që prej muajit shtator 2020, pozicioni i specialistit të BNJ ka qënë vakant dhe si pasojë është vështirësuar realizimi me cilësi i dosjeve të personelit.</p> <p>Konstatimi i subjektit të audituar: Theksojmë që dokumentacioni i detyrueshëm administrohet në dosjet e personelit, por ka pasaktësi në renditjen e dokumentacionit sipas fletës së inventarit.</p> <p>Opinioni i grupit të auditimit: Gjatë angazhimit të auditimit u konstatua se në disa dosje të personelit, përveç fletës së inventarizimit, ndër të tjera mungonte dokumentacioni i noterizuar, si diploma dhe listë notash të noterizuara në një rast, akte të konformimit në detyrë .etj. Ky fakt u ballafaqua edhe me Drejtoreshën e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.</p> <p>Ky fakt është përmendur nga ana e grupit të auditimit në faqen nr.15 të projekt raport, por theksojmë se DNJF duhet të marrë masat për të realizuar objektivat e institucionit.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Administrimi i dosjeve të personelit është detyrë funksionale e specialistit të burimeve njerëzore, Drejtoria e Financës, Aktiveve dhe Shërbimeve Mbështetëse. “3. Njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar.”</p> <p>Të përditësohen dhe të administrohen të gjitha dosjet e personelit të DNJF-së sipas Lidhjes 1 të VKM- së nr. 833, datë 28.10.2020.</p> <p>Observacioni i paraqitur nga subjekti i audituar ka dalur jashtë kontekstit të rekomandimit dhe gjetjes.</p>
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.
Rishikimi i nivelit të riskut	I mesëm.

2. Sistemi i menaxhimit buxhetor (Auditimi i performancës - Buxheti)

Baza ligjore për auditimin e programimit dhe realizimit të treguesve buxhetorë:

- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligjin nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar;
- VKM nr.80, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017-2019”;
- Udhëzimi nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2019”;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015;
- Udhëzimi Standard i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 02.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

-Udhëzimi nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”;

Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 16.01.2015, si dhe me udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018;

-Udhëzim nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;

-UMF nr. 4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e PBA 2017-2019”;

-UMF nr. 10, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA-së 2018-2020”.

-Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, ka administruar fondet buxhetore në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”, ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”i ndryshuar me Udhëzimin nr.9, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ligjet respektive vjetore si dhe udhëzimet e dërguara nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë. Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit, rezultoi se hartimi dhe dorëzimi i planit të buxhetit për periudhën e audituar, në këtë institucion, është kryer sipas afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Sistemin Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit në DNJF –së (Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas) u mbështet mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 “Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”.

2.1. Respektimi i disiplinës buxhetore sipas titujve, kapitujve, artikujve.

2.2. Respektimi i autoriteteve dhe procedurave për ndryshimet në buxhet.

Për vitin 2019 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018- 2021 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Dhe për vitin 2020 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019- 2022.

Për vitin 2019, evidentojmë se plani i buxhetit i miratuar në shumën **43,000,000 lekë**, është realizuar në shumën **16,313,158 lekë**, ose **38 %**. Me mosrealizim prej **26,686,842 lekë**.

- **Artikulli 600** “Paga personeli dhe shpërblime”, nga **10,100,000 lekë**, është realizuar **4,868,592 lekë**, **48,2%** ,me mosrealizim në shumën **5,231,408 lekë**.
- **Artikulli 601** “Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”, nga **1,800,000 lekë**, është realizuar **665,717 lekë**, ose **37 %**, më pak në shumën **1,134,283 lekë**
- **Artikulli 602** “Shpenzime operative”, nga **20,000,000 lekë**, është realizuar **8,486,857 lekë**, ose **42.4%**, më pak në shumën **11,513,143 lekë**.

- **Artikulli 604 “Transferime korrente të brendshme”**, nga **8,000,000 lekë** është realizuar **0 lekë**, ose **0%**, më pak në shumën **8,000,000 lekë**.
- **Artikulli 606 “Transferta për buxhetin familjar ”** planifikuar në shumën **100,000 lekë** është realizuar **0 lekë** ose **0%**. Më pak në shumën **100.000 lekë**,
- **Artikulli 231 “Investime”**, nga **3,000,000 lekë**, është realizuar **2,292,240 lekë**, ose **76.4 %**. Më pak në shumën **707,760 lekë**.

Duke analizuar realizimin e zërave të buxhetit për vitin 2019, konkludojmë se buxheti ka problematika të theksuara në realizimin e fondeve buxhetare. Konkretisht kemi mungesa të theksuara në organiken e këtij institucioni. Nga intervista e marrë nga Drejtoresha e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse, theksohet mungesa e stafit të institucionit, pasi në këtë vit, viti 2019 institucioni ka qenë në proces ristrukturimi. Të gjithë artikujt nuk janë realizuar dhe kjo si pasojë e riskut të lartë që është ekspozuar ky institucion në procesin e ristrukturimit.

Respektimi i autoriteteve dhe procedurave për ndryshimet në buxhet.

- Miratimi i plan buxhetit për vitin 2019

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2019 dhe në vitet 2020 është rishikuar gjatë viteve me aktet normative dhe shkresat përkatëse të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, janë shoqëruar me shtesa dhe pakësime të fondeve buxhetore.

Buxheti i vitit 2019 për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, është bazuar në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, ku i janë planifikuar fonde buxhetore në vlerën **totale 76,000 mijë lekë**.

Referuar ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, ndryshuar me VKM-në nr.417, datë 24.06.2019, Aktin Normativ nr. 2, datë 02.10.2019, si dhe shkresat e miratuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, janë argumentuar të gjitha ndryshimet që kanë pësuar zërat buxhetorë.

Shumat e alokuara e zërave buxhetore me ndryshimet përkatëse dhe realizimi, paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2019, ndryshimet në buxhet dominojnë paksimet për arsye se ky institucion në fillim të vitit 2019 ka qenë objekt i procesit të ristrukturimi dhe risku për përdorimin e fondeve buxhetore me efektivitet ka qenë relativisht i lartë.

Për vitin 2019 shtesat dhe paksimet paraqiten si më poshtë:

Vlera në 000/lekë

Llogaria Ekonomike që Buxhetohet	Buxheti Fillestar	Ndryshimet gjatë vitit		Buxheti Total Plani	Buxheti Total Fakti
		Shtesa	Paksime		
600	21,000	-	10,900	10,100	4,869
601	4,000	-	2,200	1,800	666
602	40,000	-	20,000	20,000	8,487
604	8,000	-	-	8,000	0
606	0	100	-	100	0
231	3,000	-	-	3,000	2,292
Totali	76,000	100	33,100	43,000	16,314

Për vitin 2020, evidentojmë se plani i buxhetit i miratuar në shumën 45,500 mijë lekë, është realizuar në shumën 17,140 mijë lekë, ose 37.7%. Me mosrealizim prej 28,360 mijë lekë.

- **Artikulli 600** “Paga personeli dhe shpërblime”, nga 18,500 mijë lekë, është realizuar 10,192 mijë lekë, ose 55%. Me mosrealizim në shumën 8,308 mijë lekë,
- **Artikulli 601** “Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”, nga 3,200 mijë lekë, është realizuar 1,681 mijë lekë, ose 52.5%. Me mosrealizim në shumën 1,519 mijë lekë.
- **Artikulli 602** “Shpenzime operative”, nga 15,700,000 lekë, është realizuar 5,267,156 lekë, ose 33.5%. Me mosrealizim në shumën 10,432,843 lekë,
- **Artikulli 604** “Transferime korrente të brendshme”, nga 8,000 mijë lekë është realizuar 0 lekë, ose 0%, më pak në shumën 8,000 mijë lekë.
- **Artikulli 606** “Transferta për buxhetin familjar ” planifikuar në shumën 100 mijë lekë është realizuar 0 lekë ose 0%.

Duke parë realizimin e zërave të buxhetit për periudhën **Janar - Dhjetor 2020** konkludojmë se buxheti është përdorur me mosrealizime nga institucioni. Artikujt **600 dhe 601**, kanë shënuar një mosrealizim në shumën **9,828 mijë lekë**. Gjithashtu **artikulli 602** “Shpenzime operative” paraqitet me mosrealizim në shumën **10,433 mijë lekë**.

Nga vetë institucioni, duhet të ishte menaxhuar më mirë situata në përdorimin e fondeve vjetore buxhetore. Theksojmë se kjo situat ka ardhur si rezultat pandemisë globale të krijuar nga virusi COVIT-19, procedurat e prokurimit janë kryer në mënyrë sporadike dhe çdo aktivitet tjetër që ka të bëjë me zërat buxhetor në këtë institucion.

Nga intervista e bërë me Drejtoreshën e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse, ajo argumentoi se në këtë institucion për këtë periudhë vazhdon vakanca e punonjësve. Gjithashtu nga auditimi konstatuam se në këtë periudhë Artikulli 604 “Transferime Korrente të Brendshme”, nuk është shfrytëzuar nga institucioni.

- Miratimi i plan buxhetit për vitin 2020

Për buxhetin e vitit 2020, u konstatua se nga Ministria e Drejtësisë me shkresë nr.873/1 port. datë 27.02.2020 ka dërguar detajimin e buxhetit për shpenzimet korentë, në zbatim ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019“Për Buxhetin e vitit 2020” i cili është miratuar nga Ministria e Financave. Ndryshimet gjatë vitit për shtesa e pikësime sipas artikujve janë kryer me shkresa të posaçme të Ministrisë së Drejtësisë.

Për vitin 2020, ndryshimet në buxhet janë argumentuar me shkresën përkatëse janë te argumentuara shtesat dhe pikësimet për zëri “Shpenzime për paga” 6009999 dhe “shpenzime operative” 6029999 në muajt përkatës të viti 2020, konkretisht

Për vitin 2020 shtesat dhe paksimet paraqiten si më posht:

Vlera 000/lekë

Llogaria Ekonomike që Buxhetohet	Buxheti Fillestar	Ndryshimet gjatë vitit		Buxheti Total Plani	Buxheti Total Fakti	Diferenca e pa realizuar
		Shtesa	Paksime			
600	25,500	-	7,000	18,500	10,192	-8,308
601	4,500	-	1,300	3,200	1,681	-1519
602	38,000	-	22,300	15,700	5,267	-10,433
604	8,000	-	-	8,000	0	-8,000
606	-	100	-	100	-	-100
231	-	-	-	-	-	
Totali	76,000	100	30,600	45,500	17,140	-28,360

Për vitin 2021, evidentojmë se plani i buxhetit i miratuar në shumën **66,200 mijë lekë**, është realizuar në shumën **29,702 mijë lekë**, ose **44.3 %**. Me mosrealizim prej **36,498 mijë lekë**.

- **Artikulli 600** “Paga personeli dhe shpërblime”, nga **21,400 mijë lekë**, është realizuar **15,695 mijë lekë**, ose **73.3%**. Me mosrealizim në shumën **5,705 mijë lekë**,
- **Artikulli 601** “Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”, nga **3,600 mijë lekë**, është realizuar **2,579 mijë lekë**, ose **71.5%**. Me mosrealizim në shumën **1,021 mijë lekë**.
- **Artikulli 602** “Shpenzime operative”, nga **39,974 mijë lekë**, është realizuar **10,504 mijë lekë**, ose **26.3%**. Me mosrealizim në shumën **29,470 mijë lekë**,
- **Artikulli 606** “Transferta për buxhetin familjar ” planifikuar në shumën **226 mijë lekë** është realizuar **24 mijë lekë** ose **10,6%**. Më pak në shumën **202 mijë lekë**,
- **Artikulli 231** “Investime”, nga **1,000 mijë lekë**, është realizuar **896,880 lekë**, ose **90%**. Më pak në shumën **103 mijë lekë**.

Duke parë realizimin e zërave të buxhetit për periudhën **Janar - Dhjetor 2021**, konkludojmë se buxheti është përdorur relativisht mirë nga institucioni. Nga auditimi u konstatua se fondet e rakorduara për artikujt **602,606 kanë përqindje relativisht të ulët realizimi, rreth vlerave 26.3% dhe 10.6 %**, si rezultat i mos realizimeve të shpenzimeve gjyqësore të cilat me këtë drejtori zënë e një peshë specifike të madhe të buxhetit dhe si rrjedhojë ndikojnë dukshëm në performancën buxhetore . Në artikullin 602, ka një mosrealizim për shumën **29,470 mijë lekë lekë**. Nga vetë institucioni, në bashkpunim me Ministrinë e Drejtësisë, duhet të ishte menaxhuar më mirë situata në përdorimin e fondeve vjetore për këta artikuj duke ndikuar dukshëm në performancën buxhetore.

Nisur nga kjo situatë, rekomandojmë që ndjekja e fondeve buxhetore të realizohet me korrektësi si nga ana e institucionit dhe monitoruar drejtë nga Ministria e Drejtësisë.

- Miratimi i plan buxhetit për vitin 2021

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2021 është rishikuar gjatë vitit me aktet normative dhe shkresat përkatëse të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, janë shoqëruar me shtesa dhe pakësime të fondeve buxhetore.

Buxheti i vitit 2021 për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, është bazuar në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, ku i janë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale **75,000,000 lekë**.

Për buxhetin e vitit 2021, u konstatua se nga Ministria e Drejtësisë me shkresë nr.535 port. datë 27.01.2021 ka dërguar detajimin e buxhetit për shpenzimet korente, në zbatim ligjit nr. 137/2020, “Për Buxhetin e vitit 2021” i cili është miratuar nga Ministria e Financave.

Ndryshimet gjatë vitit për shtesa e pakësime sipas artikujve janë kryer me shkresa të posaçme të Ministrisë së Drejtësisë.

Për vitin 2021 shtesat dhe paksimet paraqiten si më posht:

000/lekë

Llogaria Ekonomike që Buxhetohet	Buxheti Fillestar	Ndryshimet gjatë vitit		Buxheti Total Plani	Buxheti Total Fakti
		Shtesa	Paksime		
600	21,400	-	-	21,400	15,695
601	3,600	-	-	3,600	2,579
602	40,000		226	39,974	10,507
604	8,000		8,000	-	-
606	-	226	-	226	24
231	2,000	-	1,000	1,000	897
Totali	75,000	226	9,226	66,200	29,702

Konkluzoni:

Duke analizuar performancën e buxhetit për vitet 2019-2020-2021 rezulton se, nga ana e institucionit ka një menaxhim dhe pune relativisht të mirë, në planifikim dhe realizimin e planit të buxhetit.

Shkalla e shfrytëzimit të fondeve të buxhetit është nën ndikimin e herpashershëm të ndryshimit të (Nëpunësit zbatues) dhe nuk mbështetet në argumentime të sakta planifikimi.

Vlen të theksohet se në vitin 2021 performanca buxhetore pasqyrore përmirësim të kënaqshëm, por problematikat e hasura ndër vite duhet të reflektohet plotësisht dhe duhet të ndikojnë pozitivisht në performancën buxhetore si dhe në përmbushjen e objektivave të institucionit.

Rekomandojmë që, nga ana e institucionit të evidentohen shkaqet dhe përgjegjësitë e mos realizimit të buxhetit të miratuar, me qëllim që të reflektohet plotësisht performanca buxhetore në përmbushjen e objektivave të institucionit.

2.3. Analizë e realizimit të planit buxhetor. Analizë e plotë e buxhetit sipas viteve objekt auditimi.

Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Analizë e detajuar plan fakt. përqindja për periudha të njëjta kohe, për investimet, pagat, shpenzimet korrent, etj. Nxjerrja e përgjegjësisë për deviacionet.

Zbatimi i buxhetit sipas artikujve.

000/lekë

Nr. llog	Emërtimi i shpenzim	VITI 2019			VITI 2020			Viti 2021		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
600	Paga	10.100	4.869	48.2	18.500	10.191	55	21.400	15695	73.3
601	Sigurime shoqërore	1.800	666	37	3.200	1681	52.5	3.600	2.579	71.5
602	Shpenzimeoperative	20.000	8.487	42.4	15.700	5.267	33.5	39.974	10.504	26.3
604	“Transferime Korrente të Brendshme”.	8.000	0	0	8.000	0	0	0	0	0
606	Transferita per buxhet familjar	100	0	0	100	-	0	226	24	10.6
231	Investime	3.000	2.292	76.4	0	0	0	1.000	867	90
	TOTALI	43.000	16.314	38	45.500	17.140	38	66.200	29.702	44.3

Në bazë të tabelës së mësipërme konkludojmë se përqindja e realizimit ndër vite e fondeve buxhetore nuk është në nivelet e duhura. Vlen të theksohet se për periudhën objekt auditimi konstatojmë një përqindje të ulët të realizimit të zërve buxhetor dhe me specifikiisht artikulli 602.” Shpenzime operative”.

Gjetje:Nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas Tiranë ,(Drejtoria e Financës) në gjykimin e grupit të auditimit theksojmë se në lidhje me realizimit e zërve buxhetor për vitin 2019-2020-2021, konkretisht artikulli **602** “Shpenzime operative”, është **realizuar respektivisht 42.4 % për vitin 2019, viti 2020 është realizuar 33.5% dhe për vitin 2021 është realizuar 26.3% ,fakt që tregon performancë relativisht të ulët**, për ndjekjen dhe realizimin sistematik të fondeve të planifikuar për vitin ushtrimor. Ky artikull duhet të mbështetet në argumentime më të qarta dhe të sakta planifikimi.

Nga intervista e marë nga Drejtoresha e Financës ajo sqaroi se në këtë artikull një peshë specifike të madhe zenë shpenzimet gjyqësore, të cilat nuk realizohen të gjitha sa janë planifikuar, brenda vitit ushtrimor. Si rrjedhojë realizimi i këtij artikulli është në nivele të ulta. Grupi i auditimi kërkoi reflektimin e problematikave të hasura dhe rritjen e shkallës së bashkëveprimit ndërmjet Drejtorive të këtij institucioni për planifikimin e saktë të artikullit “Shpenzime operative”

Rekomandim:Drejtoria e financës në NJF duhet të menaxhoj me efektivitet situatën në përdorimin e fondeve buxhetore vjetore duke ju përgjigjur nevojave reale të institucionit. Ky institucion duhet të bashkërendojë punën me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Drejtësisë duke siguruar standartet e nevojshme të sistemit buxhetor.

Gjetje: Për vitin 2019, plani i buxhetit i miratuar me ndryshime, është në shumën **43,000,000 lekë**, është realizuar në shumën **16,313,158 lekë**, ose **38%**, me mosrealizim prej **26,686,842 lekë**. Për vitin 2020, plani i buxhetit i miratuar me ndryshime, është në shumën **45,500,000 lekë**, është realizuar në shumën **17,139,586 lekë**, ose **38%**, me mosrealizim prej **28,360,414 lekë**. Mungesat

në stafin e institucionit si dhe problematikat e hasura në këtë institucion nga ristrukturimi kanë lidhje me ecurinë, ndjekjen dhe realizimin e performancës buxhetore. Gjithashtu ka ndikuar edhe **situata konkrete e** pandemisë globale të krijuar nga COVID-19, për këtë arsye procedurat e prokurimit janë ndërprerë për një periudhë të tejjgjatur, por grupi i auditimit këshilloi ndjekjen në të ardhmen me efektivitet e përgjegjësi të realizimit të zerave buxhetor.

Rekomandim: Nga DNJF-ja të evidentohen shkaqet dhe përgjegjësitë e mosrealizimit të buxhetit të miratuar, me qëllim që të reflektohet plotësisht performanca buxhetore në përmbushjen e objektivave të institucionit.

Konkluzion:

Spektori i financës në këtë institucion duhet të menaxhoj me efektivitet situatën në përdorimin e fondeve vjetore, ndjekjen dhe realizimin sistematik të çdo artikulli buxhetor konkretisht shpenzimet gjyqësore të cilat kanë një peshë specifike të madhe në shpenzimet buxhetore dhe situacionin e shpenzimeve të mos e shikojë vetëm si një tabelë përmbledhëse, por si analizë për të nxjerr shkaqet dhe pasojat me qëllim, realizimin e fondeve buxhetore, si dhe përmbushjen e objektivave të institucionit në kohën e duhur.

Gjatë të procesit të auditimit u konstatua se në këtë institucion në situacionin e shpenzimeve të buxhetit për vitet 2019 ,2020 dhe 2021 pasqyroheshin edhe fondet si “Shpenzime kapitale me financim të huaj” .

Konkretisht :

Për vitin 2020, plani i fondeve me financim të huaj i miratuar, është në shumën 7,792 mijë lekë, është realizuar në shumën 2,513mijë lekë, ose 32.3%, me mosrealizim prej 5,279 mijë lekë.

Për vitin 2021, plani i fondeve me financim të huaj i miratuar, është në shumën 15,254 mijë lekë, është realizuar në shumën 12,669 mijë lekë, ose 83.1%, me mosrealizim prej 2,585 mijë lekë.

Në korrik të vitit 2020 u nënshkrua Letra e parë e Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe ADA për hapjen e 5 Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore dhe rivitalizimin e 3 qendrave të hapura nga UNDP në bashkëpunim me Organizatat jofitimprurëse.

Granti i dhënë nga UNDP konsiston në mbulimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të 2 punonjësve për çdo qendër. Qendrat janë vendosur pranë Bashkive, Gjykatave dhe ADISA, pa kundërshpërblim sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga Ministria e Drejtësisë / Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Gjithashtu për vitin 2021 vlera prej 809 mijë lekë është planifikuar për shpenzime operative në këtë institucion dhe është realizuar në shumën 342 mijë lekë.

Opinion: Në lidhje me planifikimin, detajimin e fondeve si dhe rishpërndarjes së fondeve buxhetore, në DNJF sistemi në përgjithësi është në përputhje me kriteret e paracaktuara (kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi).

Gjetjet për sistemin e përdorimit të fondeve buxhetore do të trajtohen sipas formatit të mëposhtëm:

Titulli i Gjetjes: Mosndjekja me përgjegjësi e fondeve të akorduara për mallra e shërbime si dhe cilësi jo e mirë e përdorimit të fondeve buxhetore sipas artikujve buxhetor.

Gjetje Nr. 4	
(Subjekti i Audituar)	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Tiranë ,(Drejtoria e Financës) në (DNJF)
(Njësitë/subjektet e interesuar nga gjetja)	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Tiranë Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr.9, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ligjet respektive vjetore si dhe udhëzimet e dërguara nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë Ligji nr.88/2019, datë 18.12.2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Neni 4 Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë: a) transparencë, parashikueshmëria, gjithëpërfshirja, uniteti dhe universaliteti në menaxhimin e sistemit buxhetor e të fondeve speciale; c)shpërndarja e burimeve, në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Ministrave; ç) përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike; d) përgjegjësi të qarta për menaxhimin operacional; dh) respektimi me rreptësi i tërësisë së procesit.
Përshkrimi i detajuar i gjetjes	Nga ana e D.N.J.F-së Tiranë ,(Drejtoria e Financës) në gjykimin e grupit të auditimit theksojmë se në lidhje me realizimit e zërve buxhetor për vitin 2019-2020-2021, konkretisht artikulli 602 “Shpenzime operative”, është realizuar respektivisht 42.4 % për vitin 2019, viti 2020 është realizuar 33.5% dhe për vitin 2021 është realizuar 26.3%, <i>fakt që tregon performancë relativisht të ulët</i> , të realizimit të këtij artikulli,si dhe ndjekjen dhe realizimin jo sistematik të fondeve të planifikuara për vitin ushtrimor. Ky artikull duhet të mbështetet në argumentime më të qarta dhe të sakta planifikimi. Shkalla e shfrytëzimit të fondeve të buxhetit është nën ndikimin e herpashershëm të ndryshimit të (Nëpunësit zbatues) dhe nuk mbështetet në argumentime të sakta planifikimi.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Duke analizuar performancën e buxhetit për periudhën e Auditimit, rezulton se, nga ana e institucionit ka një menaxhim dhe punë jo koherente, në planifikim dhe realizimin e planit të buxhetit. Shkalla e shfrytëzimit të fondeve të buxhetit është nën ndikimin e herpashershëm të ndryshimit të (Nëpunësit zbatues) dhe nuk mbështetet në argumentime të sakta planifikimi. Nga ana e Institucionit, të evidentohen shkaqet dhe përgjegjësitë e mos realizimit të buxhetit të miratuar, me qëllim që të reflektohet plotësisht performanca buxhetore në përbushjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi	Drejtoria e financës në DNJF duhet të menaxhoj me efektivitet situatën në përdorimin e fondeve buxhetore vjetore duke ju përgjigjur nevojave reale të institucionit. Ky institucion duhet të bashkërendojë punën me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Drejtësisë duke siguruar standartet e nevojshme të sistemit buxhetor.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Korrik 2022 e në vazhdim
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	<p>Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, sqarohet gjithë situata e krijuar e cila është përshkruar qart dhe në projekt raportin e auditimit, si dhe nënvizon se fondet e çelura për vitin 2021, janë planifikuar në projekt-buxhetin e vitit 2020 dhe nëpunësi zbatues që ka menaxhuar fondet buxhetore për vitin 2021 nuk ka marrë pjesë në planifikimin e tyre, por vetëm në realizimin e fondeve. Grupi i punës edhe një herë thekson se përqindja e ulët e realizimit të artikullit 602 për vitin 2021 në masën 26.6% nuk demonstron arritjen e objektivave të institucionit duke u mbështetur në argumenta jo produktiv. Buxheti i shtetit në fund të vitit ushtrimor nuk është përdorur mirë dhe duhet të rikujtojmë se shuma 29,470 mijë lekë, pasqyron në vetvete keqmenaxhim të buxhetit të shtetit dhe në rast se ju si institucion do realizoni objektivat duke mos i përdorur fondet e rakorduara nga buxheti i shtetit nuk është mënyra e duhur për realizimin e objektivave)</p> <p>-Efektiviteti është aftësia për të zgjedhur objektivat e përshtatshme dhe mjetet e duhura për arritjen e tyre. Efektiviteti do të thotë ti bësh gjërat që duhen në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur.</p>
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, "Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2 datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë", protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marrë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë: Ky observacion është përpiluar në formën e një sqaruese, ku grupit të auditimit ju referua edhe në periudhën e auditimit në këtë institucion, në disa raste nuk është kuptuar dhe thelbi i gjetjes dhe si rrjedhojë nuk sjellin argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

Titulli i Gjetjes: Në përdorimin e fondeve buxhetore sipas artikujve buxhetor.
Viti 2019-2020.

Gjetje Nr. 5	
(Subjekti i Audituar)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë (Drejtoria e Financës) në (DNJF)
(Njësitë/subjektet e interesuar nga gjetja)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë Ministria e Drejtësisë

Përmbledhja e bazës ligjore	<p>Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr.9, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ligjet respektive vjetore si dhe udhëzimet e dërguara nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë Ligjit 88/2019, datë 18.12.2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Neni 4 Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë: c) shpërndarja e burimeve, në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Ministrave; ç) përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike; dh) respektimi me rreptësi i tërësisë së procesit.</p>
Përshkrimi i detajuar i gjetjes	<p>Nga ana e D.N.J. F-së Tiranë, (Drejtoria e Financës) në gjykimin e grupit të auditimit theksojmë se për vitin 2019, plani i buxhetit i miratuar me ndryshime, është në shumën 43,000,000 lekë, është realizuar në shumën 16,313,158 lekë, ose 38%, me mosrealizim prej 26,686,842 lekë. Për vitin 2020, plani i buxhetit i miratuar me ndryshime, është në shumën 45,500,000 lekë, është realizuar në shumën 17,139,586 lekë, ose 38%, me mosrealizim prej 28,360,414 lekë. Mungesat në stafin e institucionit si dhe problematikat e hasura në këtë institucion nga ristrukturimi kanë lidhje me ecurinë, ndjekjen dhe realizimin e performancës buxhetore. Gjithashtu ka ndikuar edhe situata konkrete e pandemisë globale të krijuar nga COVID-19, për këtë arsye procedurat e prokurimit janë ndërprerë për një periudhë të tejzgatur, por grupi i auditimit këshilloi ndjekjen në të ardhmen me efektivitet e përgjegjësi të realizimit të zerave buxhetor.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	<p>Duke analizuar performancën e buxhetit për periudhën e auditimitvitin, rezulton se shkalla e shfrytëzimit të fondeve të buxhetit është nën ndikimin e herpashershëm të ndryshimit të (Nëpunësit zbatues) dhe nuk mbështetet në argumentime të sakta planifikimit buxhetoreqë ka si objekt kryesor përmbushjen e objektivave të institucionit. Vlen të theksohet se në këtë situat ka ndikuar risku i lartë që ka pasur ky institucion në momentin që është ristrukturuar dhe stabilizimit të punës në nivelet e duhura. Drejtoria e Financës, duhet të ndjek më me korrektësi realizimin e buxhetit, dhe</p>

	situacionin e shpenzimeve të mos e shikojë vetëm si një tabelë përmbledhëse, por si analizë për të nxjerr shkaqet dhe pasojat me qëllim, realizimin e fondeve buxhetore, si dhe përmbushjen e objektivave të institucionit në kohën e duhur.
Rekomandimi	Nga DNJF-ja të evidentohen shkaqet dhe përgjegjësitë e mosrealizimit të buxhetit të miratuar, me qëllim që të reflektohet plotësisht performanca buxhetore në përmbushjen e objektivave të institucionit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Korrik 2022 e në vazhdim
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, sqarohet gjithë situata e krijuar e cila është përshkruar qart dhe në projekt raportin e auditimit, si dhe nënvizonë do mari të gjitha masat në lidhje me sigurimin e standarteve e nevojshme të sistemit buxhetor. <i>(bashkëlidhur korrespondenca për justifikimin në lidhje me gjetjen e sipërcituar, ku theksojmë se grupit të auditimit janë vënë të gjitha më parë në dispozicion)</i>
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2 datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë”, protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marrë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë: Ky observacion është përpiluar në formën e një sqaruese, ku grupit të auditimit ju referua edhe në periudhën e auditimit në këtë institucion dhe si rrjedhojë nuk sjellin argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

3.Sistemit të prokurimeve dhe i blerjeve me vlera të vogla.

Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore për blerjet me vlera të vogla, për periudhën 01.05.2019 deri më 31.12.2021.

Grupi i audituesve u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore, ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, udhëzimin e APP-së nr. 1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe çdo akti juridik që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Dokumentat e audituara:

- Regjistri i parashikimit të blerjeve
- Regjistri i realizimit të blerjeve
- Urdhrat e ngritur nga titullarët për blerjet e vogla sipas periudhave, urdhrat e komisionit të marrjes së mallit në dorëzim.
- Procedurat e prokurimit në rrugë elektronike për blerjet me vlera të vogla.

Ishte hartuar regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet publike, si dhe raportimi i realizimit të prokurimeve për vitin 2019,2020,2021 sipas udhëzimeve të A.P.P.-së. Gjatë periudhës 01.05.2019 deri më 31.12.2021, janë zhvilluar procedura prokurimi për blerjet me vlera të vogla dhe investime me vlerë totale **5,334,993** lekë me TVSH, përkatësisht sipas viteve që paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr	Viti	Art	Parashikuar Sipas fondit limit	Realizim nga Buxheti	Fondi I perealizuar	Realizimi %
1	2019	602	1,320,000	158,467	-1,163,533	12 %
		231	3,000,000	2,292,240	-707,760	76.4%
2	2020	602	3,155,231	1,132,959	-2,022,272	36 %
		231	-	-	-	-
3	2021	602	3,785,408	853,367	-2,932,041	22.5 %
		231	2,919,996	897,960	-2,022,036	30.7%
	Totali		14,180,635	5,334,993	-8,847,642	37.6%

Gjetje: Për periudhën e audituar u konstatua se niveli i përqindjes së realizimit të artikullit 602 (Mallra dhe shërbime) dhe 231(Investime), nuk janë në nivele të kënaqshme. Gjithashtu, në total shkalla e përqindjes së realizuar është 37.6 %. Në këtë situatë ka ndikimin e saj negativ situata e rënduar e krijuar nga pandemia globale , rishikimi i institucionit **si dhe risku që është përballur ky institucion nga ndryshimi i nëpunësve zbatues.** Por pavarësisht kësaj situatë, Njësia e prokurimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e financës duhet të ndjekin me përgjegjësi procesin e realizimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike.

Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (Njësia e prokurimeve) në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave të marrë masa për realizimin e procedurave të mallrave dhe investimeve, në mënyrë që të zbatojnë me rigorozitet realizimin faktik të tyre, shërbimeve apo mallrave, si dhe likuidimin e tyre në mënyrë periodike, me qëllim realizimin dhe likuidimin e tyre në kohë gjatë gjithë vitit buxhetor, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj.

Konkluzioni: Njësia e prokurimeve në bashkëpunim me strukturat mbështetëse, duhet të kryej me përgjegjësi realizimin me sukses të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe ndjekjen e këtyre zërave që të eliminojë ndikimin negativ të performancës buxhetore si dhe efijencën e monitorimin të fondeve.

Audituesit, kanë përzgjedhur procedura prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, ose blerjeve të vogla, pasi u konstatua se për periudhën e audituar kanë dominuar shumë procedurat me blerje të vogël dhe nën 100 mijë lekë. Puna jonë pasqyrohet duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit, në hartimin dhe njoftimin e regjistrit të prokurimit publik, argumentimin e kërkesës për blerje, llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit; kualifikim, miratimi i dokumentave standarde të tenderit; paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave; vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE); menaxhimi i procesit të ankimit në rast se ka), pjesëmarrësit në proces; njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj, si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

Më poshtë po paraqesim të dhënat mbi procedurën e prokurimit:

Audituesit, kanë përzgjedhur procedura prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, ose blerjeve të vogla.

Për vitin 2019, u konstatua se:

Me Urdhrin nr.420, datë 23.08.2019 të Ministrit të Drejtësisë është përcaktuar qartë se për vitin 2019, me qëllim mbarëvajtjen e punës se institucionit të DNJF në mungesë të Titullarit dhe të stafit, procedurat e prokurimit të parashikuara në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2019, do të zhvillohen nga sektori i prokurimeve në aparatit të Ministrisë së Drejtësisë deri në plotësimin e vendeve vakant në këtë institucion.

Me urdhërin nr.106 prot., datë 31.10.2019 është ngritur komisioni për prokurimin e blerjeve të vogla për vitin 2019 i përbërë nga:

- 1- Ornela Ferhati Kryetare
- 2- Suela Qevani Anëtar
- 3- Klejda Poçi Anëtar

Me urdhërin nr. 100 prot, datë 31.10.2019 është ngritur Komisioni i mbi marrjen në dorzim të aktiveve për vitin 2019 i përbërë nga:

- 1- Xhulia Mulla Kryetare

- 2- Erisjan Gripshi Anëtar
3- Patricia Pogaçe Anëtare

Nga auditimi, u konstatua se, **për vitin 2019** janë kryer këto procedura tenderuese:

Për periudhën e audituar u konstatua se niveli i përqindjes së realizimit të artikullit 602 është në nivele relativisht të ulët, nisur dhe nga situatat e krijuar nga pandemia globale dhe nga tërmeti i Nëntorit 2019. Për vitet 2020-2021 niveli i realizimit i artikullit 602 është në të njëjtat nivele 36-22.5 % të planit të parashikimeve. Gjithashtu në total shkalla e përqindjes së realizuar është 37.6%. Audituesit, kanë përzgjedhur procedurë prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, ose blerjeve të vogla. Nga auditimi, u konstatua se **për vitin 2019** janë kryer këto procedura tenderuese:

-Marrëveshje kuadër (1) procedura, në vlerën prej 1,860,240 lekë me tvsh.

Kjo marrëveshje përfaqëson një procedurë prokurimi “Blerje pajisje elektronike e cila është zhvilluar nga AKSHI.

-Blerje me vlerë të vogël janë planifikuar (1) procedurë, në vlerën 432,000 lekë me tvsh, e cila është zhvilluar nga Ministria E Drejtësisë.

-Blerje me vlerë të vogël janë planifikuar (3) procedura, në vlerën 1 080 000 lekë me tvsh, por nuk u realizua.

-Blerje me vlerë nën 100,000 mijë lekë(2) procedura, në vlerën prej 158,467 lekë me tvsh,

Konkretisht:

1. “Blerje nën 100,000lekë

-Procedura me objekt “Blerje dokumentacioni për funksionin e zyrave”, për DNJF planifikuar në shumën 120.000 lekë është realizuar në shumën 65,664 lekë.

-Procedura me objekt “Blerje materiale kancelarike” planifikuar në shumën 120.000 lekë është realizuar në shumën 92,803 lekë.

2.Blerje me vlerë të vogël

- Blerje me vlerë të vogël është planifikuar në shumën 750,000 (1) procedurë, në vlerën 432,000 lekë me tvsh, e cila është zhvilluar nga Ministria E Drejtësisë.

3.Marrëveshje kuadër (1) procedura, në vlerën prej 1,860,240 lekë me tvsh.

Kjo marrëveshje përfaqëson një procedurë prokurimi “Blerje pajisje elektronike e cila është zhvilluar nga AKSHI.

VITI 2020

Me urdhrin nr.21, datë 09.01.2020 është ngritur Komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2020 i përbërë nga:

- 1- Ilberjan Durmishi Kryetar
2- Etleva Zeqiraj Anëtare
3- Patricia Pogaçe Anëtare

Me urdhrin nr.21/1, datë 10/07/2020 është ngritur Komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2020 i përbërë nga:

- | | | |
|-------------|----------|---------|
| 1- Ilberjan | Durmishi | Kryetar |
| 2- Etleva | Zequiraj | Anëtare |
| 3- Erisian | Gripshi | Anëtare |

Me urdhrin nr.301, datë 30/07/2020 është ngritur Komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2020 i përbërë nga:

- | | | |
|-------------|----------|---------|
| 1- Ilberjan | Durmishi | Kryetar |
| 2- Kristi | Petrela | Anëtare |
| 3- Xhulia | Mullai | Anëtare |

Kostatim 1.1: Urdhri nr.301, datë 30.07.2020 për ndryshimin e antarëve të komisionit të blerjeve të vogla ka dal si rezultat se dy nga antarët e komisionit të blerjeve të vogla kanë marrë lejen e zakonshme. Kjo mënyrë e trajtimit të komisionit të blerjeve të vogla është përdorur në mënyrë të përsëritur për vitin 2020-2021. Kjo praktikë mund të ndodhë në kushtet e largimit të punonjësve nga institucioni ose të transferimit të punonjësit, ose për një sëmundje të gjatë, por jo për shkak të marrjes së lejes së zakonshme, si veprime me risk dhe jo eficient i punës, në lidhje me njësinë e prokurimit duke lënë hapësira për gabime.

Konkluzion: Këshillojmë që praktika të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen.

Me urdhërin nr. 204 prot., datë 19.06.2020 është ngritur Komisioni i mbi marrjen në dorëzim të aktiveve për vitin 2020 i përbërë nga:

- | | | |
|--------------|--------|----------|
| 1- Fatbardha | Fiku | Kryetare |
| 2- Klejda | Poçi | Anëtar |
| 3- Suela | Qevani | Anëtare |

E njëjta procedure është ndjekur edhe për ndryshimin e antarëve të Komisionit mbi marrjen në dorëzim të aktiveve si rezultat se antarët e këtij komisioni kanë marrë lejen e zakonshme.

Nga auditimi, u konstatua se, për vitin 2020 janë kryer këto procedura tenderuese:

-Blerje me vlerë të vogël (6) procedura, në vlerën 506,979 lekë pa tvsh ose 608,375 lekë me tvsh,

-Blerje me vlerë nën 100,000 mijë lekë(20) procedura, në vlerën prej 384,180 lekë pa tvsh,ose 461,016 lekë me tvsh,

Për vitin 2020, u audituan me zgjedhje disa procedura prokurimi “Blerje e vogël” si më poshtë:

1. “Blerje nën 100,000lekë

-Procedura me objekt “Blerje mirëmbajtje ndertese”, Vlera e realizuar është në shumën 63,250 lekë pa tvsh dhe në shumën 75,900 lekë me tvsh”.

-Procedura me objekt “Mirëmbajtje aparate pajisje elektronike” planifikuar në shumën 120.000 lekë është realizuar në shumën 30,000 lekë.

Kjo procedurë është zhvilluar për riparimin dhe mirëmbajtjen e kondicionereve.

-Procedura me objekt “shërbime e internetit”, planifikuar në masën 120,000 lekë me tvsh, është realizuar në masën 102,199 lekë me tvsh.

-Procedura me objekt “shërbimi i dizifektimit”, planifikuar në masën 120,000 lekë me tvsh, është realizuar në masën 67,770 lekë me tvsh

-Procedura me objekt “materiale per mbrojtje personale anti covid-19”, blerje emergjente, është realizuar në masën 63,600 lekë me tvsh.

3.Blerje me vlerë të vogël

-Procedura me objekt “Blerje materiale per mbrojtje personale anti kovid-19” me fond limit 142,000 lekë, vlera e realizimit në shumën 170,400 lekë.

- Procedura me objekt “Blerje materiale “kancelarike” me fond limit 130,929 lekë, vlera e realizimit në shumën 157,115 lekë.

- Procedura me objekt “ Blerje materiale për funksionin e zyrës”, fond limit 63,250 lekë, e realizuar në shumën 75,900 lekë .

-Procedura me objekt “Blerje materiale marketingu” për procesin e informimit dhe me njohjen e Ndihmes Juridike Falas . Planifikuar në shumën 219,000 lekë (Fondi limit) dhe është realizuar në shumën 262,800 lekë.

VITI 2021

Me urdhërin nr.1, datë 11.01.2021 është ngritur Komisioni i blerjeve të vogla për vitin 2021 i përbërë nga:

1- Ilberjan	Durmishi	Kryetar
2- Kristi	Petrela	Anëtare
3- Erisian	Gripshi	Anëtare

Me urdhërin nr.15, datë 18.02.2021 është bërë ndryshimi i Komisionit i blerjeve të vogla për vitin 2021 i përbërë nga:

1- Ilberjan	Durmishi	Kryetar
2- Kristi	Petrela	Anëtare
3- Irma	Alushaj	Anëtare

Me urdhërin nr. 2 datë 11/01/2021 është ngritur Komisioni i mbi marjen në dorëzim të aktiveve për vitin 2021 i përbërë nga:

1- Suela	Qevani	Kryetare
2- Klejda	Poçi	Anëtar
3- Xhulia	Mulla	Anëtare

Me urdhërin nr. 156, datë 16/11/2021 është bërë ndryshimi i Komisionit mbi marjen në dorëzim të aktiveve për vitin 2021 i përbërë nga:

- | | | |
|-------------|--------|----------|
| 1- Suela | Qevani | Kryetare |
| 2- Klejda | Poçi | Anëtar |
| 3- Katerina | Jano | Anëtare |

Për vitin 2021 janë kryer këto procedura tenderuese:

-Blerje me vlerë të vogël (13) procedura, në vlerën 820,967 lekë me tvsh,

-Kancelari, realizuar në shumën 246,600 lekë.

-Materiale për pajisje zyre (Tonerat) realizuar në shumën 208,380 lekë

- Materiale te nevojshme per mbrojtje personale në shumën 50,399 lekë

-Materiale Pastrimi, realizuar në shumë 69,240 lekë

-Shtypshkrime printime, realizuar në shumë 246,348 lekë

-Blerje me vlerë nën 100,000 mijë lekë (3) procedura, në vlerën prej 32,400 lekë me tvsh,

Konkretisht:

1. "Blerje nën 100,000lekë"

1.Për sa i përket blerjeve nën 100 mijë lekë, ato konsistojnë në lidhje me nën artikujt buxhetor konkretisht: "Furnitura për funksionimin e zyrave", "Mirmbajtje e pajisjeve kompjuterike", janë 3 procedura prokurimi "**blerje nën 100,000 lekë**", për të plotësuar nevojat e institucionit. Këto procedura janë kryer konform nenit 40, kreu IV, nenit 8, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "**Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**", i ndryshuar ku thuhet se: "*Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur*".

2.Blerje me vlerë të vogël

-Procedura me objekt "Blerjemateriale kancelarike", për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas është në shumën 246,600 lekë

Procedura është kryer mbështetur në kërkesën e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, për evidentimin e nevojave të punonjësve. Procedura janë kryer data 09.02.2021, data 02.07.2021 si dhe në datën 22.12.2021.

-Procedura me objekt "Blerje materiale pastrimi" për nevojat e DNJF, me fond të planifikuar në shumën 200,000 lekë dhe është realizuar në shumën 69,240 lekë.

Procedura është kryer mbështetur në kërkesën e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, për evidentimin e nevojave në këtë institucion . Procedura jane kryer në datën 11.02.2021 si dhe në datën 22.09.2021.

-Në lidhje me shpenzimet të përcaktuara për “Shpenzime për materiale të nevojshme për mbrojtje personale” në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik për vitin 2021 është planifikuar në shumën 400.000 lekë (Fondi limit) dhe është realizuar në shumën 50,399 lekë. Komisioni ka kryer procedurën e prokurimit elektronik më datë 19.03.2021 .

-Nën artikulli buxhetor “Boje per pritera”, është planifikuar në shumën 500,000 lekë (regjistër parashikimesh) dhe është realizuar në shumën 246,348 lekë. Procedura është kryer mbështetur në kërkesën e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, për evidentimin e nevojave në këtë institucion . Procedura jane kryer në datën 23.06.2021 si dhe në datën 18.10.2021.

Për sa i përket Investimeve procedurat janë kryer për:

-Nën artikulli buxhetor “Investime për fotokopje , printera dhe paisje” në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik për vitin 2021 është planifikuar në shumën 800,000 lekë (Fondi limit) dhe është realizuar në shumën 580,080 lekë .

-Nën artikulli buxhetor “Investime për blerje orendi dhe pajisje per mobilim zyrash” në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik për vitin 2021 është planifikuar në shumën 800,000 lekë (Fondi limit) dhe është realizuar në shumën 317,880 lekë ,

Audituesit, kanë përzgjedhur procedura prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, ose blerjeve të vogla, pasi u konstatua se për periudhën 2019-2020-2021 janë procedura blerje të vogël dhe nën 100,000 mijë leke. Puna jonë pasqyrohet duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit, në hartimin dhe njoftimin e regjistrit të prokurimit publik, argumentimin e kërkesës për blerje, llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit; paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave; vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE); njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj, si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

Konkluzioni:

Për sa më sipër nuk u konstatuan problematika te rëndësishme, pasi këto procedura janë kryer konform Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, kreu IV, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi Përdorimin e Proçedurës së Prokurimit me Vlerë të Vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikë”, të ndryshuar

Konstatim 1.2: Nga auditimi u konstatua se në regjistrat e realizimeve të prokurimit publik për periudhën e audituar, të pasqyruara grupit të auditimit, konstatohet shkalla e ulët e realizimit të mallrave të prokurueshme, kjo për arsye të situatës së vështirë të tërmeti dhe pandemisë si dhe

ristrukturimi i institucionit , por në asnjë rast nuk e justifikon mosrealizimin e objektivave kryesore të institucionit ku një vend të rëndësishëm zë edhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore të prokurueshme. **Njësia e prokurimeve** në bashkëpunim me drejtorinë e financës duhet të ndjekin me përgjegjësi këtë fenomen, pasi kjo situat ndikon negativisht ne performancën financiare të DNJF-së.

Këshillohet të studiohet me përgjegjshmëri procesi i plotësimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe ndjekja me efikasitet e tij.

Konkluzioni: Njësia e prokurimeve në bashkëpunim me strukturat mbështetëse, duhet të kryej me përgjegjësi realizimin me sukses të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe ndjekjen e këtyre zërave që të eliminojë ndikimin negativ të performancës buxhetore si dhe efincencën e monitorimin të fondeve.

Për sa i përket procedurave të vitit 2019-2020-2021, **“blerjet nën 100,000lekë”**, janë kryer konform nenit 40, kreu IV, **nenit 8, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014**“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku thuhet se: *“Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur”*.

Shpenzimit janë kryer për: Shërbim mirmbajtje printeri, blerje dokumentacioni, shërbimi i dizenfektimit, material për dizenfektim, etj.

Konkluzioni:

Për sa i përket blerjeve me vlera te vogla nuk u konstatuan problematika pasi këto procedura janë kryer konform Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, kreu IV, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi Përdorimin e Proçedurës së Prokurimit me Vlerë të Vogël “i ndryshuar dhe zhvillimin e saj me mjete elektonike”.

Gjetjet në formë tabelore për sistemin e prokurimeve dhe i blerjeve me vlera të vogla.

Titulli i Gjetjes: Mosndjekja me përgjegjësi e fondeve të akorduara për mallra e shërbime të prokurueshme, si dhe realizimi i fondeve të parashikuara në regjistrin e prokurimeve nuk janë realizuar në kohë.

Gjetje Nr. 6	
(Subjekti i Audituar)	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas , Tiranë ,(Drejtoria e Financës si dhe Njësia e prokurimit) në (DNJF)
(Njësitë/subjektet e interesuar nga gjetja)	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Tiranë Ministria e Drejtësisë

Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Neni 1 2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
Përshkrimi i detajuar i gjetjes	Nga auditimi është evidentuar shkalla e ulët e realizimit të mallrave të prokurueshme në masën 37.6%, duke u krahasuar me nivelin e planifikimit (me ndryshime) që pasqyrohet në tabelën e mësipërme. Gjithashtu evidentohet, fenomeni i përqëndrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor, e cila ka ardhur si rezultat (efektet) i zvarritjes së procedurave të prokurimit, të realizimit të investimeve publike në kohë, likuidimi i tyre brenda vitit ushtrimor.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Njësia e prokurimeve në bashkëpunim me strukturat mbështetëse, duhet të kryej me përgjegjësi realizimin me sukses të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe ndjekjen e këtyre zërave që të eliminojë ndikimin negativ të performancës buxhetore si dhe efikasitetin e monitorimin të fondeve buxhetore.
Rekomandimi	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas(Njësia e prokurimeve) në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave të marrë masa për realizimin e procedurave të mallrave dhe investimeve, në mënyrë që të zbatojnë me rigorozitet realizimin faktik të tyre, shërbimeve apo mallrave, si dhe likuidimin e tyre në mënyrë periodike, me qëllim realizimin dhe likuidimin e tyre në kohë gjatë gjithë vitit buxhetor, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Menjëherë e në vazhdim
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, pranohet fakti i konstatuar.(bashkëlidhur korrespondenca për justifikimin në lidhje me gjetjen e sipërcituar, ku theksojmë se grupit të auditimit janë vënë të gjitha më parë në dispozicion)
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2

datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë”, protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marrë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë: Ky observacion nuk sjell argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.

Rishikimi i statusit të gjetjes

Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

4. Sistemi i Financiar dhe Deklarata Financiare.

4.1 Auditimi i Rregjistrimeve Kontabël dhe i Librave të Kontabilitetit.

U realizua auditimi për periudhën 01.05.2019 deri më 31.12.2021, në lidhje me regjistrat e veprimeve të kontabilitetit dhe rezultoi se, mbaheshin në rregull konform ligjit. Institucioni kishte regjistrin e pagave, ku regjistroheshin të gjitha veprimet me pagat e punonjësve, regjistrin e veprimeve me thesarin, regjistrin e veprimeve me magazinën. Këto regjistra ishin të gjithë të kuadruar në fund të periudhës raportuese. Në nxjerrjen e bilancit specialist i financës, mbështetej tek të dhënat që dispononte libri i madh.

Pasqyrat financiare u dërgohen, strukturës përgjegjëse të thesarit dega Tiranë si dhe Ministrisë së Financës për çertifikimin e llogarive të bilancit në vite duke patur dhe vulën përkatëse, për vitin 2019, sipas shkresës nr. 128 dt 25.03.2020 lënda “Dërgimi i pasqyres financiare të vitit ushtrimor 2019”, për vitin 2020 sipas shkresës nr. 343, datë 30.03.2021 lënda “Dërgohen pasqyrat financiare për vitin 2021”.

Gjithë ditarët dhe librat e kontabilitetit mbaheshin në mënyrë elektronike, dokumenti elektronik rregullohet sipas përcaktimit në nenin 4/26 të Ligjit nr.10296 dhe të nenit 3/1 të Ligjit nr.10 273 datë.29.4.2010 “Për Dokumentin elektronik”.

4.2 Përputhja e Anekseve dhe Pasqyrave Financiare me Bilancin Vjetor.

Baza ligjore dhe dokumenta:

Baza Ligjore: Në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas mbajta e kontabilitetit për vitin 2019, është bërë në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndërsa, struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të Vendimit të KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998” dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Nga auditimi u konstatua se: Pasqyrat financiare vjetore të DNJF për vitin 2019 janë plotësuar në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes

dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe përbëhen nga:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave

Nga auditimi i deklaratave financiare u pa se ato ishin të rakorduara me të dhënat e kontabilitetit dhe pasqyronin gjëndjen financiare të **Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas** në datën e mbylljes të vitit ushtrimor. U konstatua se është proceduar në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin. Ditarët kontabël janë mbajtur në përputhje me këto dispozita.

Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithëshme “rezulton se **bilanci i vitit 2019 përmbledhës është si vijon:**

Po të analizojmë aktivin e bilancit për **vitin ushtrimor 2019** shohim se përbëhej nga Aktivet e Qëndrueshme për të cilat ishte kryer inventar ekonomik.

Gjithashtu në aktivin e bilancit ishin pasqyruar edhe Aktivet Qarkulluese.

Pasqyrat Financiare viti 2019.

Shkresa nr.128 prot, datë 25.03.2020 mbështetur dhe në udhëzimin nr 8 dt 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithëshme”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Dega e thesarit) pasqyrat financiare viti 2019. Me shkresën nr 128/1 dt 14.05.2020 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë pasqyrat financiare të vitit 2019.

Formati nr.1

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

VITI 2019

NJESIA PUBLIKE Drejtoria e Ndihmës Juridike falas

NE / LEKE

Nr. Resht	Referenc e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	AKTIVET	4,671,018	1,000,721
2		I.Aktivët Afat shkurtra	1,963,961	408,505
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	988,564	
6	520	Disponibilitet në thesar	988,564	
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	97,080	
12	31	Materiale	97,080	

21		3.Llogari te Arketushme	878,317	408,505
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	878,317	408,505
47		II.Aktivitet Afat gjata	2,707,057	592,216
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,707,057	592,216
56	218	Inventar ekonomik	2,707,057	592,216
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	1,866,881	408,505
66		I.Pasivet Afat shkurtra	1,866,881	408,505
67		I. Llogari te Pagushme	1,866,881	408,505
69	42	Detyrime ndaj personelit	613,470	278,424
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	50,384	31,432
75	435	Sigurime Shoqerore	183,156	72,628
76	436	Sigurime Shendetstore	25,422	11,684
81	467	Kreditor te ndryshem	994,449	14,337
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,804,137	592,216
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,804,137	592,216
98	101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,707,057	
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	97,080	
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	4,671,018	1,000,721

A. Aktivitet paraqiten në vlerën 4,671,018 lekë.

1. Mjetet monetare (disponilitet në thesar) në shumën 988,564 lekë . Kjo përfaqëson gjëndjen në bankë më dt 31.12.2019 të llogarive bankare.Kjo llogari korenspondon me llogarinë 467 në pasiv dhe përfaqëson gjëndjen në bankë më dt 31.12.2019 të llogarive bankare të grandeve të trashëguara në vitin pasardhës nga ana e organizatave jo qeveritare. *Diferenca 5,885 (994,449- 988,564) lekë përfaqëson një diferencë të pa argumentuar nga ana e institucionit.*
2. Materialet në përfaqësohen në shumën 97,080 lekë, Inventari më dt 31.12.2019 që janë letër A4,Tonera,në shumën 97,080 lekë.

Operacione me shtetin (të drejtat) në shumën 878,317 lekë. Këtu janë futur Llogaria 42 (Detyrime ndaj personelit) në shumën 613,470 lekë. Llogaria 431 (detyrime ndaj shtetit tatim taksa) në shumën 50,384 lekë. Llogaria 435 (detyrimet për sigurimet shoqërore) në shumën 183,156 lekë në total bëjnë **872,432 lekë**, kemi dhe shuma të parashikuara për *Xhvlerësim (-) në shumën 5,885 lekë*. Të gjitha detyrimet e mësipërme janë detyrimet që do paguhesh në muajin janar 2020. Inventari ekonomik llogaria 218 në shumën 2,707,057 lekë. Kjo shumë përfaqëson inventarin e materialeve aktiveve të institucionit më dt 31.12.2019.

Rekomandojme që difektet teknike të konstatuara gjate procesit të kuadrimit të aktivitetit, të mos përsëriten në vazhdimësi në praktikën e inventarizimit të institucionit.

B. Pasivet (Detyrimet) në shumën 1,866,881 lekë.

Llogaria 42 (detyrime ndaj personelit) në shumën 613,470 lekë. Përfaqëson pagat e personelit të muajit dhjetor 2019 të cilat do të paguhen në muajin Janar 2020.

Llogaria 431 (detyrime ndaj shtetit tatim taksa) në shumën 50,384 lekë. Përfaqëson detyrimet e taksave të viit 2019 të cilat do të paguhen në muajin Janar 2020.

Llogaria 435 (detyrimet për sigurimet shoqërore) në shumën 183,156 lekë përfaqëson detyrimet e kontributeve të sigurimeve shëqërore të muajit dhjetor që do të paguhen Brenda dt 20 Janar 2020.

Llogaria 436 (Sigurime shëndetësore) në shumën 25,422 lekë Përfaqëson detyrimet e kontributeve të sigurimeve shëqërore të muajit dhjetor që do të paguhen brenda dt 20 Janar 2020. Llogaria 467 (kreditorë të ndryshëm) në shumën 994,449 lekë. Kjo përfaqëson gjëndjen në bankë më dt 31.12.2019 të llogarive bankare të grandeve të trashëguara në vitin pasardhës nga ana e organizatave jo qeveritare.

C. Fondi i Konsoliduar në shumën 2,804,137 lekë.

Llogaria 101 (Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar) në shumën 2,707,057 lekë

Llogaria 85 (Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore) në shumën 97,080 lekë. Që është ndryshimin i gjëndjes së Inventarit më dt 31.12.2019

D. Totali i pasiveve në shumën 4,671,018 lekë (i barabartë me aktivin).

Pasqyrat Financiare viti 2020.

Shkresa Nr 343, datë 30.03.2021 mbështetur dhe në udhëzimin nr 46 datë 24.12.2020 “Për procedurat e përgatitjes, mbylljes së llogarive vjetore tvitit 2020”.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Dega e thesarit) pasqyrat financiare viti 2020. Me shkresën nr.343/1 prot, datë 10.05.2021 Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë pasqyrat financiare viti 2020.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Formati nr.1

VITI 2020

NJESIA PUBLIKE

NE / LEKE

Nr.	Referenca e	EMERTIMI	Ushtrimi I	Ushtrimi Paraardhes
Reshti	Logarive		Mbyllur	
1	A	AKTIVET	8,800,203	4,671,018
2		I.Aktivet Afat shkurtra	6,851,173	1,963,961
3		I.Mjete monetare dhe ekujalent te tyre	5,279,019	988,564
6	520	Disponibilitet në thesar	5,279,019	988,564
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	206,501	97,080
12	31	Materiale	206.501	97,080

21		3.Llogari te Arketushme	1,365,653	878,317
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	1,365,653	878,317
42		II.Aktivët Afat gjata	1,949,030	2,707,057
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,949,030	2,707,057
56	218	Inventar ekonomik	1,949,030	2,707,057
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	6,644,672	1,866,881
66		I.Pasivet Afat shkurtra	6,644,672	1,866,881
67		I. Llogari te Pagushme	6,644,672	1,866,881
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	20,000	
69	42	Detyrime ndaj personelit	991,869	613,470
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	26,338	50,384
75	435	Sigurime Shoqerore	286,248	183,156
76	436	Sigurime Shendetesore	41,198	25,422
81	467	Kreditor te ndryshem	5,279,019	994,449
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,155,531	2,804,137
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,155,531	2,804,137
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,046,110	2,707,057
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	109,421	97,080
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	8,800,203	4,671,018

A. Aktivët në vlerën 8,800,203 lekë.

- 1 Mjetet monetare (disponibilitet në thesar) në shumën 5,279,019 lekë . Kjo përfaqëson gjëndjen në bankë më dt 31.12.2020 të llogarive bankare të grandeve të trashëguara në vitin pasardhës nga ana e organizatave jo qeveritare.
2. Materialet në shumën 206,501 lekë, Inventari më dt 31.12.2020 që janë letër A4 Tонера,në shumën 206,501 lekë.

Operacione me shtetin (të drejtat) në shumën 1,365,653 lekë.Këtu janë futur Llogaria 42 (Detyrime ndaj personelit) në shumën 991,869 lekë.Llogaria 431 (detyrime ndaj shtetit tatim taksa) në shumën 26,338 lekë.Llogaria 435 (detyrimet për sigurimet shoqërore) në shumën 286,248 lekë detyrime për sig shëndetësore 41,198 lekë, si dhe (Furnitorë) në shumën 20,000 lekë në total bëjnë **1,365,653** , kemi dhe shuma të parashikuara për Inventari ekonomik llogaria 218 në shumën 1,949,030 lekë. Kjo shumë përfaqëson inventarin e materialeve më dt 31.12.2020 me vlerë neto minus amortizimin .

3. Pasivet (Detyrimet) në shumën 6,644,672 lekë.

Llogaria 401-408(Furnitorë) në shumën 20,000 lekë, përfaqson shpenzimet gjyqësore i cili do paguhet në Janar 2021.

Llogaria 42 (Detyrime ndaj personelit) në shumën 991,869 lekë. Përfaqëson pagat e personelit të muajit dhjetor 2020 të cilat do të paguhet në muajin Janar 2021.

Llogaria 431 (detyrime ndaj shtetit tatim taksa) në shumën 26,338 lekë,përfaqëson detyrimet e taksave të vitit 2020 të cilat do të paguhet në muajin Janar 2021.

Llogaria 435 (detyrimet për sigurimet shoqërore) në shumën 286,248 lekë përfaqëson detyrimet e kontributeve të sigurimeve shëqërore të muajit dhjetor që do të paguhet Brenda dt 20 Janar 2021.

Llogaria 436(Sigurime shëndetësore) në shumën 41,198 lekë, përfaqëson detyrimet e kontributeve të sigurimeve shëqërore të muajit dhjetor që do të paguhet brenda dt 20 Janar 2021.

Llogaria 467 (kreditorë të ndryshëm) në shumën 5,279,019 lekë që është e barabartë me Mjetet monetare (disponibilitet në thesar) në shumën 5,279,019 lekë në aktiv Në korespondencë të llogarisë 520 në aktiv pasqyron vlerën e disponibiliteteve në thesar, të grandeve të trashëguara në vitin pasardhës nga ana e organizatave jo qeveritare.

4. Fondi i konsoliduar në shumën 2,046,110 lekë.

Llogaria 101 Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar në shumën 2,046,110 lekë. Llogaria 85 (Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore) në shumën 109,421 lekë. Që është ndryshimin i gjëndjes së Inventarit më dt 31.12.2020 (206,501- 97.080)

5. Totali i pasiveve në shumën 8,800,203 lekë (i barabartë me vlerën e aktivit).

4.3 Evidenca Analitike e Sintetike e Debitorëve dhe Kreditorëve. Ndjekja e Arkëtimit dhe Pagimit të tyre.

Për gjithë periudhën e audituar, rezulton se nuk ka debitor apo kreditor të pa shlyer, pra gjëndja e llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm” si dhe gjëndja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në fund të çdo viti ushtrimor është zero.

5. Sistemi i menaxhimit të disponibiliteteve

5.1 Auditim mbi veprimet e arkës së institucionit.

Nga auditimi ië periudhën 2019-2021 nuk kishte gjëndje monetare. Nuk janë kryer veprime për gjithë periudhën e audituar.

5.2 Auditim mbi pajtueshmërinë e transaksioneve të kryera me Thesarin.

Dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

Në zbatim të pikës nr.5 të programit të auditimit nr. 483/1 datë 27.01.2022, mbi “Auditimin e kombinuar në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim.

-Transaksionet e llogarive bankare

-Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

U audituan me zgjedhje 13 muaj për periudhën nga 01.05.2019 deri më 31.12.2021.

Për vitin 2019

-Nga auditimi i transaksioneve, u konstatua se, gjatë periudhës objekt auditim për vitin **2019 dhe 2020, shuma 1.167 lekë ,vlerësohet si shpenzim i kryer pa efektivitet,** si shpenzime të kryera për detyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e faturës së ujit për periudhën Gusht 2020, paguar në Dhjetor 2020, si dhe gjoba në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorit vendore e taksave , në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 10, si dhe në kundërshtim me, ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i”

Gjatë auditimit u konstatuan urdhër shpenzime për detyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e faturës së ujit për periudhën Gusht 2020, në shumën **240 lekë**. Gjithashtu u konstatuan vonesë likuidimi dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorinë e taksave dhe tarifave, për vitin 2019, në shumën **927 lekë**. Këto detyrime kanë ardhur si rezultat i mosmarrëveshjeve të krijuara midis DNJF-së dhe palëve të treta. **Pavarësisht se ato e kanë burimin tek mungesa e bashkëpunimit ndërinstytucional, gjobat e paguara përbëjnë shkelje të disiplinës financiare për buxhetin e shtetit .**

Pagesa e kryer për pagesë gjobe nuk mund të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit , dhe veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, **neni 10.**

Neni 10 -Pagesat – (të cilat mbulon buxheti i Shtetit)

Pagesat përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: a) pagesa, që lidhen me transaksione të ndërsjella: i) shpenzime për blerjen e mallrave dhe shërbimeve; ii) shpenzime për blerjen ose krijimin e aseteve afatgjata; iii) pagesa për huamarrje; b) pagesa, që lidhen me transaksione joreciproke: i) transferta qeveritare; ii) grante, kontribute dhe donacione; iii) shpenzime për qiramarrje; c) pagesa financiare: i) shpenzime për interesa; ii) shpenzime për qira financiare; iii) pagesa të principaleve të borxhit; vi) pagesa kujdestarie.

Në lidhje me përcaktimin e pagesave që kryhen në mënyrë specifike nga buxheti i shtetit të shprehura në nenin 10 të Ligjit organik të Buxhetit në asnjë rast nuk bëhet pagesat e gjobave dhe kamatvonesave të cilat janë paguar nga Drejtoria e financës në DNJF.

Konkretisht: Urdhër shpenzimi nr.160, datë 28.08.2019 është likuiduar pagesa e taksës dhe tarifës vendore në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorinë e taksave dhe tarifave, për vitin 2019, në shumën 15,927 lekë. Kjo pagesë është mbështetur për likuidim në bazë të faturës datë 22.07. 2019.Në mënyre analitike kjo faturë pasqyron gjobë për vonesë likuidimi për vitin 2019 në shumën **819 lekë dhe për vitin 2018 në shumën **108 lekë**. Në total shuma e gjobës **927 lekë**. **Vlera prej 927 lekë (819+108) vlerësohet si shpenzim i kryer pa efektivitet. Kjo vlerë përfaqson gjobë për detyrimet e paguar me vonese nga institucioni.****

Një veprim i tillë është kryer në kundërshtim me, ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare ” neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i” ku thotë se :“30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga debitori të faturës ose kërkesë pagese

të njëvleftshme” , institucion duhet të kryej likuidimin, si dhe me me Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 10.

Urdhër shpenzimi nr.230, datë 22.12.2020 është si shpenzime të kryera për detyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e faturës së ujit per periudhën Gusht 2020, paguar në Dhjetor 2020 në shumën **240 lekë**. Ky detyrim ka ardhur si rezultat i mosmarrëveshjeve të krijuara midis DNJF-së me të tretët për likuidimin në kohë të shpenzimit të ujit. **Pavarësisht se ato e kanë burimin tok mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional, kamatpagesa e paguara përbën shkelje të disiplinës financiare për shtetin.** Si rrjedhojë shuma **240 lekë, konsiderohet si shpenzim i kryer pa efektivitet.** Pagesa e kryer për kamatvonesat nuk mund të mbulohen nga fondet e buxhetit të shtetit. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim **me, ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare ” neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i” ku thotë se :“30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga debitori të faturës ose kërkesë pagese të njëvleftshme” , institucion duhet të kryej likuidimin si dhe me me Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 10.**

Gjetje: Nga auditimi i transaksioneve, u konstatua se, gjatë periudhës objekt auditim per vitin **2019 dhe 2020, shuma 1,167 lekë vlerësohet si shpenzim i kryer pa efektivitet,** si shpenzime të kryera përdetyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e shpenzimeve për ujë, si dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorit vendore e taksave për vitet 2018-2019 , në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 10, si dhe në kundërshtim me, ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i”

Rekomandimi: D.NJ. F Tiranë, me qëllim mosimplikimin e risqeve për krijimin e detyrimeve të reja, të marrë masa per likuidimin në kohe të faturave ose të një kërkesë-pagese të njëvleftshme, brenda agfateve të percaktuara në ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i”, si dhe te kryhen keto pagesa konform Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 10,

Nga auditimi i transaksioneve u konstatua se për vitin 2019-2020, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH” si dhe Ligji nr.48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare ”¹.

Grupi i auditimit, kreu testime në muajt që kishte përcaktuar për të audituar për vitin 2019- 2020, për të identifikuar pagesat e kryera me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit

të faturës së furnitorit . Nga kryerja e testimeve, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor.

Konkretisht:

Me **urdhër-shpenzimin nr 86, datë 19.06.2019**, janë 1925 **lekë**, shpenzime telefoni fiks prill 2019. Nga auditimi rezultoi se në dokumentet justifikues kemi faturën e muajit prill 2019 me nr. Serial 727461411, **date 30.04.2019** e cila është likujduar në 19.06. 2019.

Me **urdhër-shpenzimin nr 87, datë 19.06.2019**, janë 1920 **lekë**, shpenzime telefoni fiks prill 2019. Nga auditimi rezultoi se në dokumentet justifikues kemi faturën e muajit prill 2019 me nr. Serial 727461410, **date 30.04.2019** e cila është likujduar në 19.06. 2019.

Me **urdhër-shpenzimin nr 12, datë 04.02.2020**, janë paguar **2,045 lekë**, shpenzime për postën dhjetor 2019, për DNJI-së. Nga auditimi rezultoi se fatura tatimore e paraqitur nga operatori, me nr.5830, datë **26.12.2019** është likujduar në muajin Shkurt 2020.

Me **urdhër-shpenzimin nr 66, datë 23.04.2020**, janë 1920 **lekë**, shpenzime telefoni fiks shkurt 2020. Nga auditimi rezultoi se në dokumentet justifikues kemi faturën e muajit shkurt 2020 me nr. Serial 729025421, **date 29.02.2020** e cila është likujduar në 23.04.2020.

Me **urdhër-shpenzimi nr.154, datë 08.10.2020**, është likujduar shuma **140,400 lekë**, për blerjen e mallrave kancelarike. Nga auditimi rezultoi se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik është në datën 31.08.2020 dhe është likujduar në 08 tetor 2020.

Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar në vitet 2019-2020, janë likujduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditë në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare ”¹, konkretisht neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i” ku thotë se “30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga debitori të faturës ose kërkesë pagese të njëvlefshme”, **institucioni duhet të kryej likujdimin**. Konkretisht janë likujduar 5 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 148,210 lekë duke sjellë:

a. Tejkalim të afateve që parashikon Ligji nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare dhe si pasojë b. implikojnë risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura).

Rekomandim: Me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura, në çdo rast NZ duhet të paraqes në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, **dhe jo ndryshe**. Në auditimet në vijimësi, që do të konstatohet ndryshe, do të evidentohen përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonesave të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar. Veprimet e

tjera, të ekzekutuara nëpërmjet thesarit, konstatohen të jenë të rregullta, me dokumente justifikuese, dhe brenda kornizave ligjore.

Në vijim të procesit auditues, u audituan dhe transaksionet e tjera, të kaluara nëpërmjet thesarit, por nuk u konstatuan probleme për t'u shënuar. Në përfundim u verifikua totali i situacionit buxhetor të vitit 2019, me xhiron kreditore të llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar", dhe rezultuan të barabarta për shumën **16,313,158 lekë**.

Për sa i përket likuidimit të shpenzimeve gjyqësore u konstatua se afati i likuidimit të faturës së subjektit që ka kryer shërbimin është kryer referuar ligjit nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" ¹

Neni 7 Afati për autoritetet publike

Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, dhe:

*c) kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, **afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se:***

*kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave **a shërbimeve me kontratën**, dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme **përpara** ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date. Në ato raste kur ndërmjet kreditorit dhe debitorit ka një datë të përcaktuar për dorëzimin e faturës, afatet për pagimin e kamatëvonesave fillojnë të llogariten që nga e nesërmeja e datës së përcaktuar në marrëveshje. **Afati i parashikuar në shkronjën "a" të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur në kontratë apo marrëveshje është rënë dakord për një afat tjetër.***

*Në ato raste kur autoriteti publik ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, **afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.***

Afati i parashikuar në paragrafin e parë, të këtij neni, i jep të drejtë kreditorit të kërkojë të marrë kamatëvonesë pas 60 ditëve kalendarike gjithsej, duke përfshirë 30 ditët kalendarike të vonesës nga thesari, në shtesë nga 30 ditët e vonesës së pagesës për shkak të autoritetit publik.

Për vitin 2020 u konstatuase:

Me **urdhër-shpenzimin nr.164, datë 09.10.2020**, është likuiduar në shumën 84,120 lekë, shpenzimi blerje tabele. Nga auditimi rezultoi se në dokumentet justifikues, fletë hyrja e mallit nr.10, datë 28.09.2020 ka një gabim aritmetik dhe nuk korrespondon me faturën e operatorit fitues. Konkretisht është shkruar gabim çmimi i i artikullit nr.5, nga 3,000 lekë në 300 lekë. Ky gabim

nuk është me ndikim financiar për arsye se veprimi është një lapsus por roli i ish/nëpunësit zbatues nuk i referohet udhëzimit Nr.30 datë.27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pika 5?

Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues: "Strukturat e Nëpunësit Zbatues para marrjes në dorezim të dokumentave nga personat me përgjegjësi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike". Këshillojmë që veprime të tilla mos të ndodhin në të ardhmen.

Me **urdhër-shpenzimin nr.174, datë 28.10.2020**, është likuajduar në shumën 42,951 lekë, pagesë leje vjetore 2020 për punonjësen A. Grizhja si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës përmes procedurës së lëvizjes paralele. Kjo punonjëse ka përfituar lejen vjetore të pa konsumuar 18 ditë kalendarike, veprim ky në bazë të vendimit nr.511, datë 24.10.2002 "*Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore*", konkretisht pika 3 dhe 6 e kreut II "*Pushimet*". Nga auditimi rezultoi se ky shpërblim është dhënë në kundërshtim me vendimi nr.511, datë 24.10.2002 "*Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore*", konkretisht pika 4 e kreut II "*Pushimet*" e cila thekson:

4. Kohëzgjatja e pushimit vjetor te paguar, kur nëpunësi civil apo punonjësi nuk ka kryer një vit kalendarik pune të plotë, përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënies juridike të punës.

Punonjësja në fjalë ndërkoh për vitin 2020 ka kryer 10 ditë kalendarike pushime vjetore të paguara për vitin 2020. Mardhëniet financiare për punonjësën janë ndërprerë më datë 14.10.2020, pra kohëzgjatja e mardhënies në punë për vitin 2020, është 9.5 muaj. Ditët që duhet të përfitonte realisht janë:

$9.6 \text{ muaj} \times 2.3 \text{ ditë/muaj} = 22 \text{ ditë kalendarike}$. Nga këto zbriten 10 ditë kalendarike që ka kryer në periudhë gusht 2020, **në fakt duhet të kryente 12 ditë kalendarike** dhe jo 18 ditë kalendarike.

Gjithasht përlllogaritja e ditëve është e gabuar për arsye se paguhen ditët e punës dhe jo ditët kalendarike. Mardhëniet financiare ndërpriten më datën 19.10.2020.

Si rrjedhojë punonjësja **duhej të paguhej për 10 ditë** pune dhe jo 18 ditë.

Vlera për 10 ditë pune është:

$2807 \text{ lekë /ditë} \times 10 \text{ ditë pune gjithsej} = 28,070 \text{ lekë}$. Tatim burimi 15%=4,211 lekë.

Shuma që duhej paguar punonjësja është $(28,070 - 4,211) = 23,859 \text{ lekë}$.

Diferenca $42,951 - 23,859 = 19,092 \text{ lekë}$ konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi është dhënë në kundërshtim me VKM -në nr. 511, datë 24.10.2002 "*Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore*", me ndryshime konkretisht pika 4 e kreut II "*Pushimet*" e cila thekson:

Kohëzgjatja e pushimit vjetor te paguar, kur nëpunësi civil apo punonjësi nuk ka kryer një vit kalendarik pune të plotë, përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënies juridike të punës.

Nga këqyrja e dokumentacionit u konstatua se për viti 2020 në veprimet e thesarit për punonjësen A Grizhja si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës përmes procedurës së lëvizjes paralele, ka përfituar lejen vjetore të pa kryer për vitin 2020, **konkretisht 18 ditë kalendarike**, veprim ky bazuar në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 3 e kreut II “Pushimet”.

Nga auditimi rezultoi se ky shpërblim është dhënë në kundërshtim me VKM nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” me ndryshime, konkretisht pika 4 e kreut II “Pushimet” e cila thekson:

4. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar, kur nëpunësi civil apo punonjësi nuk ka kryer një vit kalendarik punc të plotë, përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve juridike të punës.

Gjetje nga auditimi: Nga ana DNJF (Drejtoria e Finacës) në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë zbatuar saktë përcaktimet ligjore për rastin e pagesës së lejes së pakryer për vitin 2020 si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës përmes procedurës së lëvizjes paralele, të bazuar në përlllogaritje jo korrekte sipas kuadrit ligjor e financiar aktual. Si rrjedhojë e këtij gabimi diferenca $42,951 - 23,859 = 19,092$ lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi është dhënë në kundërshtim me Vendimin nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 4 e kreut II “Pushimet”. i ndryshuar **Rekomandimi:** DNJF (Drejtoria e Finacës) të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **19,092** lekë, përfituar në mënyrë jo korrekte sipas kuadrit ligjor e financiar aktual e cila përfaqëson një pagese për ditët e lejes së pakryer në këtë institucion, në kredi të punonjësit përfitues.

Në vijim të procesit auditues, u audituan dhe transaksionet e tjera, të kaluara nëpërmjet thesarit, por nuk u konstatuan probleme për t’u shënuar.

Në përfundim u verifikua totali i situacionit buxhetor të **vitit 2020**, me xhiron kreditore të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, dhe rezultuan të barabarta për shumën **17,139,586 lekë**, dhe për vitin 2021 në shumën **29,702,483 lekë**. Në pagesat e kryera me urdhër shpenzime në përgjithësi nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre.

Konstatim: Vlen të theksojmë se për periudhën 2019-2020, grupit të auditimit ju vështirësua shumë puna në lidhje me auditimin e anës dokumentare dhe justifikuese të transaksioneve ekonomike si dhe të pasqyrave financiare për arsye se në këtë institucion kishin ndryshuar 4 nëpunës zbatues, duke na paraqitur vështirësi në konkluzionin përfundimtar për këtë institucion. Mbështetur në Ligj nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”¹, KREU II -Dispozita të përgjithshme mbi dokumentet kontabël dhe pasqyrat financiare- Neni 8 -Ruajtja e dokumenteve kontabël -

Dokumentet kontabël ruhen në selinë, ku zhvillohet aktiviteti ekonomik i njësisë ekonomike, **për 10 vjet rresht, pas mbylljes së periudhës raportuese së cilës i përkasin, me përjashtim të atyre**

që, me ligj ose akt tjetër nënligjor, u përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje. I njëjti afat zbatohet edhe për dokumentet informatike (bartësit) dhe printimet e tyre. 2. Pasqyrat financiare të grupit ruhen nga njësjia mëmë

Konkluzioni: Rekomandojmë që dispozita e mësipërme e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 8, pika 1 dhe pika 2 të zbatohen me përpikmëri në të ardhmen në këtë institucion, duke rritur shkallën e bashkëveprimit ndërsektorial për arritjen e objektivave të Institucionit. Në përgjithësi urdhër shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve

- Janë kryer pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

5.4 Auditim i dietave brenda dhe jashtë vendit, zbatimi i kriterëve dhe procedurave për përfitim.

Shpenzimet për udhëtim e dieta jashtë vendit.

Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendit, nuk është kryer asnjë procedurë për periudhën objekt auditimi.

Shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit

Nga auditimi u konstatua se punonjësit e institucionit shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit, për arsye pune.

Pagesat për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit, janë përlllogaritur konform VKM-së nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

Gjetjet në formë tabelore për Sistemin e menaxhimit të disponibiliteteve e veprimeve me Thesarin mbi pajtueshmërinë e transaksioneve të kryera.

Titulli i Gjetjes: Shpenzim i kryer pa efektivitet, për detyrimet e prapambetura për kamatvonesat për pagesat e shpenzimeve për ujë, si dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorit vendore e taksave për vitet 2018-2019

Gjetje Nr. 7	
(Subjekti i Audituar)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë ,(Drejtoria e Financës) në (DNJF)
(Njësitë/subjektet e interesuar nga gjetja)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas Tiranë Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Mbështetur në Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 10 përcaktohet: Neni 10 -Pagesat – (të cilat mbulon buxheti i Shtetit)

Pagesat përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: a) pagesa, që lidhen me transaksione të ndërsjella: i) shpenzime për blerjen e mallrave dhe shërbimeve; ii) shpenzime për blerjen ose krijimin e aseteve afatgjata; iii) pagesa për huamarrje; 8 b) pagesa, që lidhen me transaksione joreciproke: i) transferta qeveritare; ii) grante, kontribute dhe donacione; iii) shpenzime për qiramarrje; c) pagesa financiare: i) shpenzime për interesa; ii) shpenzime për qira financiare; iii) pagesa të principaleve të borxhit; vi) pagesa kujdestarie.

Gjithashtu ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7 "Afati për autoritetet publike", pika "i" ku thotë se: "30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga debitori të futurës ose kërkesë pagese të njëvleftshme" institucioni duhet të kryej likuidimin.

Përshkrimi i detajuar i gjetjes

Nga auditimi i transaksioneve, u konstatua se, gjatë periudhës objekt auditim per vitin **2019 dhe 2020, shuma 1,167 lekë ,vlerësohet si shpenzim i kryer pa efektivitet,** si shpenzime të kryera përdetyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e shpenzimeve për ujë, si dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorit vendore e taksave për vitet 2018-2019 , *në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 10, si dhe në kundërshtim me, ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7 "Afati për autoritetet publike", pika "i" Gjatë auditimit u konstatuan urdhër shpenzime për detyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e faturës së ujit për periudhën Gusht 2020, në shumën **240 lekë.** Gjithashtu u konstatuan vonesë likuidimi dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorinë e taksave dhe tarifave, për vitin 2019, në shumën **927 lekë.** Këto detyrime kanë ardhur si rezultat i mosmarrëveshjeve të krijuara midis DNJF-së dhe palëve të treta. **Pavarësisht se ato e kanë burimin tek mungesa e bashkëpunimit ndërinstytucional, gjobat e paguara përbëjnë shkelje të disiplinës financiare për shtetin, .** Pagesa e kryer për pagesë gjobe nuk mund të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit , dhe veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 10.

Pagesat e gjobave dhe kamatvonesave të cilat janë paguar nga Drejtoria e financës në DNJE, janë kryer në kundërshtim me Ligjin Organik të Buxhetit.

Vlerësimi i nivelit të riskut

I mesëm

Konkluzioni

Si i rezultat i veprimeve të mësipërme nga likuidimi i shpenzime të kryera për detyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e shpenzimeve për ujë, si dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorit vendore e taksave për vitet 2018-2019 ,shuma 1,167 lekë ,vlerësohet si shpenzim i kryer pa efektivitet, me ndikim negativ në buxhetin e shtetit.Sektori i financës në lidhje me dokumentacioni justifikues , duhet të kryej me përgjegjësi këtë proces si dhe ndjekjen rigoroze mbështetur në kuadrin ligjor përkatëse.

Rekomandimi	D.NJ.F Tiranë, me qëllim mosimplikimin e risqeve për krijimin e detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin në kohe të faturave ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme, brenda agfateve të percaktuara në <i>ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"</i> neni 7 "Afati për autoritetet publike", pika "i", si dhe të kryhen keto pagesa konform <i>Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"</i> neni 10,
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Menjëherë dhe në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, pranohet fakti i konstatuar.(bashkëlidhur korrespondenca për justifikimin në lidhje me gjetjen e sipërcituar, ku theksojmë se grupit të auditimit janë vënë të gjitha më parë në dispozicion)
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, "Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2 datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë", protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marrë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë: Ky observacion nuk sjell argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

Titulli i Gjetjes: Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave, likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton Ligji nr.48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"¹

Gjetje Nr.8	
Subjekti i Audituar)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë,(Drejtoria e Financës) në (DNJF)
(Njësitë/subjektet interesuar nga gjetja	e Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Mbështetur në Ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" ¹ , neni 7 "Afati për autoritetet publike", pika "i" përcaktohet: Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, dhe: i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesëpagese të njëvlershme, <i>institucioni duhet të kryej likuidimin;</i>

Përshkrimi i detajuar i gjetjes	Për periudhën e audituar në vitet 2019-2020, janë likujduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, konkretisht neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i” ku thotë se “30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga debitori të faturës ose kërkesë pagese të njëvleftshme”, institucioni duhet të kryej likuidimin. Konkretisht janë likujduar 5 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 148.210 lekë duke sjellë: a. Tejkalim të afateve që parashikon Ligji nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare dhe si pasojë b. implikojnë risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura).
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Drejtoria e financës në bashkëpunim me strukturat mbështetëse në lidhje me dokumentacioni justifikues për trasaksionet financiare, duhet të kryej me përgjegjësi këtë proces si dhe ndjekjen rigoroze mbështetur në kuadrin ligjor përkatëse.
Rekomandimi	Me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura, në çdo rast NZ duhet të paraqes në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, dhe jo ndryshe. Për çdo rast në vijim, që do të konstatohet ndryshe, të evidentohen përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonesave të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Menjëherë dhe në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, pranohet fakti i konstatuar. (bashkëlidhur korrespondenca për justifikimin në lidhje me gjetjen e sipërcituar, ku theksojmë se grupit të auditimit janë vënë të gjitha më parë në dispozicion)
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2 datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë”, protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë:

Ky observacion është përpiluar në formën e një sqaruese, ku grupit të auditimit ju referua edhe në periudhën e punës audituese terren në këtë institucion, në disa raste nuk është kuptuar dhe thelbi i gjetjes dhe si rrjedhojë nuk sjellin argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.

Rishikimi i statusit të gjetjes

Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

Titulli i Gjetjes: Përfitim i gabuar në lidhje me pagesën së lejes së pakryer për vitin 2020 me efekt negativ duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Gjetje Nr.9

(Subjekti i Audituar)

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Tiranë ,Drejtoria e Financës në (DNJF)

(Njësitë/subjektet interesuar nga gjetja)

e Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Tiranë
Ministria e Drejtësisë

Përmbledhja e bazës ligjore

Mbështetur në Vendimin nr.511, datë 24.10.2002“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 4 e kreut II “Pushimet” përcaktohet:

4. Kohëzgjatja e pushimit vjetor te paguar, kur nëpunësi civil apo punonjësi nuk ka kryer një vit kalendarik pune të plotë, përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve juridike të punës.

Përshkrimi i detajuar i gjetjes

Nga ana DNJF (Drejtoria e Financës) në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë zbatuar saktë përcaktimet ligjore për rastin e pagesës së lejes së pakryer për vitin 2020 si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës përmes procedurës së lëvizjes paralele , të bazuar në përllogaritje jo korrekte sipas kuadrit ligjor e financiar aktual , veprim ky në kundërshtim me vendimin nr.511, datë 24.10.2002“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 4 “Pushimet”. i ndryshuar ,

Nga këqyrja e dokumentacionit u konstatua se për viti 2020 në veprimet e thesarit për punonjësen A.Grizhja si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës përmes procedurës së lëvizjes paralele, ka përfituar lejen vjetore të pa kryerper vitin 2020, konkretisht 18 ditë kalendarike, veprim ky bazuar në vendimin nr.511, datë 24.10.2002“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 3 e kreut II “Pushimet”.

Nga auditimi rezultoi se ky shpërblim është dhënë në kundërshtim me vendimi nr.511, datë 24.10.2002“Për

	<p><i>kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 4 e kreut II “Pushimet” e cila thekson:</i></p> <p>4. Kohëzgjatja e pushimit vjetor te paguar, kur nëpunësi civil apo punonjësi nuk ka kryer një vit kalendarik pune të plotë, përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve juridike të punës.</p> <p>Nga përlllogaritja u konstatua se punonjësja duhet të përfitonte 12 ditë kalendarike dhe si rrjedhojë diferenca 19,092 lekë është përfituar në mënyrë të gabuar dhe konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Nga përlllogaritja u konstatua se punonjësja duhet të përfitonte 12 ditë kalendarike dhe si rrjedhojë diferenca 19,092 lekë është përfituar në mënyrë të gabuar dhe konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi është dhënë në kundërshtim me Vendimin nr.511, datë 24.10.2002“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, konkretisht pika 4 e kreut II “Pushimet” i ndryshuar.
Rekomandimi	DNJF (Drejtoria e Finacës) të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 19,092 lekë , përfituar në mënyrë jo korrekte sipas kuadrit ligjor e financiar aktual e cila përfaqëson nje pagese per ditet e lejes se pa kryer ne kete institucion, në kredi të punonjësit përfitues.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Menjëherë dhe në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, pranohet fakti i konstatuar .(bashkëlidhur korrespondenca në lidhje me gjetjen e sipërcituar, ku theksojmë se grupit të auditimit janë vënë të gjitha më parë në dispozicion)
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2 datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë”, protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marrë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë: Ky observacion nuk sjell argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

6.Sistemi i kontabilitetit dhe menaxhimit.

Zbatimi i rregullave për marrjen në dorëzim dhe magazinimin.

Zbatimi i rregullave për regjistrimin e aktiveve në regjistrin e aktiveve.

Zbatimi i saktësisë së regjistrimeve kontabël.

Invetarizimi fizik dhe krahasimi me vlerën e kërkuar nga kontabiliteti.

Baza ligjore dhe dokumenta:

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

-UMF Nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

-Ligjit nr. 9228, datë 29/04/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet.

-Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

- Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të buxhetit” pikës nr. 272

-Zbatimi i rregullave për regjistrimin e aktiveve në regjistrin e aktiveve.

6.1. Zbatimi i rregullave për marrjen në dorëzim dhe magazinimin.

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht. U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për 6 mujori i dytë i vitit 2021. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas magazinierit, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Çdo fletë dalje është e pajisur me urdhër dorëzimi ose me plan shpërndarje përkatëse, bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës. Fletë hyrje dhe fletë dalje, ndjekin rendin kronologjik, ku ka adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Fletë hyrjet dhe fletë daljet, ishin sipas numrit kronologjik, dhe ishin regjistruar në ditar në llogaritë përkatëse, lëvizjet e çdo vlere materiale ishin evidentuar në kartelat e magazinës.

6.2 Zbatimi i Rregullave për Rregjistrimin e Aktiveve në Rregjistrin e Aktiveve.

Baza ligjore për mbajtjen dhe regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme është Udhëzimi i Ministrit të Financave, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, udhëzimi ka të përcaktuar në pjesën III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” - Rregjistri i aktiveve të njesive të sektorit publik pika 26, ku thuhet se çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar, pika 27, Nëpunësi Autorizues i njesise, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit, pika 28, rregjistri i aktiveve të një njesie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të

njesisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njesise në formën e pjesëmarrjeve në kapital, pikën 30, e cila përcakton se formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit.

Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijne: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadences, vlerën e shpenzimeve kapitale të mepashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Nga auditimi rezultoi se janë zbatuar me rigorozitet gjithë pikat e udhëzimit MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime,

6.3 Zbatimi i saktësisë së regjistrimeve kontabël.

Konstatim: Nga auditimi i transaksioneve për periudhën 2019-2020, u konstatua se urdhër shpenzimet që janë kryer me objekt “Paga bazë, shtesë pagë, raporte mjekësore dhe honorare”, **u mungojnë të bashkëlidhura listëprezencat** të nënshkruara nga personat kompetentë në rastin konkret sektori i burimeve njerëzore i caktuar sipas ligjit dhe nëpunësi zbatues në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” të ndryshuar, pika 69 **.(mungesë dokumentacioni justifikues).**

Gjithashtu theksojmë se për periudhën objekt auditimi, vetëm për vitin 2021 këto dokumente justifikues janë të renditura sipas kuadrit ligjor, si në rastin e dokumentimit të pagave dhe në veprimet e thesarit.

Konkluzioni: *Mungesat e listëprezencave në dokumentacionin e veprimeve me thesarin është plotësohen me rigorozitet konform Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” të ndryshuar, pika 69, për vitin 2021.*

Për veprimet e tjera, urdhër shpenzimet janë shoqëruar me dokumentacionin justifikues, janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakorduara nga dega e thesarit. Në ditarin e bankës të çdo muaji ishin kryer artikujt kontabël të brendshme për pagesat e bankës, konform ligjit mbi kontabilitetin.

U auditua likuidimi nga banka i detyrimeve të ATP-së ndaj Postës, Telekomit, Ujësjiellësit dhe OSHEE-së nga ku rezultoi se këto pagesa kishin bashkangjitur faturën përkatëse për likuidimet e kryera për faturat dhe kontratat e nënshkruara. Dokumentacioni është regjistruar në mënyrë kronologjike. Është bërë rakordimi i vazhdueshëm me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Regjistrimet e kontabilitetit, ditarët dhe librat e kontabilitetit, janë mbajtur në kompjuter, në programin excel. Ligji nr.9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kanë përcaktuar mbajtjen e librave dhe ditarëve të kontabilitetit, në formë të shkruar. Mbajtja e kontabilitetit në programin excel, nuk garanton sigurinë e ruajtjes së informacionit, nga risqet e programeve kompjuterike.

Ditarët dhe librat e kontabilitetit të mbahen në formë të shkruar dhe të merren masa për zbatimin e rregullave të sistemit kontabilitetit dhe regjistrimit kontabël. Mbajtja e regjistrimeve kronologjike është kryer nëpërmjet ditarëve të arkës, bankës, ditari i magazinës, është bërë rakordimi i vazhdueshëm me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet.

6.4 Inventarizimi fizik dhe krahasimi me vlerën e kërkuar nga kontabiliteti.

Baza ligjore dhe dokumenta: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si dhe UMF, Udhëzimi Nr 30 dt 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Ligjit nr.9228 datë.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet. Kontrolli i aktiveve kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike si dhe krahasimi i tyre me gjëndjen kontabël, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9228 datë.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, Neni 7, “Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore”, si dhe Udhëzimit Nr.30 datë.27.12.2011 “ Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 74.”Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.” Dihet se inventarizimi fizik i aktiveve është detyrim i përcaktuar nga Ligji Nr.9228, dt.29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe një element i rëndësishëm kontrolli mbi gjendjen dhe lëvizjet, hyrjet dhe daljet e aktiveve në sektorin publik, ndaj dhe kryerja e këtij procesi është normuar me Udhëzimin e Ministrisë të Financave, Udhëzimi Nr.30 datë.27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pjesa IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve inventarizimi i aktiveve". Pra, kjo ka të bëjë me procesin e verifikimit faktik për gjëndjen e aktiveve të pasqyruara në raportin vjetor financiar (bilanci financiar), me qëllim vërtetësinë e shifrave të bilancit financiar. Në përfundim të kryerjes së këtij procesi duhet të raportohet nëpunësit autorizues, i cili nxjerr aktet për mbylljen e procesit. Përveç identifikimit të gjëndjes faktike, të aktiveve, komisioni inventarizimit ka detyrë të evidentojë aktivet që nuk janë në gjëndje pune, pra aktive të cilat dalin jashtë përdorimit.

Mbështetur në udhëzimin sa më sipër duhet që çdo njësi publike të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, të aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe

dokumentacionit mbështetës. Ky inventarizim realizohet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të Titullarit të njesisë publike ose Nëpunësit Autorizues të çdo niveli të njesisë publike.

Inventarizimi viti 2019.

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njesisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre.

Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

-Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

-Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

-Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin. (UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik").

Për këtë periudhë është ngritur komisioni i kryerjes së inventarizimit të aktiveve.

Konkretisht: Urdhri nr.157 Prot dt 12.12.2019 "Për ngritjen e komisionit, për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në "Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas" Komisioni i përbërë nga personat e mëposhtëm.

Znj. Kristi Petrela Kryetare

Znj. Etleva Zeqiraj Antare

Znj. Ilberjan Durmishi Antar

Me Proçes Verbalin Nr 157/1 dt 10.01.2020 midis komisionit dhe magazinieres Fatbardha Fiku janë fiksuar ku FH me nr 08 datë .04.12.2019 dhe FD me nr 23 dt 24.12.2019.

Me proçes verbalin nr 157/2 dt 10.01.2020 komisioni është njohur me listën e aktiveve për inventarizim. Shkresa nr 157/3 dt 13.01.2020 raporton mbi proçedurën e inventarizimit për vitin 2019.

Duke ju referuar Aktivitet të Bilancit Financiar në aktiv të Bilancit kemi Inventar në vlerën 592,216 lekë kurse sipas Pasqyrës **nr 7/a** Gjëndje në fillim të vitit 2019 kemi Inventar ekonomik 1,272,576 lekë. Sipas pasqyrës **nr 7/b** teprica në fillim të vitit 2019 është në shumën 1,272,576 lekë dhe amortizim i akumuluar 680,360 lekë, shtesat e vitit financiar janë në shumën, 2,292,240 lekë amortizimi në shumën 177,399 lekë. Vlera në fund të vitit 2,707,057 lekë.

Sipas Inventarit fizik aktivitet i kemi në vlerën (1,272,576 + 1,023,720 + 996,720 + 97,080) = 3,390,096 lekë duke zbritur amortizimin e llogaritur në shumën 857,759 lekë (ku 680,360 lekë amortizimi i akumuluar) vlera neto = 2,532,337 lekë. Vlerat sipas bilancit në aktiv i kemi 97,080 dhe 2,707,057 lekë (në total 2,804,137 lekë).

Si përfundim kemi vlera jo të rakorduara saktë midis inventarit fizik dhe atij kontabël diferencë 2,804,137-2,532,337 = 271,800 lekë më shumë në kontabilitet sesa në inventarizimin fizik të kryer nga grupi i inventarizimit.

Konkluzioni për procesin e inventarizimit: Në dosjen e inventarizimit që ju paraqit grupit të auditimit, rezultoi se para fillimit të inventarit, është marrë deklarata e personave me përgjegjësi materiale, është fiksuar numri i fundit i flotë hyrjes e flotë daljes sipas sektorëve përkates, *por nuk ishin bashkëlidhur kopjet e tyre, praktikës së dokumentacionit të inventarizimit.* Komisionerët kanë kryer inventarin fizik të institucionit, duke bërë krahasimin me të dhënat e gjëndjes kontabël dhe shuma 271,800 lekë, nga auditimi paraqitet më shumë në kontabilitet sesa në inventarizimin fizik të kryer nga grupi i inventarizimit.

Komisionerët e inventarizimit, kanë nënshkruar fletët e inventarëve në të gjitha fletët e tyre, dhe i kanë bërë relacion titullarit të institucionit, mbi rezultatin e inventarit perfundimtar, dhe vlerësimin e aktiveve që kanë humbur vlerën e përdorimit. *Rekomandojme që difektet teknike të konstatuara gjatë procesit të inventarizimit, të mos përseriten në vazhdimësi në praktikat e inventarizimit të institucionit.*

Konstatim: Gjatë procesit të auditimit për vitin 2019 u konstatua mosrakordim i vlerave të inventarit fizik me atë të pasqyruar në kontabilitet. Jemi përpara faktit të një mosrakordimi midis inventarit fizik dhe atij kontabël. Diferenca (2,804,137-2,532,337) = 271,800 lekë përfaqëson vlerën më shumë në kontabilitet sesa në inventarizimin fizik të kryer nga grupi i inventarizimit. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi **dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore**

Konkluzion: Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në ligj. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes. Zbatimi i Ligjit nr 9228, dt 29/04/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, Neni 7 pika .2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi **dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.** Udhëzimin nr 8 dt 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithëshme pika 30.

Inventarizimi viti 2020.

Për këtë periudhë është ngritur komisioni i kryerjes së inventarizimit të aktiveve.

Konkretisht: Urdhër nr.10 prot dt 05.02.2021 (nr 123 prot dt 05.02.2021) “Për ngritjen e komisionit, për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në “Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas” viti 2020, komisioni i përbërë nga personat e mëposhtëm.

Znj.Ornela Ferhati - Kryetare

Znj.Katerina Jano - Anëtare

Znj.Irma Alushaj -Anëtare

Gjetje: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 procesi i inventarizimit nuk është kryer brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore, brenda vitit 2020, por në fillim të vitit 2021. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, Neni 7, “Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore”, si dhe Udhëzimit Nr.30 datë.27.12.2011 “ Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 74.”Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.”

Rekomandim: Grupi i auditimit rekomandon që raste të tilla të mos përsëriten në vijim. NA, NZ dhe personeli i përfshirë, të marrin masat që në proceset e inventarizimit të rradhës të meret në konsideratë udhëzimin e MF nr.30, dt 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Pika 74.” Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës. Rezultatet e inventarizimit në cdo rast duhet të dokumentohen me një relacion përkatës. Proçesverbali nr 123/1 dt 30.03.2021 midis komisionit ku u njoh me të dhënat e regjistrit kontabël të aktiveve të Ndihmës Juridike dhe dhe punojësve të ngarkuar materialisht , dhe u bë verifikimi fizik dhe cilësor i gjëndjes së arkiveve në ngarkim dhe përdorim personelit si dhe gjëndjes në magazinë.Sipas fletëvetë inventarizimit kemi **3,107,093 lekë** Materiale.(574,476+368,560+597,780+196,657+222,720+191,020+345,840+403,538+206,502) Sipas inventarit fizik kemi 3,107,093 lekë materiale Sipas pasqyrës **nr 7/6** të pasqyrave financiare i kemi 3,046,276 lekë materialet (diferenca **60,817 lekë**).

Në dosjen e inventarizimit që ju paraqit grupit të auditimit, rezultoi se para fillimit të inventarit, është marrë deklarata e personave me përgjegjësi materiale, është fiksuar numri i fundit i fletë-hyrjes e fletë-daljes sipas sektorëve përkatës, por nuk ishin bashkëlidhur kopjet e tyre, praktikës së dokumentacionit të inventarizimit. Komisionerët kanë kryer inventarin fizik të institucionit, duke bërë krahasimin me të dhënat e gjëndjes kontabël dhe shuma 60,817 lekë, nga auditimi paraqitet më shumë në kontabilitet sesa në inventarizimin fizik të kryer nga grupi i inventarizimit. Komisionerët e inventarizimit, kanë nënshkruar fletët e inventarëve në të gjitha fletët e tyre, dhe i kanë bërë relacion titullarit të institucionit, mbi rezultatin e inventarit perfundimtar, dhe vlerësimin e aktiveve që kanë humbur vlerën e përdorimit. Rekomandojme që difektet teknike të konstatuara

gjate procesit të inventarizimit, të mos përseriten në vazhdimësi në praktikën e inventarizimit të institucionit.

Konstatim: Gjatë procesit të auditimit për vitin 2020 u konstatua mosrakordim i vlerave të inventarit fizik me atë të pasqyruar në kontabilitet. Jemi përpara faktit të një mosrakordimi midis inventarit fizik dhe atij kontabël. Diferenca 60,817 lekë përfaqëson vlerën më shumë në kontabilitet sesa në inventarizimin fizik të kryer nga grupi i inventarizimit. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi **dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore**

Konkluzion: Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në ligj. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes. Zbatimi i Ligjit nr 9228, dt 29/04/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, Neni 7 pika .2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi **dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore**. Udhëzimin nr.8 dt 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme pika 30.

Inventarizimi viti 2021. Për këtë periudhë është ngritur komisioni i kryerjes së inventarizimit të aktiveve.

Konkretisht: Urdhri nr.171 prot dt 17.12.2021(nr 1000 prot dt 17.012.2021) “Për ngritjen e komisionit, për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në “Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas” viti 2021. Komisioni i përbërë nga personat e mëposhtëm.

Z. Klejda Poçi - Kryetare ✓

Z Suela Qevani - Anëtare ✓

Z Olivia Dauti - Anëtare ✓

Ornela Daka – Magazinierë me përgjegjësi materiale. ✓

Procesverballi nr 1000/1 dt 31.12.2021 midis komisionit ku u njoh me të dhënat e regjistrimit kontabël të aktiveve të Ndihmës Juridike dhe dhe punojësve të ngarkuar materialisht, dhe u bë verifikimi fizik dhe cilësor i gjëndjes së arkiveve në ngarkim dhe përdorim personelit si dhe gjëndjes në magazinë.

Raporti i inventarizimit të aktiveve me nr 1000/2 dt 31.12.2021 ku komisioni i Inventarizimit sipas urdhërit u shpreh se u krye verifikimi në prezencë të punojësve të ngarkuar, nga inventari rezultoi se aktivet në ngarkim të punojësve janë në gjëndje pune dhe të pa dëmtuarar, dhe gjëndja sipas inventarizimit është e njëjtë me sasinë e aktiveve sipas regjistrave.

Raporti me nr 1000/3 dt 31.12.2021, ku komisioni pasi kreu inventarin fizik të aktiveve raportoi se komisioni u bë me dyer të mbyllura dhe i komunikoi magazinieres Znj Ornela Daka, FH e fundit nr .20 dt 31.12.2021 dhe FD e fundit nr. 71 dt 31.12.2021, gjithashtu mallrat ishin në gjëndje të mirë dhe të përdorshme. Sipas inventarit Fizik të kryer nga ana e komisionit rezultoi vlera e Aktiveve në vlerë, **4,296,517 lekë**. Nga ana e Komisionit të ndihmës juridike të rakordohet inventari kontabël me atë të kryer në vend.

Gjetjet tabelore në lidhje me sistemin e kontabilitetit dhe menaxhimit.

Titulli i Gjetjes: Vlerësimi i punës për kryerjen e inventarizimit të pasurisë.

Gjetje Nr.10	
(Subjekti i Audituar)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë ,(Drejtoria e Financës , NA, NZ dhe komisioni i inventarizimit të aktiveve) në (DNJF)
(Njësitë/subjektet e interesuar nga gjetja)	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Tiranë Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Mbështetur në ligjin nr.9228 datë.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, Neni 7, “Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore”, si dhe në Udhëzimin Nr.30, dt 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Pika 74.” Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.”
Përshkrimi i detajuar i gjetjes	Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 procesi i inventarizimit nuk është kryer brenda vitit 2020, por në fillim të vitit 2021. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, Neni 7, si dhe me Udhëzimin Nr.30, dt 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Pika

	74 .”Konkretisht procesi inventarizimit është kryer me Urdhërin nr 10 Prot dt 05.02.2021(nr 123 prot dt 05.02.2021)“ Për ngritjen e komisionit, për kryerjen e inventarizimit të aktiveve
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Procesi i inventarizimit të realizohet konform Ligjit nr.9228 datë.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, si dhe të UMF Nr.30, dt 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Rekomandimi	Rekomandojmë që raste të tilla të mos përsëriten në vijimësi. NA, NZ dhe personeli i përfshirë, të marrin masat që në proceset e inventarizimit të rradhës të merret në konsideratë Udhëzimi Nr.30, dt 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Pika 74.” <i>Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.</i> Rezultatet e inventarizimit në cdo rast duhet të dokumentohen me një relacion përkatës.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Menjëherë dhe në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar
Observacionet	Nga ana e DNJF për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi projekt raportin, pranohet fakti i konstatuar dhe në formën e një sqaruese na paraqiten fakte qe ishin ezauruar gjate procesit të auditimit ne terren.(bashkëlidhur korrespondenca për justifikimin në lidhje me gjetjen e sipërcituar, ku theksojmë se grupit të auditimit janë vënë të gjitha më parë në dispozicion)
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në lidhje me observacionin paraqitur nga subjekti i i audituar me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, e shkresës nr.483/2 datë 16.03.2022 të Ministrisë së Drejtësisë”, protokolluar pranë M.D. me nr.483/4prot. 05.04.2022, dhe marë nga Drejtoria e Auditimit dt 13.04.2022 sqarojmë si më poshtë: Ky observacion nuk sjell argumenta ligjorë dhe financiar për rrëzimin e gjetjes së auditit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.

7.Sistemi i funksionimit ligjor të institucionit.

-Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore.

-Analiza dhe raporte periodike mbi veprimtarinë e institucionit.

7.1.Ndihma Juridike Parësore

Me urdhrin nr.396, datë 08.07.2021 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin dhe kalimin nën administrimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë” është miratuar Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë, administrimi i kësaj qendre kryhet nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, është përcaktuar se DNJF-ja do të ketë 4(katër) qendra të ndihmës juridike parësore të financuara nga buxheti i DNJF-së, por do të ketë nën administrim edhe qendra të tjera të hapura me mbështetjen e donatorëve.

Gjetje: Aktualisht, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka 2(dy) qendra të ndihmës juridike parësore të financuara nga Buxheti i DNJF-së, nga katër që janë parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit. Qendra e Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë e vendosur në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë e rivitalizuar prej muajit Korrik 2021 dhe Qendra e Ndhmës Juridike Parësore në Lushnje e vendosur në ambientet e Bashkisë Lushnje, e rivitalizuar prej muajit shtator 2020.

Rekomandimi: Të zbatohet Urdhri i Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, ku është parashikuar që DNJF-ja do të ketë 4 qendra të ndihmës juridike parësore në qarqe. Me hapjen e dy qendrave të tjera siç është parashikuar edhe nga DNJF-ja për t’u hapur gjatë vitit 2022 në Qarkun Shkodër dhe Durrës, do të mundësohet mbulimi me ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore në 100% të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë në Shtator të vitit 2020 janë autorizuar 12 OJF për ofrimin e ndihmës juridike parësore, si më poshtë:

- Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza;
- Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat;
- Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara;
- Intelektualët e rinj shpresë;
- Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA);
- Forumi i Gruas Elbasan;
- Shërbimi Ligjor Falas (TLAS);
- Të ndryshëm dhe të barabartë;
- Albanian Legal and Territorial Institute;
- Qendra për Nisma ligjore qytetare;
- Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe emigrantët;
- Qendra Konsumatori Shqiptar.

Gjithashtu, në institucionet e arsimit të lartë janë krijuar klinikat juridike të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore. Ekzistojnë 11 (njëmbëdhjetë) klinika ligjore pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë të cilat kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me DNJF-në.

Granti i parë (Korrik 2020 - Maj 2021)

Mbi ecurinë e Granteve nga bashkëpunimi me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Prioriteti i Projektit “Shtirja e shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” nënshkruar midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe ADA, me nr.7227 prot, datë 23.10.2019 është hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe administrimi i tyre nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Në korrik të vitit 2020 u nënshkrua Letra e parë e Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe ADA për hapjen e 5 Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore dhe rivitalizimin e 3 qendrave të hapura nga UNDP në bashkëpunim me Organizatat jofitimprurëse.

Granti i dhënë nga UNDP konsiston në mbulimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të 2 punonjësve për çdo qendër. Qendrat janë vendosur pranë Bashkive, Gjykatave dhe ADISA, pa kundërshpërblim sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga Ministria e Drejtësisë / Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Gjatë vitit 2020-2021 është mundësuar hapja e 8 apo të gjitha qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore të planifikuara. Këto qendra, gjatë vitit 2020 kanë trajtuar 1.426 raste ndihmë juridike parësore.

Granti i dytë (Korrik 2021 - Dhjetor 2021)

Me datë 24.08.2021 u nënshkrua Letra e re e Bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë për përfitimin e Grantit të dytë (Korrik 2021-Dhjetor 2021), memorandum i cili zëvendëson Memorandumin e Mirëkuptimit të vitit 2019.

Gjatë vitit 2021 është bërë e mundur hapja/rivitalizimi i 3 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Fier, Vlorë, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.82, datë 19.02.2021, me mbështetjen e UNDP. Gjatë periudhës Maj – Qershor 2021, Drejtoria e Ndhmës Juridike Parësore ka zhvilluar dhe ndjekur procesin e trajnimit të detyrueshëm të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, duke përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në shkronjën “g” të nenit 8 të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Është lidhur marrëveshja standard mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Ministrisë së Drejtësisë, mbi zbatimin e projektit “Zgjerimi i shërbimeve të Ndhmës Juridike Falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”, datë 15 shkurt 2022.

Ofrimi i Ndhmës Juridike Parësore

Për vitin 2021: Janë ngritur 32 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në mbi 95% të territorit të vendit:

- 10 qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore (Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Gjirokastrë, Vlorë, Fier dhe Dibër.
- 12 OJF, të cilat operojnë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Shkodër, të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.
- 11 Marrëveshje Bashkëpunimi me Klinikat Ligjore pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër.
- Ndhma Juridike në e-Albania, Numri i gjelbër.

Ofrues të NJF	Qendrat e NdJP	OJF	Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	Platoforma Juristi online	Numri gjelbër	Totali i rasteve të raportuara
Nr. në total	3185	2398	61	1904	605	8153

Financimi i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë

Organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i DNJF-së, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje, sipas parashikimit në pikën 3 të nenit 15 të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe VKM nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre.”

DNJF-ja ka hapur thirrjen e parë për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit të OJF-ve të financuara nga Ministri i Drejtësisë, në mars të vitit 2021. Nga 10 aplikantë rezultoi të mos kishte asnjë fitues. Në raportin vjetor të vitit 2021, DNJF ka arsyetuar se kjo situatë ka ardhur për shkak të një rregullimi ligjor jo të plotë, konstatim i cili i është vënë në dispozicion Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.549 prot., datë 23.06.2021.

Në kuadër të realizimit të këtij procesi DNJF ka hartuar Metodologjinë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar, miratuar me urdhrin nr.5, datë 18.01.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF-së.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të zbatojë Vendimin nr.110, datë 06.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre” duke zhvilluar një procedurë konkurruese, transparente konform legjislacionit në fuqi.

Sistemi i zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore

Gjetjet për sistemin e zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore do të trajtohen sipas formatit të mëposhtëm:

Titulli i Gjetjes: Aktualisht, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka dy qendra të ndihmës juridike parësore të financuara nga Buxheti i DNJF-së, nga katër që janë parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit. Qendra e Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë e vendosur në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë e rivitalizuar prej muajit Korrik 2021 dhe Qendra e Ndhmës Juridike Parësore në Lushnje e vendosur në ambientet e Bashkisë Lushnje, e rivitalizuar prej muajit shtator 2020.

Gjetje nr. 11	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Ministria e Drejtësisë
Përmbledhja e bazës ligjore	<i>Urdhri i Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”.</i> Pika 3 e nenit 36 “Dispozita kalimtare” e Ligjit nr.111/2017: <i>Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore ngrihen brenda tre muajve nga krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.</i>
Përshkrimi i gjetjes	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka dy qendra të ndihmës juridike parësore të financuara nga Buxheti i DNJF-së, nga katër që janë parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit. Situata: Mos hapja e katër qendrave me buxhetin e shtetit sipas parashikimit në Urdhrin e Kryeministrit. Kriteri: <i>Urdhri nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”.</i> Ndikimi/Efekti: Hapja e katër qendrave të parashikuara do të mundësojë ofrimin e shërbimit në gjithë territorin e R.SH.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Me hapjen e dy qendrave të tjera siç është parashikuar edhe nga DNJF-ja për t’u hapur gjatë vitit 2022 në Qarkun Shkodër dhe Durrës, do të

	mundësohet mbulimi me ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore në 100% të territorit të Republikës së Shqipërisë.
Rekomandimi	Të zbatohet Urdhri i Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ku është parashikuar që DNJF-ja do të ketë 4 qendra të ndihmës juridike parësore në qarqe.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar.
Observacioni i gjetjes nr. 11	<p>Aktualisht, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka dy qendra të ndihmës juridike parësore të financuara nga Buxheti i DNJF-së, nga katër që janë parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit.</p> <p>Subjekti i audituar në kundërshtimet e paraqitura me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit kanë argumentuar se: DNJF administron jo 2, por 10 qendra në qytetin e Tiranës.....Kalimi i Qendrave të Ndihmës Juridike Falas bëhet vetëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.</p> <p>Opinionin e grupit të auditimit: Në projekt raport, grupi i auditimit nuk i është referuar qendrave të administruara nga DNJF, por i është referuar zbatimit të Urdhrit të Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, si dhe Pika 3 e nenit 36 “Dispozita kalimtare” e Ligjit nr.111/2017 ..“Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore ngrihen brenda tre muajve nga krijimi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, në lidhje me hapjen e katër qendrave me buxhetin e shtetit.</p> <p>Subjekti i audituar me paraqitjen e këtij observacioni nuk i ë përmbajtur kuptimit të gjetjes dhe rekomandimit.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Me hapjen e dy qendrave të tjera siç është parashikuar edhe nga DNJF-ja për t’u hapur gjatë vitit 2022 në Qarkun Shkodër dhe Durrës, do të mundësohet mbulimi me ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore në 100% të territorit të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Të zbatohet Urdhri i Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ku është parashikuar që DNJF-ja do të ketë 4 qendra të ndihmës juridike parësore në qarqe.</p>
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.
Rishikimi i nivelit të riskut	I mesëm.

7.2.Ndihma Juridike Dytësore:Ndihma Juridike Dytësore realizohet nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike. Kjo drejtori zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike si dhe mbikëqyrjen e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore të ofruar nga Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Klinikat e Ligjit dhe Avokatët. Është realizuar një ndarje detyrash brenda Drejtorisë së Mbikëqyrjes, e cila i është komunikuar specialistëve nëpërmjet e-mailit zyrtar.

1.Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Monitorimet ushtrohen sipas Kalendarit të monitorimeve për çdo vit. Ato realizohen duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore, organizimin, administrimin e rasteve të ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Është përllogaritur që çdo qendër të monitorohet të paktën 3 herë brenda vitit në periudha të ndryshme. Me urdhrin nr.20 prot, datë 11.03.2021 “Për miratimin e kalendarit të monitorimit për vitin 2021” në funksion të vlerësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike. Me urdhrin nr.23, datë 10.02.2022 “Për miratimin e kalendarit të monitorimeve të Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore për vitin 2022”.

Disa nga konkluzionet kryesore të evidentuara nga grupet e monitorimit:

1. Përcjellja e raporteve mujore narrative.
2. Punonjësit e qendrave nuk përcjellin problematika/rekomandime.
3. Numri i rasteve të rasteve.

U audituan disa nga praktikat mbi mbikëqyrjen dhe kontrollin e performancës së ofruesve të Ndhmës Juridike Dytësore dhe Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore, nga ku rezultoi se në përgjithësi mbikëqyrja dhe kontrolli i performancës së qendrave dhe ofruesve të Ndhmës Juridike është realizuar konform Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe urdhrin nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF e shërbimeve të ndihmës juridike”.

Konstatim: Vetëm në një rast u konstatua mungesë dokumentacioni dhe konkretisht në Urdhrin nr.111, datë 10.09.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e performancës së ofruesve të Ndhmës Juridike Dytësore, Qarku Gjirokastrë.” Në këtë praktikë gjendej vetëm Memo drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike dhe Drejtorit të Përgjithshëm dhe foto të ambienteve të zyrave të avokatëve të Ndhmës Juridike, Dhoma e Avokatisë Gjirokastrë. Në praktikë mungonin disa nga Aneksat e përcaktuara në Urdhrin nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë (Aneksi 6).

Konkluzion: Të mbahet parasysh në vijimësi nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike që çdo praktikë të jetë e pajisur me dokumentacionin përkatës konform urdhrin nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF e shërbimeve të ndihmës juridike”.

2.Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët.

Ndihma Juridike Dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12 të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

DNJF-ja lidh deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore. Pas miratimit të listës së avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore nga DHASH, DNJF-ja vijoi me procesin e lidhjes së kontratave me avokatët e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për vitin 2021. Lista e avokatëve publikohet në faqen zyrtare të MD-së.

Disa nga problematikat e konstatuara në ofrimin e Ndhmës Juridike Dytësore janë:

1. Dorëzimi në rrugë joformale të vendimeve të gjykatës (pa vulë dhe firmë sipas parashikimeve në K.Pr. Civile) dhe akteve të tjera zgjat procesin e pagesave të faturave tatimore të lëshuara nga avokatët për shërbimin e kryer nga ata.
2. Miratimi i listave përfundimtare të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike parësore bëhet nga Dhoma e Avokatëve brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, përmes shortit. Lista e aprovuar e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore, sipas dhomave lokale të avokatisë do të jetë e vlefshme deri më 31 janar të vitit pasardhës. Ndërkohë që kontratat e avokatëve lidhen me datë 1 mars të çdo viti kalendarik duke lënë një hapësirë 1 (një) mujore me shërbim të paofruar nga avokatët.

DNJF-ja realizon trajnime të avokatëve pjesë të listës për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore lidhur me legjislacionin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Përsa i përket ecurisë së vendimeve për pranimin e ndihmës dytësore rezulton se nga vendimet gjyqësore me objekt kërkesën për ndihmë juridike dytësore falas, të administruara nga DNJF-të për vitin 2021 në total rezultojnë 849 vendime gjyqësore.

Nga analiza e të dhënave, në krahasim me ecurinë gjatë vitit 2019 dhe 2020, konstatohet një rritje progresive me shumëfishim të kërkesave për ndihmë juridike dytësore.

- ✓ Për vitin 2019 janë marrë 32 vendime mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar,
- ✓ Për vitin 2021 në total rezultojnë 849 vendime mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar
- ✓ Për vitin 2021 janë marrë 181 vendime mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar.

Nga ana e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Ndhmës Juridike Dytësore mbahen dhe përditësohen regjistri elektronik i ekspertëve dhe Regjistri i Detajuar i Caktimit të Avokatëve. Gjithashtu nga Drejtoria e Financës, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse është mbajtur regjistri me rastet e ndihmës juridike dhe urdhërshpenzimet përkatëse.

Vlerësimi ligjor dhe financiar i praktikave dhe propozimit për kryerjen e pagesave për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Për administrimin, vlerësimin, trajtimin ligjor dhe financiar të praktikave mbi pagesat e shpërblimit të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore është ngritur një grup pune me përbërje: specialist të Drejtorisë së NJF dytësore, me urdhrin nr.167, datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga auditimi i pagesave të avokatëve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore, u konstatua se në përgjithësi pagesat e avokatëve janë realizuar konform Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe Udhëzimin e përbashkët nr. 18, datë 5.8.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”. Praktikën përmbanin dokumentacionin e përcaktuar në pikën II të Udhëzimit nr.18, datë 5.8.2020: **II. Kriteret e shpërblimit për shërbimin e ofruar nga avokati:** 2. Formulari për shpërblimin për ndihmën juridike shoqërohet me: *a) faturën tatimore të shërbimit të ofruar; b) kopje të vendimit të gjykatave të dhëna për çështjen ose kopje të akteve të tjera, të përpiluara sipas shtojcës 1; c) raportin për përfundimin e punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.*

Në disa prej praktikave të audituara u konstatua se janë likuiduar me vonesë faturat tatimore të lëshuara nga avokatët e ndihmës juridike falas, veprim i cili vjen në kundërshtim me afatin e parashikuar në Ligjin nr.111/2017, neni 463 Kodi Civil dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare” me ndryshime.

Konstatim: Disa nga problematikat e hasura që kanë çuar edhe në likuidimin me vonesë të faturave tatimore të avokatëve të ndihmës juridike dytësore kanë qënë:

- Lëshimi i faturës tatimore nga ana e avokatëve i pashoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues si kopje të vendimit të gjykatës, kërkesë padi apo raport përmbledhës, mbi bazën e të cilave grupi i punës duhet të përcaktojë nëse i takon apo jo pagesa si dhe për përcaktimin e vlerës përkatëse sipas akteve procedurale.

- Vendime të gjykatave të printuara nga sistemi (pa vulë dhe firmë) apo rastet e dërgimit të akteve të ekspertimit me vonesë nga ana e sekretarisë së gjykatave.

Konkluzion: DNJF-ja dhe konkretisht Drejtoria e Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Dytësore duhet të udhëzojë gjatë trajnimeve të avokatëve të ndihmës juridike dytësore dokumentacionin ligjor justifikues për shpërblimin e shërbimit të ofruar nga avokatët, kriteret formale dhe ligjore të dokumentacionit dhe të menaxhojë trajtimin e pagesave konform ligjit, në mënyrë që faturat tatimore të likujdohen brenda afatit të parashikuar në Ligjin nr.111/2017, neni 463 Kodi Civil dhe Ligj nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

Gjatë auditimit, grupi i auditimit konstatoi një rast të heqjes dorë të avokatit nga dhënia e ndihmës juridike dytësore 6 muaj pas lidhjes së kontratës.

Kontratat për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore lidhen me afat 1 (një vjeçar). Në rastin konkret, avokatja ka kryer shërbimin e përfaqësimit në shkallë të parë me palë (mbrojtja juridike në fushën civile dhe administrative), ka marrë pjesë në 2 seanca gjyqësore. Kontrata për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore është ndërprerë 6 muaj nga lidhja dhe hyrja në fuqi nga avokatja pasi ka qënë në një ndër rastet e Papajtueshmërisë së ushtrimit të Avokatit, konkretisht pika 1 e Nenit 7 **“Papajtueshmëria me ushtrimin e profesionit të avokatit”:** *Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, nuk mund të kryejë njëkohësisht detyrën e gjyqtarit, prokurorit, noterit, përmbaruesit gjyqësor, si dhe usnjë funksion apo detyrë tjetër në organet publike, me përjashtim të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit.* Por deri në këtë moment, avokatja ka ushtruar kompetencat e saj ligjore dhe ka përfaqësuar qytetaren e cila ka fituar të drejtën për ndihmë juridike të garantuar nga shteti.

Me shkresën datë 23.07.2021 avokatja ka dërguar dokumentacionin ligjor justifikues të parashikuar në pikën II.2 të udhëzimit të përbashkët nr.18, datë 05.08.2020:

- a) faturën elektronike tatimore shitje nr.388, datë 28.06.2021
- b) raport për përfundimin e punës datë 23.07.2021
- c) vendimin gjyqësor nr.794, datë 15.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan,
- d) Kërkesë padi datë 02.03.2021 për gjykim civil “Bukurije Cani”.

Me urdhër-shpenzimin nr.304, datë 21.09.2021 është paguar avokatja sipas tarifave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.18, datë 05.08.2020.

Pavarësisht faktit që avokatja ka hequr dorë për shkak të papajtueshmërisë së ushtrimit të profesionit të avokatit, grupi i punës ka gjykuar të kalojë pagesën me arsyetimin se gjykata është vënë në lëvizje nëpërmjet përpilimit dhe dorëzimit të akteve procedurale të nevojshme.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një institucion i krijuar rishtazi dhe janë në proces të krijimit të një praktike të unifikuar pune, për rrjedhojë vlerësimi i pagesave të avokatëve vlerësohet me një nivel rrisht të lartë. Duke qënë se praktika në fjalë përbën një rast *sui generis* (papajtueshmëria për shkak të ushtrimit të funksionit të avokatisë), i rekomandojmë DNJF-së dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Dytësore t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë vlerësimit të pagesave të avokatëve të ndhmës juridike falas duke interpretuar drejtë dhe pa konfunduar bazën ligjore dhe konkretisht ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, udhëzimin e përbashkët nr.18, datë 05.08.2020 dhe Kontratën për ofrimin e shërbimit të ndhmës juridike dytësore.

8. Sistemi i Menaxhimit të Riskut dhe i Kontrollit të Brendshëm.

8.1.Zbatimi i rekomandimeve të auditimit paraardhës.

Në maj të vitit 2019 ka përfunduar auditimi paraardhës dhe grupi i auditimit i Ministrisë së Drejtësisë ka lënë rekomandimet përkatëse sipas sistemeve dhe fushave të auditimit. Drejtoria e Ndhmës Juridike ka dërguar Planin e Veprimit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Janë realizuar një pjesë e rekomandimeve të pranuar nga subjekti i audituar dhe janë reflektuar në procesin e punës në vazhdimësi.

Grupi i auditimit paraardhës: Të ndërtohet dhe mirëmbahet faqja zyrtare, duke pasqyruar rubrikat standard që pasqyrojnë aktivitetin e institucionit.

Subjekti i audituar: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron një faqe zyrtare dhe në mënyrë periodike në faqe publikohen analizat mujore me të dhëna statistikore nga ofruesit e shërbimit të ndhmës juridike parësore dhe dytësore. Faqja <https://ndihmajuridike.gov.al/> është krijuar falë mbështetjes së projektit Euralius. Kjo faqe është marrë në administrim nga DNJF prej vitit 2020 dhe në vijim përditësohet me informacion nga personi i autorizuar me urdhrin nr.139 datë 15.10.2021 “Për një shtesë në urdhrin nr.220, prot datë 24.06.2020, “Për caktimin e detyrave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit”. Në këtë faqe publikohen të gjitha aktivitetet dhe takimet që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvillon, vendet vakante, njoftime të ndryshme, përditësohet Programi i Trasnsparencës, Regjistri i Kërkesave dhe 35 Përgjigjeve, Regjistrat sipas Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë, Raporte dhe Analiza Statistike të DNJF.

Drejtoria e Ndhmës Juridike administron llogari dhe në dy rrjete sociale si Facebook dhe Instagram. Edhe këto llogari administrohen dhe përditësohen me informacion nga punonjësi i ngarkuar për përditësimin e faqes.

Nga mars 2020, faqja nuk ka mbikëqyrje teknike dhe asistencë teknike. Deri në korrik 2021, mirëmbajtja është kryer nga një punonjës si pjesë e planit kombëtar të praktikave. Në vazhdim, postet në faqen në internet postohen nga një punonjëse e DNJF, e patrajnuar teknikisht. Për

periudhën në vijimin, DNJF nuk ka të parashikuar në buxhetin e saj postin e një specialisti IT dhe fondi për mirëmbajtje teknike të faqes.

Rrjetet sociale të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron llogari dhe në dy rrjete sociale si Facebook dhe Instagram. Edhe këto llogari administrohen dhe përditësohen me informacion nga punonjësi i ngarkuar për përditësimin e faqes.

Rekomandimi është ndjekur dhe zbatuar, si dhe është reflektuar zbatimi i rekomandimit në vazhdimësi.

Grupi i auditimit paraardhës: Të plotësohet organika e Drejtorisë së Ndihmës Juridike.

Subjekti i audituar: Në shkurt të vitit 2021 është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundur realizimin e këtij objekti në masën 100%, ku gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 është plotësuar vendi vakant i specialistit të financës. Për shkak të largimit të 3 specialistëve të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike vakancat janë thelluar sërish.

Rekomandimi është ndjekur dhe zbatuar, si dhe është reflektuar zbatimi i rekomandimit në vazhdimësi.

Janë nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuara në nenin 34 të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si më poshtë vijon:

- Udhëzim nr.4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor” i ndryshuar me udhëzim nr.1, datë 06.03.2019.
- Vendim nr.55, datë 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e ojf që oforjnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;
- Udhëzim nr.1, datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”;... etj.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas është audituar nga UNDP Albania në shtator të vitit 2021 dhe në Raportin e Mikrovlerësimit janë vlerësuar me risk të lartë vetëm fushat lidhur me sistemet dixhitale të menaxhimit financiar.

8.2. Mjedisi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm në kuadër të respektimit të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar

Grupi i auditimit në mbështetje të dokumentacionit të vënë në dispozicion sipas kërkesës së bërë, në lidhje me zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe akteve në zbatim ka rezultuar se nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për

vitin 2019, 2020 dhe 2021 janë hartuar dhe dorëzuar dokumentat në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.” me ndryshime.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas funksionon mbi bazën e një Rregulloreje të Brendshme, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me urdhër nr. 393, datë 23.11.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, në të cilin janë përshkruar detyrat dhe kompetencat funksionale të drejtorive, parimet themelore në ushtrimin e veprimtarisë.

Është realizuar Deklara për Cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2021 dhe 2022 dhe Raporti mbi Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas për vitin 2021 dhe 2022. Gjithashtu është hartuar dhe miratuar Regjistri i riskut dhe është plotësuar Pyetëtori i vetëvlerësimit për çdo vit. Me shkresat nr.317/1 prot., datë 16.04.2021, nr. 686 prot., datë 18.08.2021 dhe nr.1017 prot., datë 22.12.2021 është përgatitur dhe dërguar Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, faza I, II dhe III.

Kontrolli i aktiviteteve dhe komunikimi: Është hartuar “Analiza e realizimit të objektivave të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për vitin 2020” me shkresën nr.994 prot., datë 18.02.2021 dhe është miratuar nga Ministri i Drejtësisë me shkresën nr.994/1 prot., datë 18.02.2021 “Mbi analizën e realizimit të objektivave të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për vitin 2020”. Është përgatitur plani vjetor për vitin 2021 dhe 2022 në të cilën janë përcaktuar objektivat specifike, aktiviteti dhe lloji i aktivitetit, indikatorët e rezultateve, grupi i punës, afati për aktivitetet.

Zbatimi i rregullave për dorëzimin e materialeve në ngarkim, për punonjësit e larguar.

Funksioni i nëpunësit zbatues për periudhën nga data 4.6.2020 deri më datë 31.12.2020 është realizuar nga specialistja e financës, e cila është larguar pa respektuar procedurën e dorëzimit të materialeve në ngarkim. Me shkresën nr.1564/3 prot., datë 13.05.2020 “Transferim i përhershëm në përfundim të pezullimit” të Drejtorisë së Procedurave të Rekrutimit në shërbimin civil është transferuar në pozicionin Specialiste Finance/Buxhet në Drejtorinë e Financës, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 “Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe me shkresën nr.2980/3 prot., datë 11.06.2020 “Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të Përkohshëm për Drejtorinë e Ndhmës Juridike”, të Ministrisë së Drejtësisë, ku Nëpunës i Përkohshëm Zbatues është caktuar specialistja e financës.

Ish nëpunësi zbatues i periudhës i caktuar deri më datë 31.12.2020 ka kërkuar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare dhe të punës për arsye se është emëruar në një pozicion tjetër të administratës publike.

Nga auditimi rezulton se ish nëpunësi zbatues i caktuar me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 të Ministrisë së Financave nuk ka bërë dorëzimin e detyrës sipas udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në këto kushte identifikimi i saktësisë së kryerjes së procesit të dorëzimit të aktiveve në momentin e largimit, është i parcalizueshëm dhe si rrjedhojë kjo situatë ka vështirësuar procesin e auditimit.

Me vendimin nr.666/2 datë 05.01.2021 “Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare specialistes së financës, Drejtori i Përgjithshëm ka vendosur ndër të tjera edhe detyrimin e specialistes së financës për të bërë dorëzimin e detyrës dhe bazës materiale konform ligjit.

Nga ana e nëpunësit zbatues është përpiluar një procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit të Financës dhe Buxhetit, e firmosur dhe nga specialistja në fjalë, por nuk është marrë në dorëzim nga asnjë punonjës i DNJF-së.

U konstatua se edhe nga ana e DNJF-së nuk është ngritur një komision për dorëzimin e materialeve në ngarkim të nëpunësit zbatues të larguar.

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30 datë.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, parashikon procedurën për dokumentimin e përgjegjësisë materiale të nëpunësve dhe punonjësve, në institucionet shtetërore.

Bazuar në pikën 10 të udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **“Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike” theksohet se:** Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre sipas kompetencave që mbulon, duke dokumentuar veprimet e ndërmarra prej tij për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka nën përgjegjësi.

Ndërsa, lidhur me procedurën e dorëzimit të materialeve në ngarkim për punonjësit që largohen, pika 13 e udhëzimit shprehet se: *Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nëpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.*

Gjetje: Nga auditimi u konstatua se nëpunësi zbatues i DNJF-së i caktuar me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 “Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk ka ndjekur procedurën e dorëzimit të materialeve në ngarkim për punonjësit që largohen, veprim i cili vjen në kundërshtim pika 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”: *Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve.*

Nisur nga rrethanat, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të kishte ngritur një komision për marrjen në dorëzimit të materialeve në ngarkim të nëpunësit zbatues të larguar, ashtu siç e parashikon edhe pika 13 e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”: shprehet se: *Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nëpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.*

Rekomandimi: Të zbatohet procedura e dorëzimit të materialeve në ngarkim të secilit punonjës të DNJF-së konform udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime.

Identifikimi, përcaktimi dhe menaxhimi i riskut. Monitorimi.

Në urdhrin nr. 60, datë 17.02.2020 dhe nr.172, datë 24.03.2021 për Miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik me përbërje edhe nga Drejtoria e Ndhmës Juridike.

Me Urdhrin nr.11, datë 24.01.2022 është realizuar Ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik për Drejtorinë e Ndhmës Juridike. Janë dokumentuar minuta takimi të mbledhjeve të gupit të menaxhimit strategjik dtë 24.01.2022, 12.01.2021 15.07.2021, 30.09.2021. Me urdhrin nr.60, datë 17.02.2020 “Për Miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik,” në kuadër të ngritjes së urdhrin dhe zbatimit të ligjit për MFK janë zhvilluar takime, si dhe janë dokumentuar “minuta takimi” të mbledhjeve të gupit të menaxhimit strategjik datë 24.01.2022, 12.01.2021 15.07.2021, 30.09.2021.

8.3. Regjistri i riskut, mbajtja, përditësimi dhe efektiviteti.

Gjithashtu është realizuar regjistri i riskut, si një komponent shumë i rëndësishëm i MFK-së me në të cilin janë vendosur objektivat për çdo drejtori dhe për secilin objektivi është përcaktuar niveli i riskut.

Koordinatori i riskut është titullari i Institucionit.

Është realizuar pyetësori për vlerësimin e sistemit të programimit dhe zbatimit të buxhetit nga Drejtoria e Financës, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse. Dokumenti respektiv i PBA-së është

përgatitur bazuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, i ndryshuar.

Dokumenti i PBA-së është përgatitur bazuar në objektivat dhe produktet të cilat përmbushin qëllimin strategjik të DNJF-së. Është hartuar raporti mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në DNJF për vitin 2020 dhe 2021. Ky raport përmban një material informues, sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe parimeve mbi të cilat bazohet çdo komponent.

Në lidhje me politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore raportohet se janë miratuar përshtatje pune për çdo pozicion pune në subjekt, si dhe është realizuar procesi i monitorimit, duke filluar nga raportimi javor deri tek analizat 3 -muajore, 6-mujore dhe 1-vjeçare, si dhe vlerësimet periodike.

Në lidhje me përshtatshmërinë e strukturës organizative në funksion të objektivave të njësive raportohet se pavarësisht përpjekjeve të institucionit në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, ka ende vende vakante, rreth 10 pozicione specialist. Mosplotësimi i vendeve vakante sjell vështirësi në realizimin e detyrave funksionale, mbingarkesë, mbivendosje përgjegjësishe dhe kompetencash, mosrealizim të objektivave të drejtorive me cilësi dhe efektivitet të proceseve të punës. Është e rëndësishme që rekrutimi i punonjësve të rinj të realizohet në drejtim të kualifikimit të punonjësve të ardhur rishtazi.

Janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme përgjegjësitë dhe detyrat për secilin pozicion, janë parashikuar dhe përcaktuar përgjegjësitë, detyrat, komunikimi, dokumentimi, raportimi dhe mënyra e raportimit.

Gjetje: Nga auditimi u konstatua se drejtoritë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas nuk kanë hartuar manualin e proceseve të punës dhe hartën e proceseve konform Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Aneksit 2,3 si dhe nuk është hartuar gjurma e auditimit Aneksi 4 i Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Rekomandimi: Të ndiqet procesi i hartimit të manualeve të proceseve të punës, harta e proceseve dhe gjurmën e auditimit për të gjitha drejtoritë e DNJF-së.

Ky dokument nxjerr në pah çfarë duhet bërë dhe nga kush duhet realizuar. Gjithashtu manuali përshtatet të gjitha proceset e punës në sektor dhe drejtori, duke mundësuar identifikimin e dobësive, mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës, në funksion të kryerjes së detyrave të drejtorisë.

Në të gjitha drejtoritë e DNJF-së, janë përgatitur planet vjetore dhe 3 ose 6 mujore të punës. Në planet e punës janë parashikuar aktivitetet kryesore për realizimin e objektivave në funksion të strategjive. Në përmbushje të objektivave të vendosur nga secila drejtori, janë ngritur linjat e

brendshme të raportimit, të cilat gjatë vitit 2019-2021 kanë funksionuar në mënyrë të ndërsjelltë si dhe për marrjen e raporteve periodike dhe dhënien e informacioneve të nevojshme.

Sistemi i dorëzimit të materialeve në ngarkim të punonjësit që largohet, lidhur me zbatimin e Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011.

Gjetjet për sistemin e dorëzimit të materialeve në ngarkim të punonjësit që largohet, lidhur me zbatimin e Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011 do të trajtohen sipas formatit të mëposhtëm:

Titulli i Gjetjes: Nga auditimi u konstatua se nëpunësi zbatues i DNJF-së i caktuar me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 “Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk ka ndjekur procedurën e dorëzimit të materialeve në ngarkim për punonjësit që largohen, veprim i cili vjen në kundërshtim me pikën 10 dhe 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe u evidentua se nga ana e DNJF-së nuk është ngritur një komision për marrjen në dorëzim të aktiveve.

Gjetje nr. 12	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
Përshkrimi i gjetjes	Nëpunësi zbatues i DNJF-së i caktuar me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 “Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk ka ndjekur procedurën e dorëzimit të materialeve në ngarkim për punonjësit që largohen, veprim i cili vjen në kundërshtim me pikën 10 dhe 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nga ana e DNJF-së nuk është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të materialeve. Situata: Nga ana e nëpunësit zbatues është mbajtur një procesverbal për dorëzimin e materialeve në ngarkim e firmosur vetëm nga nëpunësi zbatues, por nuk evidentohet nëse këto materiale janë marrë në dorëzim nga ndonjë punonjës i DNJF-së. Kriteri: Pika 13 e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 shprehet se: <i>Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të</i>

	<p>përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Pika 10 e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i procedurës së dorëzimit të materialeve në ngarkim, për punonjësit që largohen nga institucioneve sjell vështirë në vazhdimësinë e proceseve të punës, si dhe ka sjellur vështirësi për realizimin e auditimit financiar për periudhën kur nëpunësja zbatuese ka qënë e caktuar si e tillë me shkresën e MFE-së.</p> <p>Shkaku: Procesverbali i dorëzimit të materialeve nga ana e ish nëpunësit zbatues nuk është dorëzuar konform udhëzimit nr.30/2011 dhe nga ana e DNJF-së nuk është ngritur një komision për dorëzimin e materialeve në ngarkim të nëpunësit zbatues.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	<p>Nisur nga rrethanat, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas duhet të kishte ngritur një komision për marrjen në dorëzimi të materialeve në ngarkim të nëpunësit zbatues të larguar, ashtu siç e parashikon edhe pika 13 e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”: shprehet se: <i>Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve.</i> Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nëpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.</p>
Rekomandimi	Të zbatohet procedura e dorëzimit të materialeve në ngarkim të secilit punonjës të DNJF-së konform Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar.

Observacioni i gjetjes nr. 12	<p>Nga auditimi u konstatua se nëpunësi zbatues i DNJF-së i caktuar me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 “Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk ka ndjekur procedurën e dorëzimit të materialeve në ngarkim për punonjësit që largohen, veprim i cili vjen në kundërshtim me pikën 10 dhe 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe u evidentua se nga ana e DNJF-së nuk është ngritur një komision për marrjen në dorëzim të materialeve.</p> <p>Me shkresën e DNJF nr. 217/3 prot, datë 01.04.2022, “Dërgohet kundërshtimet e argumentuara mbi konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruar në Projekt Raportin e Auditimit, subjekti i audituar ka paraqitur kundërshtimet si më poshtë: “Komisioni nuk është ngritur pasi nuk jemi në kushtet e ngritjes së komisionit, pasi punonjësi nuk dorëzoi dokumenta shkresore dhe as elektronike”.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Në manualin e proceseve të punës duhet përcaktuar me detaje roli, detyrat, kontrolli, delegimi dhe ndarja e detyrave për të gjitha drejtoritë e DNJF-së. Ky dokument nxjerr në pah çfarë duhet bërë dhe nga kush duhet realizuar. Gjithashtu manuali përshkruan të gjitha proceset e punës në sektor dhe drejtori, duke mundësuar identifikimin e dobësive, mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës, në funksion të kryerjes së detyrave të sektorit/drejtorisë.</p> <p>Të ndiqet hartimi dhe përditësimi i procesit të hartimit të manualeve të proceseve të punës, harta e proceseve dhe gjurmën e auditimit për të gjitha drejtoritë e DNJF-së.</p> <p>Subjekti i audituar me observacionin e përgatitur ka dalur jashtë thelbit të rekomandimit dhe nuk kanë sjellur argumenta ligjorë dhe financiarë për rrëzimin e gjetjes së auditit.</p>
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.
Rishikimi i nivelit të riskut	I mesëm.

Sistemi i Menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjetjet për sistemin e Menaxhimit financiar dhe kontrollit do të trajtohen sipas formatit të mëposhtëm:

Titulli i Gjetjes: Nga auditimi u konstatua se drejtoritë nuk kanë hartuar manualin e proceseve të punës dhe hartën e proceseve të përditësuar, si dhe nuk është hartuar gjurma e auditimit konform Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Gjetje nr. 13	Drejtoritë e DNJF-së nuk kanë hartuar manualin e proceseve të punës, hartën e proceseve dhe gjurmën e auditimit të përditësuar konform Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Të gjithë Drejtoritë e DNJF-së. Drejtoria e Financës, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
Përshkrimi i gjetjes	<p>Nga auditimi i zbatimit të procedurave të përcaktuara në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” u konstatua se në tërësi ka funksionuar sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe rezulton pjesërisht efektiv.</p> <p>Situata: Aktualisht manualet e proceseve të punës, harta e proceseve të punës dhe gjurmën e auditimit nuk janë përgatitur nga Drejtoritë e DNJF-së.</p> <p>Kriteri: Parimi 12 Aktivitetet e Kontrollit “Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave”. Aneksi 2,3 dhe 4 i Manualit të Menaxhimit Kontrollit Financiar.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mbështetja në këto procedura të shkruara do të ndihmojë institucionin në realizimin e objektivave dhe përdorimin e fondeve buxhetore në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente</p> <p>Shkaku: Drejtoritë e DNJF-së duhet të angazhohen në drejtim të rishikimit dhe ndërtimit të instrumentave të MFK, në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Në manualin e proceseve të punës duhet përcaktuar me detaje roli, detyrat, kontrolli, delegimi dhe ndarja e detyrave për të gjitha drejtoritë e DNJF-së. Ky dokument nxjerr në pah çfarë duhet bërë dhe nga kush duhet realizuar. Gjithashtu manuali përshkruan të gjitha proceset e punës në sektor dhe drejtori, duke mundësuar identifikimin e dobësive, mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës, në funksion të kryerjes së detyrave të sektorit/drejtorisë.
Rekomandimi	Të ndiqet hartimi dhe përditësimi i procesit të hartimit të manualeve të proceseve të punës, harta e proceseve dhe gjurmën e auditimit për të gjitha drejtoritë e DNJF-së.

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Në vazhdimësi
Statusi i rekomandimit	Pranuar nga subjekti i audituar.
Observacioni i gjetjes nr. 13	Opinioni i grupit të auditimit: Nuk është paraqitur observacion për këtë gjetje. Por gjatë observacioneve vihet re se është konfunduar ndarja e detyrave me hartimin dhe miratimin e manualit të proceseve të punës dhe hartës së proceseve të shtjelluara në Aneksin 2, 3 dhe 4 të Manualit të Menaxhimit Kontrollit Financiar.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Në manualin e proceseve të punës duhet përcaktuar me detaje roli, detyrat, kontrolli, delegimi dhe ndarja e detyrave për të gjitha drejtoritë e DNJF-së. Ky dokument nxjerr në pah çfarë duhet bërë dhe nga kush duhet realizuar. Gjithashtu manuali përshkruan të gjitha proceset e punës në sektor dhe drejtori, duke mundësuar identifikimin e dobësive, mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës, në funksion të kryerjes së detyrave të sektorit/drejtorisë. Të ndiqet hartimi dhe përditësimi i procesit të hartimit të manualeve të proceseve të punës, harta e proceseve dhe gjurmën e auditimit për të gjitha drejtoritë e DNJF-së.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Qëndron rekomandimi i grupit të auditimit.
Rishikimi i nivelit të riskut	I mesëm.

9. Auditimi i Teknologjisë së Informacionit

Lidhur me sistemet e teknologjisë së informacionit Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të menaxhojë funksionimin e kompjuterave dhe sistemeve në DNJF dhe në Qendrat e Ndhmës Juridike në rrethe. Për këtë arsye DNJF-ja ka aplikuar për t'u pajisur me një punonjës të IT-së në zbatim të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË RISKUT:

Gjetje	Rekomandimi
--------	-------------

			Niveli i Riskut
1.	<p>Gjatë procesit të auditimi konstatuam se në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2020, janë akumuluar detyrime të papaguara në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për shkak të deklarimit me vonesë në sistemin e organeve tatimore për punonjësve e këtij institucioni detyrim ky në shumën 37,347 lekë.</p> <p>Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 12 968, datë 14.10.2021 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, përcaktohet qartë se në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.08.2008,” Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton të jetë debitore në shumën 37,347 lekë, për deklarim të vonuar në sistemin e organeve tatimore, për periudhën Qershor –Dhjetor 2020.</p>	<p>Nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të ndiqen të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 37,347 lekë, për deklarim të vonuar në sistemin e organeve tatimore. Ky detyrim përfaqëson shkelje e disiplinës financiare dhe duhet të zhdëmtohet nga personi përgjegjës që ka shkatuar këte detyrim të paparashikuara nga ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të zbatohet me korrektësi kuadri ligjor në lidhje me mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.</p>	I Lartë
2.	<p>Në strukturën funksionale, për periudhën e audituar ka patur rreth <u>10</u> vende vakante. Mosplotësimi i vendeve vakante sjell vështirësi në realizimin e detyrave funksionale, mosrealizim të objektivave të drejtorive me cilësi dhe efektivitet të proceseve të punës.</p>	<p>Vakancat organike të ndiqen me prioritet nga institucioni, për plotësimin sa më shpejtë të saj, pasi mungesa e punonjësve ndikon negativisht në realizimin e objektivave të institucionit.</p>	I mesëm
3.	<p>Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se administrimi i tyre nuk ishte mbajtur konform VKM-së nr.833/2020.</p> <p>Situata: Mosadministrimi i dosjeve konform VKM-së nr.833/2020. Në disa prej dosjeve mungonin dokumentat e noterizuara, aktet e emërimit nga DAP dhe fleta e inventarizimit të dosjeve.</p> <p>Kriteri: VKM-ja nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”.</p>	<p>Të përditësohen të gjitha dosjet e personelit të DNJF-së sipas Lidhjes I të VKM- së nr. 833, datë 28.10.2020.</p>	I mesëm

	<p>Ndikimi/Efekti: Kjo parregullsi ka ardhur si pasojë e mungesës së specialistit të burimeve njerëzore, si personi përgjegjës për administrimin e dosjeve të personelit të Drejtorisë së Financës, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse.</p>		
4.	<p>Nga ana e D.N.J.F-së Tiranë ,(Drejtoria e Financës) në gjykimin e grupit të auditimit theksojmë se në lidhje me realizimit e zërve buxhetor për vitin 2019-2020-2021, konkretisht artikulli 602 “Shpenzime operative”, është realizuar respektivisht 42.4 % për vitin 2019, viti 2020 është realizuar 33.5% dhe për vitin 2021 është realizuar 26.3% , fakt që tregon performancë relativisht të ulët, të realizimit të këtij artikulli,si dhe ndjekjen dhe realizimin jo sistematik të fondeve të planifikuar për vitin ushtrimor. Ky artikull duhet të mbështetet në argumentime më të qarta dhe të sakta planifikimi. Shkalla e shfrytëzimit të fondeve të buxhetit është nën ndikimin e herpashershëm të ndryshimit të (Nëpunësit zbatues) dhe nuk mbështetet në argumentime të sakta planifikimi.</p>	<p>Drejtoria e financës në DNJF duhet të menaxhojë me efektivitet situatën në përdorimin e fondeve buxhetore vjetore duke ju përgjigjur nevojave reale të institucionit. Ky institucion duhet të bashkërendojë punën me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Drejtësisë duke siguruar standartet e nevojshme të sistemit buxhetor.</p>	I mesëm
5.	<p>Nga ana e D.N.J. F-së Tiranë, (Drejtoria e Financës) në gjykimin e grupit të auditimit theksojmë se për vitin 2019, plani i buxhetit i miratuar me ndryshime, është në shumën 43,000,000 lekë, është realizuar në shumën 16,313,158 lekë, ose 38%, me mosrealizim prej 26,686,842 lekë. Për vitin 2020, plani i buxhetit i miratuar me ndryshime, është në shumën 45,500,000 lekë, është realizuar në shumën 17,139,586 lekë, ose 38%, me mosrealizim prej 28,360,414 lekë. Mungesat në stafin e institucionit si dhe problematikat e hasura në këtë institucion nga ristrukturimi kanë lidhje me ecurinë, ndjekjen dhe realizimin e performancës buxhetore. Gjithashtu ka ndikuar edhe situata konkrete e pandemisë globale të</p>	<p>Nga DNJF-ja të evidentohen shkaqet dhe përgjegjësitë e mosrealizimit të buxhetit të miratuar, me qëllim që të reflektohet plotësisht performanca buxhetore në përmbushjen e objektivave të institucionit.</p>	I mesëm

	krijuar nga COVID-19, për këtë arsye procedurat e prokurimit janë ndërprerë për një periudhë të tejzgjatur, por grupi i auditimit këshilloi ndjekjen në të ardhmen me efektivitet e pergjegjesi te realizimit te zerave buxhetor.		
6.	Nga auditimi është evidentuar shkalla e ulët e realizimit të mallrave të prokurueshme në masën 37.6%, duke u krahasuar me nivelin e planifikimit (me ndryshime) që pasqyrohet në tabelën e mësipërme. Gjithashtu evidentohet, fenomeni i përqëndrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor, e cila ka ardhur si rezultat (efektet) i zvarritjes së procedurave të prokurimit, të realizimit të investimeve publike në kohë, likuidimi i tyre brenda vitit ushtrimor, me ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7 "Afati për autoritetet publike", pika "i"	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas(Njësia e prokurimeve) në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave të marrë masa për realizimin e procedurave të mallrave dhe investimeve, në mënyrë që të zbatojnë me rigorozitet realizimin faktik të tyre, shërbimeve apo mallrave, si dhe likuidimin e tyre në mënyrë periodike, me qëllim realizimin dhe likuidimin e tyre në kohë gjatë gjithë vitit buxhetor, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj.	I mesëm
7.	Nga auditimi i transaksioneve, u konstatua se, gjatë periudhës objekt auditim për vitin 2019 dhe 2020, shuma 1,167 lekë, vlerësohet si shpenzim i kryer pa efektivitet , si shpenzime të kryera për detyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e shpenzimeve për ujë, si dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorit vendore e taksave për vitet 2018-2019, në kundërshtim me Ligjin nr 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 10, si dhe në kundërshtim me, ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7 "Afati për autoritetet publike", pika "i" Gjatë auditimit u konstatuan urdhër shpenzime për detyrimet e prapambetura në lidhje me kamatvonesat për pagesat e faturës së ujit për periudhën Gusht 2020, në shumën 240 lekë . Gjithashtu u konstatuan vonesë likuidimi dhe kamatvonesat në lidhje me detyrimet tatimore në drejtorinë e taksave dhe tarifave, për vitin 2019, në shumën 927 lekë . Këto detyrime kanë ardhur si rezultat i mosmarrëveshjeve të krijuara midis DNJF-së dhe palëve të treta. Pavarësisht se ato e kanë	D.N.J.F Tiranë, me qëllim mosimplikimin e risqeve për krijimin e detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin në kohë të faturave ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme, brenda agfateve të përcaktuara në ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7 "Afati për autoritetet publike", pika "i", si dhe te kryhen keto pagesa konform Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 10,.	I mesëm

	<p>burimin tek mungesa e bashkëpunimit ndërinstytucional, gjobat e paguara përbëjnë shkelje të disiplinës financiare për shtetin, .</p> <p>Pagesa e kryer për pagesë gjobe nuk mund të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit , dhe veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 10.</p> <p><i>Pagesat e gjobave dhe kamatvonesave të cilat janë paguar nga Drejtoria e financës në DNJF, janë kryer në kundërshtim me Ligjin Organik të Buxhetit.</i></p>		
8.	<p>Për periudhën e audituar për vitet 2019-2020, janë likujduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, konkretisht neni 7 “Afati për autoritetet publike”, pika “i” ku thotë se “30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga debitori të faturës ose kërkesë pagese të njëvleftshme”, institucioni duhet të kryej likujdimin. Konkretisht janë likujduar 5 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 148,210 lekë duke sjellë:</p> <p>a. Tejkallim të afateve që parashikon Ligji nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare dhe si pasojë</p> <p>b. implikojnë risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura).</p>	<p>Me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura, në çdo rast NZ duhet të paraqes në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, dhe jo ndryshe. Për cdo rast në vijim, që do të konstatohet ndryshe, të evidentohen përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonesave të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar</p>	I mesëm
9.	<p>Nga ana DNJF (Drejtoria e Finacës) në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë zbatuar saktë përcaktimet ligjore për rastin e pagesës së lejes së pakryer për vitin 2020 si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës përmes procedurës së lëvizjes paralele , të bazuar në përlllogaritje jo korrekte sipas kuadrit ligjor e financiar aktual , veprim ky në kundërshtim me vendimin nr.511, datë</p>	<p>DNJF (Drejtoria e Finacës) të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 19,092 lekë, përfituar në mënyrë jo korrekte sipas kuadrit ligjor e financiar aktual e cila përfaqëson një</p>	I lartë

	<p>24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore ", konkretisht pika 4 "Pushimet". i ndryshuar , Nga këqyrja e dokumentacionit u konstatua se për viti 2020 në veprimet e thesarit për punonjësen A Grizhja si rrjedhojë e ndryshimit të pozicionit të punës përmes procedurës së lëvizjes paralele, ka përfituar lejen vjetore të pa kryerper vitin 2020, konkretisht 18 ditë kalendarike, veprim ky bazuar në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", konkretisht pika 3 e kreut II "Pushimet". I ndryshuar. Nga përlllogaritja u konstatua se punonjësja duhet të përfitonte 12 ditë kalendarike dhe si rrjedhojë diferenca 19,092 lekë është përfituar në mënyrë të gabuar dhe konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit</p>	<p>pagesë për ditët e lejes së pa kryer në këtë institucion, në kredi të punonjësit përfitues.</p>	
<p>10.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 procesi i inventarizimit nuk është kryer brenda vitit 2020, por në fillim të vitit 2021. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë.29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" me ndryshimet, Neni 7, si dhe me Udhëzimin Nr.30, dt 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik". Pika 74 .”Konkretisht procesi inventarizimit është kryer me Urdhërin nr 10 Prot dt 05.02.2021(nr 123 prot dt 05.02.2021)“ Për ngritjen e komisionit, për kryerjen e inventarizimit të aktiveve per vitin 2020..</p>	<p>Rekomandojmë që raste të tilla të mos përsëriten në vijimësi. NA, NZ dhe personeli i përfshirë, të marrin masat që në proceset e inventarizimit të rradhës të meret në konsideratë Udhëzimi Nr.30, dt 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik". Pika 74.” Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës. Rezultatet e inventarizimit në cdo rast duhet të dokumentohen me një relacion përkatës</p>	<p>I mesëm</p>

11.	<p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka dy qendra të ndihmës juridike parësore të financuara nga Buxheti i DNIF-së, nga katër që janë parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit.</p> <p>Situata: Moshapja e katër qendrave me buxhetin e shtetit sipas parashikimit në Urdhrin e Kryeministrit.</p> <p>Kriteri: <i>Urdhri nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”.</i></p> <p>Ndikimi/Efekti: Hapja e katër qendrave të parashikuara do të mundësojë ofrimin e shërbimit në gjithë territorin e R.SH.</p>	<p>Të zbatohet Urdhri i Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, ku është parashikuar që DNJF-ja do të ketë 4 qendra të ndihmës juridike parësore në qarqe.</p>	I mesëm
12.	<p>Nëpunësi zbatues i DNJF-së i caktuar me shkresën nr.9747 prot., datë 4.6.2020 “Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk ka ndjekur procedurën e dorëzimit të materialeve në ngarkim për punonjësit që largohen, veprim i cili vjen në kundërshtim me pikën 10 dhe 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nga ana e DNJF-së nuk është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të materialeve.</p> <p>Situata: Nga ana e nëpunësit zbatues është mbajtur një procesverbal për dorëzimin e materialeve në ngarkim e firmosur vetëm nga nëpunësi zbatues, por nuk evidentohet nëse këto materiale janë marrë në dorëzim nga ndonjë punonjës i DNJF-së.</p> <p>Kriteri: Pika 13 e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 shprehet se: <i>Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve.</i> Pika 10 e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit</p>	<p>Rekomandojmë që raste të tilla të mos përsëriten në vijimësi si dhe të zbatohet procedura e dorëzimit të materialeve në ngarkim të secilit punonjës të DNJF-së konform Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p>	I mesëm

	<p>publik”, “Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike”</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i procedurës së dorëzimit të materialeve në ngarkim, për punonjësit që largohen nga nga institucioneve sjell vështirë në vazhdimësinë e proceseve të punës, si dhe ka sjellur vështirësi për realizimin e auditimit financiar për periudhën kur nëpunësja zbatuese ka qënë e caktuar si e tillë me shkresën e MFE-së.</p> <p>Shkaku: Procesverbali i dorëzimit të materialeve nga ana e ish nëpunësit zbatues nuk është dorëzuar konform udhëzimit nr.30/2011 dhe nga ana e DNJF-së nuk është ngritur një komision për dorëzimin e materialeve në ngarkim të nëpunësit zbatues.</p>		
13.	<p>Nga auditimi i zbatimit të procedurave të përcaktuara në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” u konstatua se në tërësi ka funksionuar sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe rezulton pjesërisht efektiv.</p> <p>Situata: Aktualisht manualët e proceseve të punës, harta e proceseve të punës dhe gjurmën e auditimit nuk janë përgatitur nga Drejtoritë e DNJF-së.</p> <p>Kriteri: Parimi 12 Aktivitetet e Kontrollit “Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave”. Aneksi 2,3 dhe 4 i Manualit të Menaxhimit Kontrollit Financiar.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mbështetja në këto procedura të shkruara do të ndihmojë institucionin në realizimin e objektivave dhe përdorimin e fondeve buxhetore në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe efëçiente</p> <p>Shkaku: Drejtoritë e DNJF-së duhet të angazhohen në drejtim të rishikimit dhe ndërtimit të instrumentave të MFK, në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.</p>	<p>Të ndiqet hartimi dhe përditësimi i procesit të hartimit të manualeve të proceseve të punës, harta e proceseve dhe gjurmën e auditimit për të gjitha drejtoritë e DNJF-së.</p> <p>vend nga i njëjti komision.</p>	I mesëm

ANEKSI I. Gjatë auditimit, grupi i auditimit konstatoi disa problematika të cilat janë shprehur në këtë Aneks dhe duhet të mbahen parasysh nga subjekti i audituar (DNJF ja) për eliminimin e konstatimeve të evidentuara dhe marrjen e masave konkrete për mospërsëritjen e tyre në vazhdimësi.

Konstatim.1: Vetëm në një rast u konstatua mungesë dokumentacioni dhe konkretisht në Urdhrin nr.111, datë 10.09.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e performancës së ofruesve të Ndhmës Juridike Dytësore, Qarku Gjirokastrë.” Në këtë praktikë gjendej vetëm Memo drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Ofritit të Shërbimit të Ndhmës Juridike dhe Drejtorit të Përgjithshëm dhe foto të ambienteve të zyrave të avokatëve të Ndhmës Juridike, Dhoma e Avokatisë Gjirokastrë. Në praktikë mungonin disa nga Aneksat e përcaktuara në Urdhrin nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë (Aneksi 6).

Konkluzion.1: Të mbahet parasysh në vijimësi nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofritit të Shërbimit të Ndhmës Juridike që çdo praktikë të jetë e pajisur me dokumentacionin përkatës konform urdhrin nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofritit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF e shërbimeve të ndihmës juridike”.

Kundërshtimet e subjektit të audituar: “Mbikëqyrja dhe kontrolli i performancës së ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike kryhet në terren, pranë ambienteve të zyrave ku ofrohet shërbimi ku verifikohet nëse plotësohen të gjithë kriteret dhe indikatorët e parashikuar në metodologjinë e miratuar me urdhër të Ministrit.

Pas kontrollit të ambienteve dhe verifikimit të dokumentacionit të administruar pranë zyrave, grupi i punës vijon me plotësimin e Aneksëve përkatëse sipas Urdhrit nr.531/2019. Aneksi plotësohet në të gjitha rubrikat dhe i përcillet ofruesit të shërbimit për komente dhe rekomandime. Lidhur me praktikën e urdhrin nr.111, datë 10.09.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e performancës së ofruesve të Ndhmës Juridike Dytësore, Qarku Gjirokastrë”, subjekti i audituar ka argumentuar se Aneksi 6 është plotësuar dhe i është përcjellë ofruesit të shërbimit të ndihmës juridike falas.”

Grupi i auditimit: Theksojmë se ky fakt nuk është bërë i ditur gjatë procesit të auditimit, si dhe Aneksi 6 nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit deri në përfundim të angazhimit edhe pse iu është kërkuar disa herë të na vihet në dispozicion nga personat përgjegjës.

Konkluzioni përfundimtar: DNJF dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes të marrin menjëherë masat për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofritit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF e shërbimeve të ndihmës juridike”. Të

respektohet kuadri ligjor në fuqi, si dhe çdo praktikë e DNJF-së të pasqyrojë vërtetësi të procesit, transparencë dhe zbatim korrekt të ligjit dhe akteve nënligjore.

Konstatim:

Disa nga problematikat e hasura që kanë çuar edhe në likuidimin me vonesë të faturave tatimore të avokatëve të ndihmës juridike dytësore kanë qënë:

-Lëshimi i faturës tatimore nga ana e avokatëve i pashoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues si kopje të vendimit të gjykatës, kërkesëpadi apo raport përmbledhës, mbi bazën e të cilave grupi i punës duhet të përcaktojë nëse i takon apo jo pagesa si dhe për përcaktimin e vlerës përkatëse sipas akteve proceduriale.

-Vendime të gjykatave të printuara nga sistemi (pa vulë dhe firmë) apo rastet e dërgimit të akteve të ekspertimit me vonesë nga ana e sekretarisë së gjykatave.

Konkluzion:

DNJF-ja dhe konkretisht Drejtoria e Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Dytësore duhet të udhëzojë gjatë trajnimeve të avokatëve të ndihmës juridike dytësore dokumentacionin ligjor justifikues për shpërblimin e shërbimit të ofruar nga avokatët, kriteret formale dhe ligjore të dokumentacionit dhe të menaxhojë trajtimin e pagesave konform ligjit, në mënyrë që faturat tatimore të likuidohen brenda afatit të parashikuar në Ligjin nr.111/2017, neni 463 Kodi Civil dhe Ligj nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

Kundërshtimet e subjektit të audituar: Ky tejkallim i këtij afati mund të vijë si moskryerje në kohë të shqyrtimit të praktikës nga punonjësit, ose nga parregullsitë dokumentare të kërkesave të depozituara nga ofruesit. Më së shumti, kjo e dyta ndër të tjera ka mbingarkuar volumin e punës së punonjësve, duke vendosur një situatë që në aspektin menaxherial dhe të gjetjes së përgjegjësive së punonjësit është thujse e pamundur.

Grupi i auditimit:

Udhëzimi nr.18, datë 05.08.2020 parashikon qartë në pikën:

Pika e II.2:

Kriteret e shpërblimit për shërbimin e ofruar nga avokati

1. Me përfundimin e procedurave të dhënies së ndihmës juridike, avokati duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas formularin për shpërblimin, për ndihmën e ofruar, në përputhje me kontratën vjetore të lidhur midis avokatit dhe kësaj drejtorie.

2. Formulari për shpërblimin për ndihmën juridike shoqërohet me: a) faturën tatimore të shërbimit të ofruar; b) kopje të vendimit të gjykatave të dhëna për çështjen ose kopje të akteve të tjera, të përpiluara sipas shtojcës 1; c) raportin për përfundimin e punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

Konkluzioni përfundimtar:

DNJF-ja dhe konkretisht Drejtoria e Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Dytësore duhet të udhëzojë gjatë trajnimeve të avokatëve të ndihmës juridike dytësore dokumentacionin ligjor justifikues për shpërblimin e shërbimit të ofruar nga avokatët, kriteret formale dhe ligjore të dokumentacionit dhe të menaxhojë trajtimin e pagesave konform ligjit, në mënyrë që faturat tatimore të likujdohen brenda afatit të parashikuar në Ligjin nr.111/2017, neni 463 Kodi Civil dhe Ligj nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

Lidhur me pagesat e avokatëve: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është një institucion i krijuar rishtazi dhe janë ende në proces të krijimit të një praktike të unifikuar pune, për rrjedhojë vlerësimi i pagesave të avokatëve vlerësohet me një nivel risku të lartë. Duke qënë se praktika e përmendur në projekt raport përbën një rast *sui generis* (papajtueshmëria për shkak të ushtrimit të funksionit të avokatisë), i rekomandojmë DNJF-së dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Dytësore t’i kushtojnë një rëndësi të veçantë vlerësimit të pagesave të avokatëve të ndihmës juridike falas duke interpretuar drejtë dhe pa konfunduar bazën ligjore dhe konkretisht ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, udhëzimin e përbashkët nr.18, datë 05.08.2020 dhe Kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Konstatim.2: Disa nga problematikat e hasura që kanë çuar edhe në likuidimin me vonesë të faturave tatimore të avokatëve të ndihmës juridike dytësore kanë qënë:

-Lëshimi i faturës tatimore nga ana e avokatëve i pashoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues si kopje të vendimit të gjykatës, kërkesëpadi apo raport përmbledhës, mbi bazën e të cilave grupi i punës duhet të përcaktojë nëse i takon apo jo pagesa si dhe për përcaktimin e vlerës përkatëse sipas akteve procedurale.

-Vendime të gjykatave të printuara nga sistemi (pa vulë dhe firmë) apo rastet e dërgimit të akteve të ekspertimit me vonesë nga ana e sekretarisë së gjykatave.

Konkluzion.2.1: DNJF-ja dhe konkretisht Drejtoria e Mbikëqyrjes së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Dytësore duhet të udhëzojë gjatë trajnimeve të avokatëve të ndihmës juridike dytësore dokumentacionin ligjor justifikues për shpërblimin e shërbimit të ofruar nga avokatët, kriteret formale dhe ligjore të dokumentacionit dhe të menaxhojë trajtimin e pagesave konform ligjit, në mënyrë që faturat tatimore të likujdohen brenda afatit të parashikuar në Ligjin nr.111/2017, neni 463 Kodi Civil dhe Ligj nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

Konstatim 3.1: Urdhri nr.301, datë 30.07.2020 për ndryshimin e antarëve të komisionit të blerjeve të vogla ka dal si rezultat se dy nga antarët e komisionit të blerjeve të vogla kanë marrë lejen e zakonshme. Kjo mënyrë e trajtimit të komisionit të blerjeve të vogla është përdorur në mënyrë të përsëritur për vitin 2020-2021. Kjo praktikë mund të ndodhë në kushtet e largimit të punonjësve nga institucioni ose të transferimit të punonjësit, ose për një sëmundje të gjatë, por jo për shkak të marrjes së lejes së zakonshme, si veprime me risk dhe jo eficient i punës, në lidhje me njësinë e prokurimit duke lënë hapësira për gabime.

Konkluzion: Këshillojmë që praktika të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen

Konstatim3.2: Nga auditimi u konstatua se në regjistrat e realizimeve të prokurimit publik për periudhën e audituar, të pasqyruara grupit të auditimit, konstatohet shkalla e ulët e realizimit të mallrave të prokurueshme, kjo për arsye të situatës së vështirë të tërmetit dhe pandemisë si dhe ristrukturimi i institucionit, por në asnjë rast nuk e justifikon mosrealizimin e objektivave kryesore të institucionit ku një vend të rëndësishëm zë edhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore të prokurueshme. **Njësia e prokurimeve** në bashkëpunim me drejtorinë e financës duhet të ndjekin me përgjegjësi këtë fenomen, pasi kjo situatë ndikon negativisht në performancën financiare të DNJF-së.

Këshillohet të studiohet me përgjegjëshmëri procesi i plotësimit të regjistrat të parashikimeve të prokurimeve publike dhe ndjekja me efikasitet e tij.

Konkluzioni: Njësia e prokurimeve në bashkëpunim me strukturat mbështetëse, duhet të kryej me përgjegjësi realizimin me sukses të regjistrat të parashikimeve të prokurimeve publike dhe ndjekjen e këtyre zërave që të eliminojë ndikimin negativ të performancës buxhetore si dhe efikasitetin e monitorimit të fondeve.

Konstatim.4: Vlen të theksojmë se për periudhën 2019-2020, grupit të auditimit ju vështirësua shumë puna në lidhje me auditimin e anës dokumentare dhe justifikuese të trasaksioneve ekonomike si dhe të pasqyrave financiar për arsye se në këtë institucion kishin ndryshuar 4 nëpunës zbatues, duke na paraqitur vështirësi në konkluzionin përfundimtar për këtë institucion. Mbështetur në Ligj nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”¹, KREU II -Dispozita të përgjithshme mbi dokumentet kontabël dhe pasqyrat financiare- Neni 8 -Ruajtja e dokumenteve kontabël -

Dokumentet kontabël ruhen në selinë, ku zhvillohet aktiviteti ekonomik i njësisë ekonomike, **për 10 vjet rresht, pas mbylljes së periudhës raportuese së cilës i përkasin, me përjashtim të atyre që, me ligj ose akt tjetër nënligjor, u përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje.** I njëjti afat zbatohet edhe për dokumentet informatike (bartësit) dhe printimet e tyre. 2. Pasqyrat financiare të grupit ruhen nga njësia mëmë.

Konkluzioni.4.1: Rekomandojmë që dispozita e mësipërme e Ligj nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 8, pika 1 dhe pika 2 të zbatohen me përpikmëri në të ardhmen në këtë institucion, duke rritur shkallën e bashkëveprimit ndërsektorial për arritjen e objektivave të Institucionit.

Në përgjithësi urdhër shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalët dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve

Konstatim.5: Gjatë procesit të auditimit për vitin 2019 u konstatua mosrakordim i vlerave të inventarit fizik me atë të pasqyruar në kontabilitet. Jemi përpara faktit të një mosrakordimi midis

inventarit fizik dhe atij kontabël. Diferenca (2,804,137-2,532,337) = 271,800 lekë përfaqëson vlerën më shumë në kontabilitet sesa në inventarizimin fizik të kryer nga grupi i inventarizimit. Për vitin 2020 u konstatua mosrakordimi midis inventarit fizik dhe atij kontabël në shumën 60,817 lekë përfaqëson vlerën më shumë në kontabilitet sesa në inventarizimin fizik të kryer nga grupi i inventarizimit. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi **dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.**

Konkluzion.5.1: Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në ligj. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes. Zbatimi i Ligjit nr 9228, dt 29/04/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet, Neni 7 pika .2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi **dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.** Udhëzimin nr 8 dt 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithëshme pika 30.

Raporti përfundimtar i auditimit mbahet në 3(tre) kopje, 1(një) prej të cilave i dërgohet palës së audituar për dijeni dhe sqarim, 1(një) kopje qëndron në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë, dhe 1 kopje në dosjen e angazhimit të auditimit.

Subjekti i audituar jo më vonë se 30 ditë pune nga data e marrjes së raportit përfundimtar, duhet të paraqesë me shkrim plan veprimin e zbatimit të rekomandimeve të shprehura në këtë raport auditimi nga grupi i auditimit.

Grupi i Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Alma NASKA (Përgjegjëse Grupi)

Adriana KALEMAJ (Anëtare grupi)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr _____ prot.

Tiranë, më __. __. 2022

Lënda: Plan veprimi

MINISTRISË SË DREJTËSISË
DREJTORISË SË AUDITIMIT

TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar dhe Urdhërit 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë së Financave mbi "Manualin e Auditimit të Brendshëm", të ndryshuar, Kapitulli IV, po paraqesim Plan Veprimin për subjektin e audituar, Aparati i Ministrisë së Drejtësisë, subjekt i audituar në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Drejtori i Komanduar, Z.Gentjan Thoma, me nr. 483/1 prot, datë 27.01.2022 "Për auditimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas".

Nr.	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e parag.në raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						

